PËRMBAJTJA

Portreti i muajit: Mbështetës i dëshmuar 2

Dr. Milazimi Krasniqi: Izolimi poshtërues i Kosovës – për qejfin e duhanxhinjve 3-4

Fatos Shala: Duhanxhinjtë nuk e njohin ligjin e tyre.. 4-5

Muhamet Jahiri: Të gjithë kërkojmë ligjin kundër duhanit 6-8

Avni Avdiu: Mes shumë të këqijave edhe disa të mira... 9

Mr. Milazim Mustafa: Shqiptarët dhe Ballkani në vitin 2010 10-11

A. Avdiu: Pasojat e përmbytjeve në Shqipëri ... 12-13

Qendresa Mustafa: Haxhimusa: Sjelljet e pahijshme të gjyqtarëve dëmtojnë në thelb sundimin e ligjit ... 14-15

Avni Xhemajli: Rulèt greke për Shqipërinë ... 16-17

Dukagjin Avdyli: Homoseksualizmi 18-19

Intervistë me Kim Mehmetin 20-22

Lulzim Ahmeti: Çfarë bëmë, e çfarë duhet të bëjmë?.. 23

Mevlude Zejnullahu: Nëpër vorbullën e problemeve . 24

Muhamed J. Kajolli: Aliu, i biri i Ebu Talibit (598-661)... 25-27

Dr. Murad W. Hofmann: Muslimanët ndërmjet Oksidentit dhe Orientit (1) 28-30

Senad Ramadani: Prej fashizmit deri te terrorizmi. 31-32

Mexhid Yvejsi: Zoti, shqiptarët dhe gjuhëtarët .. 32-33

Flamur Maloku: Pushtuesja e skenës................. 34

Intervistë me drejtorin e Institutit Albanologjik, Hysen Matoshin... 34-35

Imer Topanica: Tmerri i dokumentuar 35

Avni Avdiu: Rreziku vjen nga Gjithësia.......... 36-37

Artan N. Bejta: Frika nga vaksina................ 37-38

Alban Bilalli: Për kë do të luajnë vëllezërit Xhaka? . 39

Largohet nga futbolli për të pasur më shumë kohë për t'iu përkushtuar Allahut 39

Fjalëkryqi 40













REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti V / Nr. 38

19 janar 2010 - 19 shkurt 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Mbështetës i dëshmuar

Kroacia do ta ndihmojë Kosovën në realizimin e synimeve të saj për integrim në familjen e bashkuar evropiane" - tha në Prishtinë presidenti kroat, Stipe Mesiq. Këtë deklaratë ai e bëri gjatë vizitës së tij njëditëshe në Kosovë, ku presidenti Fatmir Sejdiu i dha "Medaljen e Artë të Pavarësisë" dhe, më pas, ai u shpall "Qytetar nderi" i Prishtinës. Ai i bëri thirrje Beogradit që ta pranonte realitetin e ri në Kosovë dhe të mos e pengonte integrimin e komunitetit serb në institucionet e Republikës së Kosovës. Presidenti Mesiq tha se Kosova dhe Kroacia kanë kultivuar marrëdhënie të mira edhe në kohën e ish-Federatës Jugosllave. Ndërkaq, gjatë kohës së rënies së ish-Jugosllavisë, ai tha se populli kroat nuk e harron kurrë kontributin e kosovarëve në luftën për lirinë e këtij vendi. Duke iu drejtuar Parlamentit të Kosovës, gjatë një seance solemne të thirrur për nder të tij, Mesiq tha se vizita e tij në Kosovë ishte interpretuar në mënyra të ndryshme. Por, ai tha se vinte në Kosovë si mik i shqiptarëve, i serbëve dhe i popujve të tjerë dhe se kjo vizitë nuk ishte e drejtuar kundër askujt. "Federata Jugosllave është shkatërruar dhe dihet botërisht se me fajin e kujt është shkatërruar. Rrota e historisë nuk kthehet më pas dhe as Kosova nuk mund të rikthehet më në Serbi" - tha Mesiq. Ndërkohë, presidenti Fatmir Sejdiu tha se Kroacia paraqet një vend të veçantë për Kosovën, kurse, presidenti Mesiq, nënvizoi ai, është një prej personaliteteve që dha kontribut të madh për pavarësinë dhe njohjen e Kosovës. Ai vuri në dukje se nuk sheh ndonjë arsye për zemërimin e presidentit të Serbisë, Boris Tadiç, për shkak të vizitës së tij në Kosovë. "Do ta përshëndesja Tadiçin në rast se do të kishte ardhur me mua në Kosovë dhe në rast se do të kishim biseduar së bashku me presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiun dhe qytetarët që na pritën atje" - deklaroi Mesiçi pas reagimeve të ashpra të Tadiçit dhe autoriteteve të tjera të larta serbe që e konsideruan vizitën e presidentit kroat në Kosovë si një provokacion antiserb. Derisa deputetët shqiptarë dhe të komuniteteve të tjera i bënë të premten një mikpritje të ngrohtë presidentit kroat, Stipe Mesiq, kur ai vizitoi kuvendin e Kosovës, kjo nuk ndodhi me deputetët serbë. Lideri i Partisë Demokratike të Serbëve të Kosovës, Sllavisha Petkoviç, është shprehur: "Nuk do të pinim as edhe një kafe me të, e lëre më të ulemi me një person, i cili publikisht deklarohet për Kosovën e pavarur...Jo vetëm me atë, por me asnjë përfaqësues tjetër të Kroacisë, të cilët në Hagë kanë deklaruar se Kosova është shtet legjitim" - ka thënë Petkoviç, i cili dikur ka qenë edhe ministër për kthim i Kosovës. Vizita e presidentit kroat në Kosovë shënon vizitën e tij të fundit zyrtare si kryetar i Kroacisë në përfundim të dy mandateve pesëvjeçare. ■

BIOGRAFIA: **Stjepan (Stipe) Mesiq,** lindi më 24 dhjetor 1934 në rajonin e Sllavonisë – Orahovc, ku vijoi arsimin fillor e të mesëm. Diplomoi në Zagreb dhe punoi si gjykatës komune. U martua me Milkën me të cilën ka dy vajza: Dunjën dhe Sashën. Ishte delegat në kuvendin e Kroacisë gjatë viteve të 1960-ta, kryeministër i Kroacisë në vitet '90, mandej anëtarë i kryesisë së RSFJ-së. Në kryesinë e Jugosllavisë ka kryer funksionin e nënkryetarit, pastaj edhe të kryetarit në vitin 1991, pra ka kryer funksionin e kryetarit të fundit të ish-RSFJ. Është kryetar i dytë i Republikës së Kroacisë (pas Franjo Tugjmanit, i cili vdiq më 1999) që nga viti 2000; u rizgjodh më 2005. Mandati si president i përfundon më 18 shkurt, pasi ka shërbyer dy herë nga 5 vite.



Izolimi poshtërues i Kosovës - për qejfin e duhanxhinjve

Iniciativa e djaloshit katërmbëdhjetë vjeçar, Spek Mellenkampit, për të mbledhur një milionë nënshkrime, me çka babai i tij do të bindej që ta braktiste duhanin, është shembull i mirë se si një fëmijë e di se sa i dëmshëm është duhani, meqë babai i tij ka pasur infarkt si pasojë e pirjes së duhanit. Pra, ka shpresë edhe për Gjon Mellenkampin. Të vetmit që janë të pashpresë në këtë aspekt, janë qytetarët e Kosovës, sepse qeveria e tyre nuk është bindur ende që duhani është i dëmshëm për shëndetin e tyre



Dr. Milazim KRASNIQI

Kosova po vazhdon të mbetet e patrazuar edhe në vitin 2010 nga detyrimet që bart me vete përpjekja për t'u afruar me Europën e bashkuar. Përderisa qytetarët e vendeve fqinje, Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi mund të udhëtojnë pa viza gjithandej nëpër Europën e bashkuar, qytetarët e Kosovës do të vazhdojnë të mërdhijnë të patrazuar para dyerve të ambasadave. Pleq e plaka, gra e fëmijë, shtyhen në radhët e gjata, pa pasur shumë shpresë se në fund do t'u shpaguhet vuajtja me marrjen e një vize për të dalë përkohësisht, qoftë dhe vetëm për disa ditë, nga karantina e quajtur EULEXISTAN. Edhe përkundër kësaj, kampionët e optimizmit botëror, shqiptarët e Kosovës, nuk e prishin terezinë e optimizmit. Në vend që të gjenin mënyra të shprehjes së protestës për izolimin, ata vazhdojnë të jenë "krenarë" në poshtërimin që u bëhet. Njëra nga format e protestës qytetare ka mundur të jetë një tubim masiv në orë të caktuar, para zyrave të përfaqësuesit të Bashkimit Europian në Prishtinë dhe dorëzimi tek ai i listave të gjata me kërkuesit e vizave që refuzohen përditë. Ka mundur të organizohej edhe ndonjë program publik në formë instalacionesh ose transmetimesh publike në kryeqytet, ku do të transmetoheshin pamjet e gjata të kërkuesve të vizave, listat me emrat e të refuzuarve dhe hartat e shteteve europiane të rrethuara me gjemba. Po ashtu, është dashur të organizoheshin këso instalacionesh edhe para qeverisë së Kosovës, duke bërë së paku një pyetje publike: pse ende prodhohen pasaporta jobiometrike? Por, asgjë nga këto aktivitete nuk kanë ndodhur, as nuk duket se do të ndodhin as në vitin 2010. Për më tepër, qytetarët e Kosovës duken të lumtur nga ndonjë favor që e kanë falë izolimit. Fjala vjen, përderisa në Maqedoninë fqinje ka hyrë në fuqi më 1 janar 2010 ligji kundër pirjes së duhanit në vende publike, në Kosovë duhanxhinjtë mund të pinë duhan krejt të patrazuar, deri sa të mbesin pa frymë ata vetë dhe njerëzit përreth tyre. Edhe pse ligji kundër pirjes së duhanit në vende publike është miratuar para pesë vjetëve, asnjë përpjekje nuk është bërë që ai të vihet në zbatim. Ministri i shëndetësisë, Alush Gashi, nuk mbahet mend të jetë deklaruar në ndonjë rast lidhur me këtë çështje, qoftë dhe për të shprehur mendimin e tij si mjek. Vartësit e tij kanë pas shkruar disa urdhëresa administrative për ta kompletuar zbatimin e ligjit, por më vonë ato janë tërhequr mbrapsht, për të penguar zbatimin e ligjit. Sigurisht e gjithë kjo tymnajë rreth ligjit do të jetë bërë me urdhrin e ministrit. Së paku në rastin e moszbatimit të këtij ligji, partnerët e koalicionit duket sheshit që kanë konsensus të plotë, pra ata janë bashkërisht të vendosur që të mos e zbatojnë një ligj të miratuar nga Kuvendi. Por, Kuvendi nuk ka shprehur ndonjë interesim për fatin e ligjit që vetë e ka miratuar. Madje asnjë deputet i vetëm nuk ka kërkuar një interpelancë me ministrin ose me kryeministrin për injorimin total që i është bërë një ligji të miratuar. Kësisoj, tymnaja që ka rrethuar ligjin kundër pirjes së duhanit në vende publike, vazhdon të mos davaritet nga askush. Madje as opozita që bën zhurmë për gjithçka, kurrë nuk është kujtuar të bëjë një pyetje pse nuk zbatohet një ligj aq i rëndësishëm, që është një standard për t'u afruar me Europën e bashkuar.

Në izolimin e plotë që e ka ngulfatur Kosovën, të gjithë bashkërisht, qeveritarë e opozitarë, do të vazhdojnë të tymosin lirshëm e të kënaqur me veten e tyre, jo vetëm në ambientet e Kuvendit e të



qeverisë, po nëse ka nevojë edhe në ambientet e ambulancave e të klinikave. Në fakt, moszbatimi i ligjit kundër pirjes së duhanit në vende publike, zbulon karakterin antrieuropian dhe antihuman të politikës në vendin tonë. Politika nuk e ka preokupim as në këtë çështje e as në çështje të tjera, arritjen e standardeve të jetës publike që vlejnë në Europën e bashkuar. Kur nuk zbatohet një ligj kaq larg interesave klienteliste të politikanëve, si mund të pritet të ndryshohet e të zbatohet rigorozisht një ligj për prokurimin publik, ku pleksen interesat e shumta materiale të politikanëve dhe të klientëve të tyre parapolitikë? Ose të miratohet një ligj i qartë për të bërë transparencën financiare të fushatave elektorale dhe të partive politike? Retorika entuziaste proeuropiane, pa veprime adekuate politike e qeverisëse, që do ta mbështesnin konkretisht, është si një nishan i mentalitetit recidivist bizantin.

Po edhe të mos ishte fare nevoja që të arrihet standardi europian i zbatimit të një norme, të sjelljes publike, sikundër është ajo e ndalimit të pirjes së duhanit në ambiente publike, një qeveri e përgjegjshme do të duhej të zbatonte një ligj të tillë, vetëm për ta mbrojtur shëndetin e popullsisë. Botërisht dihet se pirja e duhanit është shkaktar i sëmundjeve të shumta, të cilat shkaktojnë trauma në jetën e mijëra familjeve që kanë të sëmurë. Po ashtu, shkaktohen edhe shpenzime të jashtëzakonshme të parave publike për mjekimin e të sëmurëve, që kanë pësuar nga pirja e duhanit.


Speck Mellencamp

Apo mos vërtet ka ende njerëz në qeveri që mendojnë se të dhënat për dëmin që shkakton pirja e duhanit, janë thjesht një propagandë? Meqë ligji thjesht nuk po zbatohet, kjo tingëllon si një qasje e ministrisë së shëndetësisë dhe e qeverisë së Kosovës. Ndërsa, në botën normale, jo vetëm që zbatohet ligji, por ka edhe iniciativa individuale për ndërgjegjësim për lënien e duhanit. Njëra prej tyre është shumë pikante. Iniciativa e djaloshit katërmbëdhjetë vjeçar, Spek Mellenkampit, për të mbedhur një milionë nënshkrime, me çka do të bindej babai i tij që ta linte duhanin, është shembull se si një fëmijë e di se sa i dëmshëm është duhani, meqë babai i tij ka pasur infarkt si pasojë e pirjes së duhanit. Djaloshi po mbledh firma në fejsbuk dhe ka gjasa që të mbledhë një milionë nënshkrime. Babai i tij, i cili me pasionin e tij për pirjen e duhanit edhe pas infarktit që ka përjetuar, më shumë duket si shqiptar i Kosovës se sa si amerikan. Megjithatë, ai i ka premtuar të birit se nëse djaloshi i mbledh një milionë nënshkrime kundër pirjes së duhanit me thirrjen: "Nëse 1.000.000 firmëtarë më bashkohen, babai im, Gjon Mellenkampi do ta lërë duhanin", ai do ta braktisë vërtet pirjen e duhanit. Pra, ka shpresë edhe për Gjon Mellenkampin. Të vetmit që janë të pashpresë në këtë aspekt janë qytetarët e Kosovës sepse qeveria e tyre nuk është bindur ende që duhani është i dëmshëm për shëndetin e tyre. Kjo po ndodh ngase në vendin tonë nuk ka vullnet për ta zbatuar ligjin. E lëre më që të ketë iniciativa individuale e qytetare. Kur nuk ka asnjë iniciativë qytetare për ta denoncuar izolimin poshtërues që i është bërë Kosovës, si mund të ketë iniciativa për të "privuar" veten nga qejfi i madh i duhanit. Izolimi poshtërues i instaluar së fundi nga ana e Bashkimit Europian dhe fryma antieuropiane dhe antihumane e sedimentuar në segmente të shoqërisë sonë, ku në plan të parë bën pjesë politika, edhe shkojnë me këtë qejf-shprehi të mbrapshtë e të dëmshme, e cila nuk i jep pesë para për shëndetin e rrezikuar të shtetasve të këtij vendi. Ama bash as pesë para. ■

Sa po zbatohet Ligji për Duhanin

Duhanxhi

Sipas organizatës joqeveritare KADC, shumica e qytetarëve të Kosovës dinë shumë pak për Ligjin e Duhanit, ndërsa 90 për qind e tyre nuk e kanë parë shenjën ndaluese për shitjen e duhanit personave nën moshën 18 vjeç.
Ndërsa, Inspektorati Sanitar i Kosovës e parashikon zbatimin e ligjit si një sfidë të vështirë për të ardhmen



Fatos SHALA

Qytetarët e Kosovës janë konsumues të mëdhenj të duhanit. Edhe pse shumica prej tyre i dinë pasojat që mund të bartin nga vesi i duhanpirjes, ata, megjithatë, e konsiderojnë duhanin si "shokun" më të mirë të ditës. Ndërsa Inspektorati Sanitar i Kosovës e parashikon zbatimin e ligjit si një sfidë të vështirë për të ardhmen, kurse ligji i Republikës së Kosovës e ndalon pirjen e duhanit në të gjitha institucionet publike ose private, ku ofrohen shërbime shëndetësore.

Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha institucionet publike a private të edukimit, arsimit dhe të mbikëqyrjes së fëmijëve dhe rinisë. Ndalohet pirja e duhanit në hapësirën publike, përveçse në hapësirat e parapara për pirjen e duhanit.

Ligji për duhanin, i panjohur për qytetarët

"Duhanin e pi që në moshë të re. Kam dëgjuar se sjell shumë sëmundje, por duhani të imponohet, bre axhë, dhe në këtë moshë e kam vështirë ta lë. Por mendoj që të rinjtë nuk duhet ta pinë fare" - thotë Tahir Mazreku, 56 vjeçar nga Prishtina. Ai nuk ka shumë informata për Ligjin e Duhanit, por është dakord se ky ves ndoshta do të mund të reduktohej vetëm nëpërmjet këtij ligji. Në anën tjetër, lidhur me njohuritë e qytetarëve për Ligjin e Duhanit,

në Kosovë?

njtë nuk e njohin ligjin e tyre

organizata joqeveritare KADC (Kosovo Advo-cacy and Development Centre) ka mbajtur një konferencë, ku ka prezantuar rezultatet e hulumtimit të saj lidhur me këtë ligj. Pjesëmarrës të takimit ishin edhe përfaqësues të Inspektoratit Sanitar të Shëndetësisë së Kosovës.

Shkumbin Spahija, drejtori i KADC, ka theksuar se, sipas hulumtimeve të organizatës, gjatë vitit 2009 dukuria e konsumimit të duhanit në objektet arsimore dhe ato shëndetësore, edhe përkundër ndalimit me ligj, është ende e pranishme.

Mirëpo, ai ka shtuar se qytetarët e përkrahin në masë të madhe ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike, sidomos në objektet shëndetësore dhe ato arsimore, e po ashtu e përkrahin ndalimin e shitjes së duhanit personave nën moshën 18-vjeçare. Sipas tij, 70 për qind e të anketuarve nuk e dinin se në Kosovë ekziston Ligji për Duhanin dhe më shumë se 90 për qind nuk e kishin parë shenjën ndaluese për shitjen e duhanit personave nën moshën 18 vjeçare.

Spahija ka thënë se zbatimi i ligjit për duhanin paraqet një nevojë të domosdoshme për të riafirmuar të drejtën themelore të secilit njeri, për t'i gëzuar standardet më të larta shëndetësore. "Në vendet e Bashkimit Evropian dhe ato të rajonit dihen trendet e rritjes së numrit të hapësirave publike në të cilat është e ndaluar pirja e duhanit. Edhe para institucioneve të Kosovës dhe qytetarëve të saj shtrohet sfida se si të përftohet nga ky trend i zhvillimeve dhe bërjes pjesë së këtij trendi"- ka thënë Spahija. Spahija ka deklaruar se KADC ka filluar me shpërndarjen e posterëve në të gjitha komunat më të mëdha të Kosovës, me qëllimin e sensibilizimit të opinionit për ekzistimin e ligjit për duhanin, si dhe për t'i informuar qytetarët për dëmet që shkakton pirja e duhanit.

Inspektorati pret zbatimin e ligjit

Iliriana Zymberi, kryeinspektore e Inspektoratit Sanitar në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), ka thënë se zbatimi i Ligjit për Duhanin është një sfidë e madhe për Kosovën, duke marrë parasysh se edhe vendet e BE-së kanë pasur vështirësi në zbatimin e këtij ligji. "Vështirësi kemi për shkak të mentalitetit, por ne jemi të përgatitur për sfidat për zbatimin e Ligjit të Duhanit, ngase sipas disa praktikave të vendeve të BE-së, edhe atje kanë kaluar pesë deri në shtatë vjet derisa e kanë praktikuar këtë ligj" - tha Zymberi.

Sfida për zbatimin e Ligjit për Duhanin

"Duke marrë parasysh përvoja të shumta, kemi parë se edhe ne në Kosovë kemi një sfidë të madhe për ta zbatuar ligjin në nivel të plotë. Por, Inspektorati Sanitar i ka bërë ndalesat për duhanin në Kosovë, duke marrë parasysh dhe vendet publike"- është shprehur Ibrahim Tërshnjaku, zëvendës kryeinspektor i Inspektoratit Sanitar të Kosovës. ■



Çka thotë ligji për ndalimin e pirjes së duhanit?

Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha institucionet publike a private, ku ofrohen shërbime shëndetësore. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha institucionet publike a private të edukimit, arsimit dhe të mbikëqyrjes së fëmijëve dhe rinisë. Ndalohet pirja e duhanit në hapësirën publike, përveç në ato hapësira të parapara për pirje të duhanit.

Në hapësirat publike, përveç vendeve të përcaktuara nga pika 10.1 dhe 10.2 të nenit 10, mund të sigurohen vende për pirjen e duhanit, por që këto vende nuk janë vendqëndrime të zakonshme për personat që nuk pinë duhan, ose që nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme të vizitohen gjatë kohës së punës. Hapësira e dedikuar për pirje të duhanit nuk guxon të jetë më e madhe se 30% nga hapësira e lokalit gjegjës.

Përcaktimi i hapësirës për duhanxhinjtë duhet të bëhet nga personi përgjegjës juridik a fizik i hapësirës në fjalë. Hapësira për duhanxhinjtë duhet të jetë e pajisur me aparate për ajrosje, taketuke dhe me mjete kundër zjarrit. Personi përgjegjës i hapësirës publike mund ta ndalojë pirjen e duhanit në gjithë hapësirën, për çka duhet shënuar me mbishkrim në hyrje të atij objekti, si dhe në vendet ku shihen në brendi të tij. Personi përgjegjës i hapësirës publike duhet të vendosë shenjat e lejimit a moslejimit të pirjes së duhanit në vendet që shihen dhe që mund të lexohen nga largësia prej 5m.

Në vendet publike dhe në vendet e punës me pronësi private a publike ku është e ndaluar pirja e duhanit nuk duhet të jenë të vendosura taketuket. Qeveria mban të drejtën që të kërkojë kushte të tjera shtesë për hapësirat ku lejohet pirja e duhanit.

Përfaqësues nga institucionet, nga shoqëria civile, qytetarë e mjekë kanë bërë thirrje që të ndal

Të gjithë kërkojnë ligjin



Muhamet JAHIRI

Kosova i është bashkuar vendeve të botës të cilat e sanksionojnë me ligj ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike, por zbatimi i tij duket se po përcillet me probleme serioze. Por, pavarësisht kësaj, përfaqësuesit e institucioneve, e shoqërisë civile, mjekët, qytetarët, por edhe pronarët e kafeneve, kanë bërë thirrje që të ndalohet sa më parë konsumimi i duhanit, sidomos në vendet publike.

Drejtori i Departamentit për Komunikim në Ministrinë e Shëndetësisë, Faik Hoti, ka thënë se në Kosovë ekziston ligji për ndalimin e përdorimit të duhanit në ambientet publike, mirëpo për këtë qeveria duhet t'i shpejtojë procedurat dhe ta shtyjë atë drejt kuvendit për miratim.

"Në Kosovë ekziston ligji i duhanit. Ky ligj është nën kuadrin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kemi bërë disa ndryshime në të, me rekomandimin e Ministrisë së Drejtësisë. Ne kemi kryer disa ndryshime të vogla, të cilat kanë pas të bëjnë më shumë me pakon e cigareve, se çfarë duhet të përmbajë, për efektet e duhanit etj. Pra, e kemi përfunduar punën tonë dhe e kemi dorëzuar ligjin në qeveri dhe i mbetet qeverisë që ta procedojë në Kuvend për ta miratuar" – ka theksuar Hoti.

Hoti ka deklaruar se është në interes të Ministrisë së Shëndetësisë që të zbatohet ligji në tërë vendin. Ai, po ashtu, ka thënë se tashmë ka filluar zbatimi i tij në disa institucione shtetërore, por megjithatë duhet shumë punë për ta mposhtur propagandën e prodhuesve të cigareve.

"Megjithëkëtë, lufta kundër duhanit është shumë e vështirë, nga se industria e duhanit bën luftë që të shesë sa më shumë cigare, që është në interesin e saj ekonomik, por Ministria e Shëndetësisë, bashkë me atë të Kulturës dhe Arsimit do të fillojnë që ta zbatojnë atë, pasi që të miratohet në Kuvend" – është shprehur Hoti, duke shtuar se duhet të bëhet çmos për ndalimin e duhanit, i cili sipas tij ka shumë pasoja.

"Zbatimi i ligjit kundër duhanit është i domosdoshëm nga se duhani paraqet rrezik për shëndetin publik, si dhe të duhanpirësve pasivë. Ky për ne është një ligj i domosdoshëm, i cili duhet ta mbrojë shëndetin e popullatës" - është shprehur drejtori i Departamentit për Komunikim në Ministrinë e Shëndetësisë, Faik Hoti.

Hoti ka bërë të ditur se edhe Kosova do t'i bashkohet vendeve të Evropës dhe rajonit sa i përket ligjit për ndalimin e përdorimit të duhanit në vendet publike.

"Duhani është shumë i dëmshëm sepse përmban substanca që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndet, si: nikotinë, katran, dyoksidi karboni etj, prandaj është e nevojshme të ndalohet jo vetëm në vendet publike, por edhe në ambientet familjare, sepse është shumë i dëmshëm. Ne, pas miratimit të ligjit, do t'i shtojmë aktivitetet tona dhe do të bëjmë çmos që ky ligj të zbatohet si në disa vende të Bashkimit Evropian dhe disa vende të rajonit, mirëpo për këtë duhet të ketë edhe vullnet të qytetarëve" – ka thënë Hoti.



Faik Hoti

Retkoceri: Pirja e duhanit shkakton probleme serioze

Ndërkaq, doktori specialit i njërës prej Qendrave të njësisë familjare në Prishtinë, Abdyl Retkoceri, ka thënë se pirja e duhanit shkakton probleme shumë serioze te njeriu i cili e konsumon atë. Ai ka deklaruar se, pavarësisht kësaj, në vendin tonë është bërë një trend mode konsumimi i cigares.

"Thithja e duhanit e ka direkt ndikimin më të madh në shëndet në organet e sistemit të frymëmarrjes që nënkuptojnë fytin, hundën, laringun dhe mushkëritë. Duhani shkakton probleme të shpeshta të ndezjes së hundës, siç janë pezmatimet që në mjekësi thirren sinusit, pastaj të laringut, gabzherrit dhe të mushkërive. Një virus e zhvillon më lehtë sëmundjen tek një duhanpirës. Ndikimi shumë serioz i pirjes së duhanit në ditët e mëvonshme është zhvillimi i sëmundjeve kronike të ndryshme që tek duhanpirësit janë më të shpeshta dhe më të vështira që të shërohen dhe këtu nënkuptojnë bronkitin kronik dhe ndezjen e mushkërive, një prej shkaktarëve të të cilëve është edhe duhani" - ka thënë Retkoceri, duke shtuar se duhani ka edhe ndikim kancerogjen.

"Duhet potencuar posaçërisht ndikimi kancerogjen i disa përbërësve të nikotinës. Janë dhjetëra që e kanë vërtetuar ndikimin kanceroz në mushkëri. Sëmundja e kancerit të mushkërive, për momentin, është problem serioz edhe për shoqërinë" - ka shtuar ai.

Sipas doktorit, të ndikuar dhe me pasoja nga duhanpirësit janë edhe duhanpirësit pasivë, të cilët, me apo pa dashjen e tyre, gjenden në një ambient ku konsumohet duhani.

"Është e vërtetë që personat që nuk e konsumojnë duhanin dhe janë në mesin e duhanpirësve e kanë ndikimin gati të njëjtë" – ka theksuar Retkoceri,

...ohet pirja e duhanit në vendet publike me ligj

kundër duhanit



duke shtuar se një gjë e tillë është mirë të sanksionohet me ligj.

"Kështu që është shumë i mirëseardhur ligji që po flitet, i cili nuk ka filluar të aplikohet ende, për parandalimin e pirjes së duhanit në vendet publike. Njerëzit duhen të vetëdijesohen për parandalimin e duhanit, sepse ka shoqata të ndryshme që ndihmojnë për këshilla. Pastaj ka hapa që e parandalojnë, fllastera që ngjiten në trup, etj." – ka theksuar specialisti Retkoceri.

Ai ka bërë të ditur se ka shumë njerëz të cilët i drejtohen atij për t'i ndihmuar përmes këshillave në lënien e duhanit, mirëpo sipas tij një gjë e tillë është e vështirë.

"Ka njerëz që në momentin e caktuar kur ne e vërtetojmë që kanë pasoja në shëndet nga pirja e duhanit, gjatë vizitës mjekësore na u propozojmë, pavarësisht dëshirës së tyre, që ata ta ndërpresin duhanin sepse rrezikohen më vonë. Shumica nga ta pajtohen dhe thonë shpesh 'Ishalla e ndërpres duhanin, por nuk po di si', por realisht nuk ka të vendosur. Të rrallë janë ata pacientë që vijnë e kërkojnë këshillime për parandalimin e duhanit" – është shprehur doktor Retkoceri.

Sipas tij, duhani tek njeriu e ka efektin sikurse edhe përbërësit e tjerë të dëmshëm për organizimin siç janë: kafeina, droga, alkooli.

Osaj: Do e respektoj ligjin. Në kafenenë time do ta ndaloj konsumimin e duhanit

Ndërkaq, Ramiz Osaj, pronar i njërës prej kafeneve më të frekuentuara në Prishtinë, kafes "Time's bar", në lokalin e të cilit konsumohet shumë duhani ka thënë se nëse kërkohet nga ai që ta ndalojë përdorimin e duhanit, ai do ta bëjë një gjë të tillë sipas ligjit.

"Unë do ta zbatoj ligjin nëse vendoset për një gjë të tillë. Unë nuk do të lejoj që të konsumohet duhani në kafenenë time nëse një gjë e tillë rregullohet më ligj" - ka theksuar Osaj.

Sipas tij, edhe përkundër se ndalimi i konsumimit të duhanit do të ndikonte në të ardhurat e punës së tij, ai do ta bënte një gjë të tillë.

"Pavarësisht asaj që në kafenenë time shumica e klientëve janë duhanpirës dhe konsumues të rregullt të duhanit, unë do t'ua ndaloja përdorimin këtu, në mënyrë që t'i respektoj sa më shumë rregullat e shtetit. Mirëpo nëse një gjë e tillë ndodh, ajo duhet të vlejë për të gjithë njësoj dhe të ketë kontroll nga ana institucionale në mënyrë që jo dikush ta zbatojë ligjin e dikush ta thyejë atë, duke përfituar më shumë e të mos ketë ndëshkim" – është shprehur pronari i "Time's bar"-it.

KADC: Çdo vit, vdesin rreth 5 milion njerëz si pasojë e duhanit

Ditë më parë, nëpërmjet një konferencë të organizuar nga Qendra e Kosovës për avokim dhe zhvillim (KADC), në kuadër të projektit "Mbrojtja e shëndetit publik nga pirja e duhanit", është deklaruar se duhani është shkaktari i dytë i vdekjeve në botë dhe, si pasojë e konsumimit të tij, çdo vit vdesin rreth 5 milionë njerëz. Duhani është helm, përbërësi kryesor i të cilit është nikotina, që është helm i fortë nervor dhe në varësi të kualitetit të cigares ajo mund të përmbajë deri në 15 miligramë nikotinë, që do të thotë se në një pako prej 20 cigaresh mund të gjenden 120-300 miligramë nikotinë dhe përbërës të tjerë siç janë: dyoksidi i karbonit, monoksidi i karbonit, amoniaku, katrani etj.

Sipas këtij studimi, sëmundjet më të shpeshta që shkakton duhani janë sëmundjet respiratorë si enfizema mushkërore, përkeqësime të sëmundjeve tjera, sëmundjet kardiovaskulare, si infarkti i zemrës, përkeqësimi i diabetit me pasoja tragjike, duke shkaktuar në disa raste edhe amputimin e ekstremiteteve për shkak të gangrenës. Në klinikën pulmologjike në Prishtinë, brenda vitit bëhen 2.000 hospitalizomë, prej të cilave 500 i takojnë problematikës së tumoreve, kurse rreth 500 të tjerë janë nga pasoja e pirjes së duhanit.

Duhani një vrasës i ngadalshëm, por i sigurt!

Qytetarët pro ndalimit të duhanit në vendet publike

Edhe qytetarët e Kosovës, të anketuar lidhur me atë se a pajtohen që të ndalohet përdorimi i duhanit në vendet publike, janë deklaruar se një gjë e tillë është e domosdoshme.

Mulliqi: Duhet të ndalohet pirja e duhanit në vende publike



Besim Mulliqi, qytetar nga Podujeva, është i mendimit se përdorimi i duhanit në vendet publike duhet të ndalohet me ligj, pasi që sipas tij ka dëme të shumëfishta.

"Normal që duhet të ndalohet duhani në vendet publike sepse është i dëmshëm, e ndot ambientin dhe e dëmton shëndetin. Edhe pse jam konsumues i duhanit e shoh se është i dëmshëm. Mua nuk më pengon nëse ndalohet duhani në vende publike" – ka thënë Mulliqi.

Kryeziu: Të dënohen ata që s'e ndalojnë duhanin në vendet publike



Edhe Islam Kryeziu, qytetar nga Malisheva, i cili nuk është duhanpirës mendon se është shumë i nevojshëm ndalimi i duhanit, sidomos në vendet publike.

"Jo nuk e pi duhanin. Mendoj se duhet të ndalohet pirja e duhanit në vendet publike me ligj dhe të ketë dënime sa më të forta për ata që e shkelin ligjin. Duhani është shumë i dëmshëm. Në një



ambient ku pihet duhani, njerëzit që nuk pinë duhan kanë pasoja të mëdha nga duhanpirësit" – ka deklaruar Kryeziu, duke shtuar se një gjë e tillë duhet të ndalohet me ligj.


Berisha: Duhani tepër i dëmshëm për njerëzit



Ndërkaq, Kadrie Berisha, banore e Prishtinës është e bindur se ka ardhur koha që edhe Kosova ta ndëshkojë me ligj përdorimin e duhanit në vendet publike.

"Kisha preferuar që ta ndalojnë duhanin në vendet publike. Përdorimi i tij është gjë e keqe tepër e ndytë për njerëz. Mendoj se për mua që nuk konsumoj duhan, të ndenjurit në vendet ku konsumohet është me pasoja, sepse ai tym është tepër i dëmshëm" – ka thënë Berisha.


Zhitia: Nuk mund të qëndroj në ambientet ku pihet cigare



Ndërsa Zahe Zhitia, nga Lluzhani i Podujevës, e cila ishte konsumuese e duhanit për 35 vite dhe e ka ndërprerë atë, tash përveçse që ndihet keq që e ka përdorur për një kohë aq të gjatë, ajo tani kërkon që edhe të ndalohet konsumimi i tij në ambiente publike.

"Kam konsumuar që 35 vite duhan dhe që një vit e kam lënë, mirëpo po ndihem shumë mirë dhe ndihem keq që e kam pirë gjithë ato vite. Duhet me e ndal duhanin patjetër në vendet publike e sidomos në kafene. Unë nuk mund të rri në ambientet ku pihet duhani" – është shprehur ajo.

Emini: Duhani duhet të ndalohet patjetër në vendet publike



Po këtë mendim ka edhe studentja Zejnepe Emini, e cila u bën thirrje të gjithë të rinjve që të mos jenë konsumues të duhanit, pasi që sipas saj konsumimi i tij është shumë i dëmshëm.

"Patjetër duhet të ndalohet duhani në vendet publike, sepse është i dëmshëm si për shëndetin, ashtu si për ambientin. Unë nuk jam konsumuese e duhanit, mirëpo u kisha bërë thirrje të gjithë atyre që konsumojnë duhan që mos ta bëjnë një gjë të tillë" – ka deklaruar Emini.

Hajrizi: Duhani të rregullohet sa më parë me ligj



Mirëpo edhe Bujari Hajrizi nga Skenderaj mendon se, pavarësisht asaj që është konsumues i rregullt i duhanit, një gjë e tillë duhet të ndalohet në vendet publike, pasi që, sipas tij, një gjë e tillë po i dëmton edhe duhanxhinjtë kronikë. Ai ka thënë se një gjë e tillë duhet të bëhet me ligj.

"Mendoj se duhani është i dëmshëm për ambientin e sidomos për vendet publike, por, pavarësisht kësaj, unë jam një konsumues i tij. Pirja e duhanit në vendet publike duhet të ndalohet. Për këtë është i nevojshëm një ligj nga Kuvendi i Kosovës. Por ai ligj duhet jo vetëm të miratohet, por edhe të zbatohet, sepse deri më tani janë miratuar shumë ligje, por nuk janë zbatuar" – ka deklaruar Hajrizi. ■



Mes shumë të këqijave edhe disa të mira



Avni AVDIU

Viti që po lëmë pas kaloi nëpër kapërcyellin e ndodhive të turbullta politike në Maqedoni. Krahas shumë problemeve, me liberalizimin e vizave, u duk sikur vendi mori një infuzion, që e këndelli deri-diku. Ideja se tashmë mund të dilet jashtë vendit, krijoi një lehtësim se, megjithatë, në raste të mosgjetjes së perspektivës, prapëseprapë, mund të ketë shtegdalje.

Shumë shenja të zymta recesioni, si pasojë e krizës globale, nuk japin edhe aq shpresë për vendin. Nga viti 2006 e këtej, mesatarisht në vit, numri i të varfërve në Maqedoni shënon shifrën prej 4100 familjesh të reja që jetojnë nën vijën e caktuar të varfërisë. Në Maqedoni, deri në fund të këtij viti, numri i të papunësuarve ka arritur shifrën rreth 380.000 të papunësuar. Mbi 30 mijë punonjës i humbën vendet e tyre të punës. Numri më i madh i të papunësuarve janë të rinj, janë në atë moshë kur janë më produktivë për të prodhuar zhvillim ekonomik. Shtimi i njerëzve të papunë do të thotë më pak shpenzime dhe mundësi më e vogël për rimëkëmbje ekonomike. E gjithë kjo ndikon në rritjen e numrit të rasteve sociale, duke e çuar vendin në një varfëri të skajshme.

Një numër i madh i të punësuarve nuk i marrin rrogat rregullisht, ndërsa pjesa tjetër as që marrin rroga me muaj të tërë. Të gjithë këta, të vetëdijshëm për situatën e rëndë ekonomike të vendit, vazhdojnë të punojnë me ato kushte, të cilat ju dedikohen nga punëdhënësit.

Sipas raportit të Bankës Botërore, më shumë se 30 për qind e popullatës në Maqedoni janë të varfër, që do të thotë çdo i treti është i varfër. Qytetarët e Maqedonisë, vjet jetuan në ankth dhe frikë ekonomike, për shkak se nuk mundën të siguronin gjërat elementare ushqimore për familjet e tyre. Më shumë se 60 mijë familje marrin ndihma sociale. Edhe të dhënat e fundit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale tregojë se mbi 250 mijë qytetarë të Maqedonisë jetojnë në kurriz të shtetit. Të gjitha këto të dhënat flasin për pamundësitë e qytetarëve për t'i siguruar nevojat e tyre elementare.

Të dhënat e fundit të Bankës Botërore (BB) tregojnë se gjatë vitit që lamë pas, indeksi i varfërisë në Maqedoni është rritur dhe çdo i treti qytetar është i varfër. Paralajmërimet për investime të huaja dhe hapjen e vendeve të reja të punës nuk ndodhën dhe vështirë se edhe gjatë vitit 2010 do të ketë rimëkëmbje ekonomike.

Qytetarët janë të pakënaqur me gjendjen e tyre të rëndë sociale që po mbizotëron. Me të prekur janë qytetarët e papunësuar dhe ata të cilët punojnë por nuk i marrin rrogat me rregull.

Mbi 800.000 qytetarë të Maqedonisë, gjatë vitit 2009, sipas raportit të BB-së, ishin në gjendje të blenin vetëm bukën, ndërsa për nevojat e tjera elementare as që bëhej fjalë.

Një shkëndijë drite në tunelin e errët

Me këtë nëntitull nuk kemi ndërmend të themi se ka shpresa për investime të huaja, përderisa Maqedonia vazhdon të rezistojë në mosndryshimin e emrit. Mirëpo qeveria, krahas kokëfortësisë nacionaliste, tregon edhe dozën e saj se është këmbëngulëse në plotësimin e standardeve evropiane. Këtë e dëshmoi me pajisjen e qytetarëve të saj me pasaportë biometrike. Këtë po e dëshmon edhe në fillim të këtij viti, duke treguar seriozitet maksimal në zbatimin e ligjit kundër duhanit. Tani e tutje duhanpirësit nuk do të mund të konsumojnë duhan nëpër kafene, bare, diskoteka, pub-e, në stadiume, ndërsa gjatë verës edhe në lokalet e hapura. Përveçse në ambiente të mbyllura, nuk do të mund të pihet duhan edhe në ballkone, banakë dhe në veranda, përkatësisht gjithkund ku shërbehet ushqim dhe pije.

Për mosrespektimin e ligjit, duhanpirësit do të paguajnë 100 euro, nëse zihen duke konsumuar duhan, ndërsa dënimet për mosrespektim nga hotelierët dhe ndërmarrjet janë prej 2.500 deri 4.500 euro, për personat përgjegjës është prej 100 deri 300 euro. Sipas ligjit për veprimtarinë hotelierike është paraparë edhe mbyllja e objektit në një kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Inspektorati i tregut shtetëror obligohet të kryejë kontroll në kafene, kafebare...., ndërsa në institucionet e tjera, ndalimin për pirjen do ta kontrollojë inspektorati sanitar shëndetësor, arsimor dhe ai i punës.

"Faktet dhe dëshmitë mjekësore tregojnë, qartazi dhe pa kurrfarë dyshimi, se pirja e duhanit lidhet me 25 arsye për vdekshmëri dhe është faktor numër një, në gjashtë prej tetë arsyeve kyçe të vdekshmërisë dhe është fakt se pirja e duhanit do ta vrasë gjysmën e duhanpirësve të tanishëm" - është shprehur ministri i Shëndetësisë së Maqedonisë, Bujar Osmani.

Nga 24 janari, edhe kutitë për cigare do të duhet që të përmbajnë etiketa me fotografi të organeve të dëmtuara të duhanpirësve. Prodhuesit kanë afat prej tre muajsh që t'i tërheqin ose t'i shesin paketimet e vjetra, të cilat nuk kanë etiketa.

Ligji për mbrojtje nga pirja e duhanit e ndalon edhe reklamimin e produkteve të duhanit në vende të mbyllura dhe në vende të hapura publike.

Në Maqedoni, në vit, pihen rreth 11.000 tonë cigare, ose individualisht çdo qytetar pi rreth 5,5 kilogramë cigare. ■



Shqiptarët dhe Bal



Mr. Milazim MUSTAFA

Ballkani i lënë pas dore. Dikur qendër e vendimmarrjes botërore, sot provincë dhe gjithnjë e më larg qendrave të vendimmarrjes botërore. Përveç problemeve të shumta ekonomike, me shtimin e viteve të kaluara, gjithnjë e më shumë shtohen edhe problemet ndërfqinjësore.

Një tokë pjellore që rriti dhe kultivoi çdo kulturë dhe civilizim. Mori elemente të secilës prej tyre dhe, po ta shikosh nga jashtë, mund t'i definosh si të duash, elemente edhe antike, edhe romake, edhe bizantine, edhe osmane, edhe komuniste, edhe evropiane edhe..., por në realitet po të ndalesh ta analizosh, do ta shohësh se në të nuk ka asgjë prej asnjërës prej tyre, gjithçka është gjysmake, gjithçka me tendencë eksploatimi dhe shkatërrimi nga kulturat pasardhëse, me përjashtime shumë të rralla, ku hasim mbijetesë të frymave të ndryshme kulturore dhe civilizuese.

Ka shumë studiues që shohin dhe dallojnë një kulturë ballkanike dhe civilizim ballkanik, por edhe më të shumtë janë ata që nuk arrijnë të gjejnë asnjë pikë të përbashkët midis shumicës së popujve dhe shteteve ballkanike. Kemi një Greqi që e llogarit veten si patron i antikitetit, si diçka të shenjtë për ta dhe se çdokujt që mundohet të prekë diçka në të i "shpallet luftë". Këtë më së miri e ndjeu Maqedonia, me rastin e shprehjes së vullnetit për identifikim të vetes me periudhën antike. Kemi një numër të madh të shqiptarëve, gjithashtu si popull i lashtë dhe vendas në këto troje, ku as për nga kombi, as për nga origjina, as për nga gjuha e feja nuk ka asgjë të përbashkët me fqinjët e vet gadishullorë. Pastaj një numër të madh të fqinjëve sllavë, të cilët përkundër origjinës së përbashkët, sot janë shtete të ndara, me gjuhë relativisht të ndryshme, me kisha të ndryshme, por edhe me mospajtime të shumta mes vete. Gjithashtu, në studimet për Ballkanin, asnjëherë nuk guxojmë t'i lëmë jashtë turqit (dikur osmanlinj), popull ky i cili për afër 6 shekuj qeverisi në këtë gadishull, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e tij.

Në këtë mixtum composum, hasim gjithçka dhe asgjë! Të gjithë këta popuj i bashkon ëndrra e përbashkët e të qenit në Evropën e Bashkuar, projekt ky që dekadave të fundit është bërë obsesion i këtyre vendeve. Disa prej vendeve ballkanike jetojnë me këtë ëndërr, por fati i të qenit njëkohësisht edhe në Evropë edhe në Ballkan, disi po ua mjegullon sytë, saqë problemet e bartura nga ballkanizmi nuk po i lënë të jetojnë të qetë ëndrrën evropiane, si rastet e korrupsionit, ksenofobisë, por edhe problemet e tjera ekonomike dhe sociale.

Vitin 2010 po e fillojmë me shumë probleme dhe me shumë sfida dhe shpresa. Si shqiptarë, ndonëse të shpërndarë gati në të gjitha shtetet ballkanike, vitin 2010 e kemi vit vendimtar, sikurse edhe të gjithë vitet e kaluara. Sepse, për ne, çdo vit është vendimtar. Kështu do të jetë deri në realizimin qind për qind të problemeve të pazgjidhura kombëtare.

Shpresojmë në një Shqipëri më të fortë ekonomikisht, më stabile politikisht dhe më aktive ndërkombëtarisht. Besojmë se investimet e shumta, sidomos në infrastrukturë, do t'i japin një pamje më serioze atdheut tonë. Por përkundër kësaj, çarjet e shumta pozitë-opozitë mund të reflektohen si problem serioz në procesin e kandidimit për në BE. Sepse, mungesa e dialogut politik di shumë herë të bëhet shkas për kritika gjatë këtij procesi. Por, mos të harrojmë se deri tash Shqipëria ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e pavarësisë së Kosovës. Këtë rol duhet ta luajë gjithnjë e më shumë edhe në vitin që vjen, sidomos në Organizatën e Konferencës Islamike, ku Shqipëria është anëtare. Gjithashtu, shpresojmë që ky vit t'ia hapë dyert Shqipërisë, sikurse Kosovës dhe Bosnjës, për lëvizje të lirë të qytetarëve të tyre për në shtetet e BE-së.

Gjithashtu edhe Kosova, si shteti i dytë shqiptar në Ballkan, sivjet feston 2 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së saj. Kosova është bërë vatër e stabilitetit, duke qenë shembull për shumë shtete përreth se si duhet të ndërtohet një shtet modern shumetnik, edhe pse shqiptarët përbëjnë mbi 90% të popullatës. Minoriteti serb gëzon hiç më pak të drejta se vetë shqiptarët në Kosovë, besa në disa raste janë edhe "pozitivisht të diskriminuar". Shpresojmë në një politikë më aktive të diplomacisë kosovare, sidomos në planin e njohjeve dhe në një unifikim të faktorëve politikë kosovarë në planin e politikës së jashtme, me qëllim të funksionimit si një zë i vetëm dhe më i fortë. Diplomacia kosovare më tepër duhet të angazhohet për njohje të reja, sidomos në vendet islame, të cilat fatkeqësisht ishin të lëna pas dore, por, në të njëjtën kohë, edhe në vendet e BE-së që akoma nuk e kanë njohur dhe të marrim hapin së bashku me vendet e tjera fqinje, të cilat akoma nuk e kanë realizuar procesin e integrimeve euro-atlantike. Them që t'i qasemi më seriozisht kësaj çështje, sepse përvoja e kyçjes së vendeve Ballkanike në EU ndaras, ka sjellë mjaft probleme, si shembulli i Greqisë me Maqedoninë, pastaj i Sllovenisë me Kroacinë, e kështu me radhë. Prandaj e kemi parasysh se çka do të ndodhte po të futej Serbia në BE para Kosovës.

Në Maqedoni është e njëjta këngë! Qeveria aktuale po e shpie shtetin drejt një



lkani në vitin 2010

rruge pa shtegdalje. Tentativat për ndërrimin e identitetit, respektivisht thirrjet gjithnjë e më të shpeshta për origjinën antike të maqedonasve të sotëm, nxitën reagim të ashpër te fqinji jugor, duke e bllokuar me veto anëtarësimin në NATO, por edhe pengesë e drejtpërdrejtë për marrjen e datës për bisedime me BE-në. Problem tjetër janë edhe marrëdhëniet ndëretnike, kryesisht në mosdisponimin e partisë maqedonase në pushtet për realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, por edhe shkeljen direkte të të drejtave të shqiptarëve, në të gjitha aspektet e mundshme. Përkundër pushtetit, thuajse absolut, që e gëzon kjo parti, ndihmues i madh i këtij diskriminimi është edhe faktori politik shqiptar, që as nuk po di, por as që po mundet t'i prezantojë dhe të luftojë për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Kjo ka sjellë deri te humbja e besimit të popullatës shqiptare tek përfaqësuesit politik, gjë që u pa me rastin e zgjedhjeve të fundit (parlamentare), ku dalja e shqiptarëve në këto zgjedhje ishte shumë e ulët. Viti 2010 për Maqedoninë shtron çështjen: të jesh a të mos jesh! Mendoj se nëse Maqedonia nuk gjen zgjidhje për çështjen e emrit me Greqinë, do të ketë krizë të brendshme politike, me ç'rast nuk përjashtohet edhe mundësia e zgjedhjeve të parakohshme. Shpresojmë në ngritjen e vetëdijes politike të shqiptarëve në RM, duke faktorizuar politikën shqiptare në këtë vend kompleks.

Nuk duhen harruar edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës, ose Kosovës Lindore. Ndoshta, pozita e tyre është më e vështirë, por edhe në këtë pjesë etnike shqiptare, duhet një qasje më serioze e faktorit politik shqiptar. Përkundër shpërnguljeve të shumta që bëhen drejt Kosovës (e tash edhe drejt Evropës, duke pasur parasysh se shqiptarët e kësaj ane, mund ta shfrytëzojnë beneficionin e lëvizjes pa viza drejt vendeve të zonës Shengen), duhet të zhvillohet një politikë edhe nga faktorët vendas, por edhe ata të Kosovës dhe Shqipërisë, për qëndrimin e shqiptarëve në këto troje. Përfundimisht, jemi të bindur se shqiptarëve të kësaj ane nuk ju duhen tetë a më tepër parti politike. Më tepër se kurrë duhet të ekzistojnë uniteti dhe prezantimi i interesave të shqiptarëve si në aspektin kombëtar, ashtu edhe në atë fetar. Duhet një zë dhe një synim i përbashkët! E njëjta vlen edhe për vëllezërit tanë në Mal të Zi, të cilët mendoj se janë mirë duke i menaxhuar interesat e tyre kombëtare dhe fetare, në këtë shtet relativisht të ri të Ballkanit, i cili është duke e ndjekur shumë seriozisht ëndrrën evropiane.

Pas gjithë kësaj, në këtë kolizion interesash dhe konfliktesh, Ballkani do të mbetet edhe për një kohë të gjatë kafshatë e dëshiruar për të gjitha forcat aktuale. Këtu janë kryqëzuar dhe kryqëzohen shtizat e të gjitha fuqive dhe superfuqive të mëdha. Nuk mohohet fakti i interesit amerikan në këtë rajon, sidomos pas bazës së Bond Still-it në Kosovë, pastaj "Ambasadës" në Shkup, por edhe ndikimit ushtarak me prezencën në Kosovë dhe vendet e tjera të rajonit. Pastaj edhe Rusia, kryesisht nëpërmjet investimeve të shumta në Serbi dhe Mal të Zi, mundohet të jetë aktive edhe në aspektin diplomatik në Ballkan. Viteve të fundit, mjaft aktive është edhe diplomacia turke, e udhëhequr nga shkolla e Davutogllit, e cila tenton rikthimin e ndikimit turk, nëpërmjet ruajtjes dhe kultivimit të frymës osmane nëpër vendet ballkanike.

Edhe përkundër gjithë kësaj, ne shpresojmë që ky vit të jetë një vit i përfitimeve tona, i përmirësimit të standardit tonë jetësor, i avancimit të të drejtave dhe lirive tona dhe i prezantimit sa më të mirë të imazhit tonë para botës. ■



Pasojat e përmbytjeve në

Reshjet e shiut të ditëve të fundit dhe hapja e portave të kaskadës së Drinit, si pasojë e mbushjes së tij, ka bërë që gjithë ultësira veriperëndimore e Shqipërisë të gjendet nën ujë. Uji ka vërshuar në banesat e mijëra banorëve, jeta e të cilëve është vënë në rrezik serioz. Ky është një problem që përsëritet çdo vit në këtë zonë, e megjithatë qeveritë nuk kanë marrë asnjë masë për eliminimin e tij.

Shiu vazhdon të bjerë mbi njerëzit, shtëpitë dhe tokat. Vetëm lajme të këqija vijnë nga parashikuesit e motit, ndërsa situata është tashmë e rënduar. Në luftën me ujin që u ka zënë gjithë hapësirën e jetës, banorët kanë ofertën e evakuimit dhe të kompensimit. Shumica e tyre nuk largohen nga shtëpitë, se nuk kanë garanci që ato do të jenë të sigurta.

Buna duket se tashmë nuk ndalet më, teksa vazhdon që të përparojë në brendësi të qytetit të Shkodrës. Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile njofton se ka mbërritur shumë pranë nivelit kritik gjendja në lumin Bunë. Aktualisht, niveli i lumit është 9.11 metra nga 9.25 që është pika kritike. Për këtë arsye mbledhja e Komitetit e zhvilluar në qarkun e Shkodrës ka lënë si detyrë kryesore vazhdimin e operacioneve të evakuimit.

Banorët e zonave të përmbytura në Shkodër, përveç ujit, tashmë duhet të kenë kujdes edhe faktin e prekjes nga sëmundjet infektive. Sipas specialistëve, ky është një rrezik real, për shkak të vërshimit të ujërave të zeza në rrugët e qytetit dhe fshatrave të përmbytura.

Emergjencat civile, të cilat kanë inspektuar zonën, thonë se në këtë përmbytje të fundit ka ndikuar hapja e portave të hidrocentralit të Shkopetit dhe Ulzës, por, shkaktari kryesor i kësaj përmbytjeje të rrallë është batica e detit, e cila ka ardhur shumë më e madhe se herët e tjera. Banorët e zonës së përmbytur janë shprehur se uji që ka hyrë në shtëpitë e tyre ka qenë i kripur, gjë që vërteton faktin e baticës. Dëmet që janë shkaktuar në banesa janë të shumta, por dëmi më i madh duket se është shkaktuar në kulturat bujqësore dhe në rezervat ushqimore. Banorët thonë se pjesa më e madhe e pajisjeve shtëpiake u janë prishur, ndërkohë që për fshatarët mjaft problem janë edhe bagëtitë, që kanë mbetur pa ushqim, pasi janë kalbur grazhdet që ata kishin grumbulluar për to. Ndërkohë, prurjet e shumta të ujërave kanë dëmtuar shtyllat elektrike, të cilat furnizonin me energji hidrovorin, që është jashtë funksionit, duke e bërë më problematike situatën në zonën e plazhit të Tales.

Nr.	Njësia vendore	Tokë e përmbytur	Persona të evakuuar	Shtëpi të përmbytura
1	B. Shkodër	250 hektarë	616	330
2	K. Dajç	2000 hektarë	2000	1187
3	K. Ana Malit	1200 hektarë	282	180
4	K. Velipojë	2000 hektarë	200	50
5	K. Bërdicë	2100 hektarë	810	368
6	K. Guri i Zi	1000 hektarë	730	210
7	K. Bushat	2500 hektarë	500	300
8	K. Qendër, M. Madhe	50 hektarë	10	8
9	**K.Rrethina**	**300 hektarë**	**25**	**16**
	Gjithsej	**11.400 hektarë**	**5148 persona**	**2649 shtëpi**

Shkrirja e borës rrit alarmin në Liqenin e Fierzës, në basenet e së cilës janë ngritur hidrocentralet kryesore në vend. Sipas të dhënave më të fundit nga KESH-i, prurjet në hidrocentralin e Fierzës si rezultat i rritjes së temperaturave, janë dyfishuar, duke shkuar në 800 metër kub ujë në sekondë nga 400 metër kub ujë në sekondë që ka qenë më parë.

Niveli i ujit në liqenin e Ohrit është në nivele maksimale, gjë që nuk mund të lejojë ndalimin e shkarkimeve në Drin. Madje, sipas ekspertëve, duhet të ketë më shumë derdhje në Drin për të ndaluar fryrjen e Ohrit, gjë që do të përkeqësonte situatën.



Situata vazhdon të paraqitet problematike për sa i takon nivelit të përmbytjeve; janë mbi 10 mijë hektarë të vërshuara nga uji dhe mbi 2400 shtëpi të përmbytura.

Hidrocentralet kryesore në veri të vendit janë duke shkarkuar sasi të konsiderueshme uji, si pasojë e mbingarkesës së krijuar nga reshjet e shiut dhe dëborës. Situata paraqitet alarmante, megjithatë KESH-i dhe stafi i tij janë duke u përpjekur të bëjnë një menaxhim sa më efikas.

Pasi situata emergjente në veriun e Republikës së Shqipërisë është përkeqësuar nga vërshimet e ditëve të fundit, Qeveria e Shqipërisë ka kërkuar zyrtarisht ndihmë emergjente humanitare nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri i FSK-së, Fehmi Mujota, autorizoi menjëherë komandantin e FSK-së, gjeneral Sylejman Selimin, që në koordinim me KFOR-in, të angazhojë Njësinë e Kërkim–Shpëtimit në kuadër të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), pjesë e Brigadës për Reagime të Shpejta, me qëllim të ofrimit të ndihmës për autoritetet shqiptare. Njësiti i FSK-së me pajisjet e nevojshme ka arritur në Shqipëri, ku operacionet e para i ndërmori në Vaun e Dejës. Pas deklarimit të NATO-s për arritjen e kapaciteteve të para operacionale, kjo është hera e parë që FSK-ja merr pjesë në një mision humanitar jashtë shtetit.

Ministri i Brendshëm, Lulëzim Basha, në cilësinë e kryetarit të Komitetit të Emergjencave, konfirmoi mbërritjen e forcave italiane të specializuara për menaxhimin e situatës. Thirrjes së autoriteteve shqiptare për ndihmë, u janë përgjigjur dhe shtetet e tjera si: Greqia, Austria, Sllovenia etj.

Qeveria e Kosovës ka vendosur që t'u vijë në ndihmë banorëve të zonave të

Shqipëri

përmbytura në Lezhë dhe Shkodër, duke ofruar shumën prej 200 mijë eurosh.

Komuna e Gjakovës ka hapur dyert për banorët që u janë përmbytur banesat në qarkun e Shkodrës. Me nismën e një grupi të qytetarëve të Gjakovës, mësohet se është ofruar mikpritje për 200 familje të prekura nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës. Komuna e Gjakovës dhuroi një shumë prej 10 mijë eurosh në ndihmë të familjeve të përmbytura, ndërsa një gjë të tillë e bëri edhe komuna e Podujevës, që dhuroi 20 mijë euro. Edhe Prizreni dhe qytete të tjera të Kosovës janë sensibilizuar për gjendjen e krijuar, duke ofruar ndihmën aq shumë të nevojshme.

Historiku

150 vjet më parë (më 1858) ndodhi ajo që mund të quhet katastrofa më e rëndë hidrike e imagjinueshme. Deri në atë kohë, lumi Drin derdhej i tëri në Lezhë, një qytet që përdorej edhe si port. Por atë vit, prurjet e stërmëdha bënë që Drini të hapë një degë të re që quhet Drinash dhe që aktualisht derdh pjesën më të madhe të ujit në Bunë. Ky ndryshim solli pasoja të gjithanshme. Liqeni i Shkodrës rriti me dy ose tre metra nivelin e tij të mëparshëm, duke përmbytur qindra hektarë toka. Në anën malazeze, një zonë që në Mesjetë njihej me emrin Principata e Zetës, humbi të gjitha tokat. Qyteti historik i Shkodrës, i cili në atë kohë ndodhej përreth kalasë së Rozafës, filloi të përmbytej rregullisht, disa herë në vit. Për pasojë, familjet e pasura filluan të zhvendosen dhe ndërtuan shtëpitë e tyre dy kilometra më në veri, aty ku gjendet sot. Lagjja e vjetër u braktis ngadalë për banim, por vijoi të shërbejë si treg. Në fushën poshtë kalasë së Shkodrës mbetet Xhamia e Plumbit, një ndërtesë e vitit 1768. Ajo gjendej këto ditë rreth një metër nën ujë. Përgjatë viteve, xhamia ka kryer rolin e një destinacioni turistik për përmbytjet. Sa herë që ka përmbytje, aq here xhamia jep shansin për një foto të shkëlqyer domethënëse për përmbytjen. Në vitet '80, qeveria komuniste shqiptare hartoi një plan që mund ta rikthente historinë përmbys. Projekti për ndërtimin e hidrocentralit të Bushatit mund të risistemonte rrjedhën e poshtme të Drinashit, të pakësonte prurjet në Bunë dhe të ulte ndjeshëm nivelin e liqenit të Shkodrës, duke çliruar disa qindra hektarë tokë. Por logjika e atëhershme e çlirimit të tokave të bukës nuk bindi askënd. Liqeni i Shkodrës është një burim ekonomik më i mirë kështu siç është sot. Qeveria shqiptare u detyrua të heqë dorë nga hidrocentrali i Bushatit dhe e zëvendësoi atë me hidrocentralin e Ashtës, i cili nuk do të ketë ndikim në sistemin vjetor të derdhjeve të Drinit, pasi do të jetë hidrocentral pa digë. Përmbytjet e Drinashit në zonën e Nënshkodrës u rralluan pas ndërtimit të hidrocentraleve, të cilat zakonisht grumbullojnë ujin kur vjen me tepri dhe e përdorin kur vjen me pakicë. Por në vitin 2002, pas fillimit të krizës energjetike, skema e shfrytëzimit të Kaskadës së Drinit u ndryshua. Nën stresin për të garantuar furnizim me drita sa më të mirë, hidrocentralet mbahen të mbyllura edhe në nëntor, pasi shirat mund të vonojnë. Për rrjedhojë, pothuajse një herë në tre vjet, shirat vijnë me



furi, ndërkohë që liqenet janë plot. Siç ndodhi gjatë javës së fundit, një situatë e tillë shoqërohet me përmbytje.

Mos dhashtë Zoti: Ekziston gjithmonë mundësia që nga shpatet e maleve, anës ujëmbledhësit të Fierzës, të shkëputen masive të mëdhenj shkëmborë. Kjo është një mundësi, jo vetëm teorike, por dhe praktike. Rënia e këtyre masiveve mund të shkaktojë dallgë të forta në liqen që përplasen në kurorën e digës. "Nuk dua të flas për këtë mundësi. Është e tmerrshme. Por edhe më e tmerrshme është nëse kalon niveli i ujit mbi digë. Shpërthimi i tyre do ta çonte Shqipërinë në epokën e gurit, nuk do të kishte më Shkodër, Lezhë, në Tiranë uji do të vinte për 30-40 minuta dhe do të kishte thellësinë 30 centimetra. Dallga e cunamit do të mbërrinte deri në Ankona" - thotë inxhinier Cico. ■

Përmblodhi: A. Avdiu



Haxhimusa: Sjelljet e pahijshme të gjyqta

"Ardhja ndesh me këto postulate është gjëja më e shëmtuar për gjyqësorin, sepse me sjellje të pahijshme humbet besimi në vetë gjyqësorin dhe sjelljet e këtilla dëmtojnë në thelb sundimin e ligjit, i cili është kusht për shtetin ligjor dhe demokracinë e mirëfilltë", -ka thënë kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës Rexhep Haxhimusa



Qendresa MUSTAFA

Prishtinë - Dymbëdhjetë gjyqtarë të Kosovës janë suspenduar për vepra të ndryshme penale që nga paslufta e deri më sot. Ata dyshohen se këto vepra i kanë kryer në vendet e punës, ku kanë shërbyer me vite të tëra.

Sipas të dhënave të Gjykatave në Kosovë, gjyqtarët e suspenduar janë: Drita Hoxha, Selman Bogiqi, Bedri Krasniqi, Elez Hoxha, Ukë Muçaj, Sudan Gorani, Shefqet Xhelili, Xhevat Bici, Adem Tasholli, Baki Azemi, Abdullah Robaj dhe Zef Prenaj.

Në anën tjetër, kryetari i Gjykatës Supreme, Rexhep Haxhimusa, ka thënë se suspendimi i gjyqtarëve është gjëja më e shëmtuar për gjyqësorin, pasi që krijohet një humbje e besimit për këtë institucion.

"Ardhja ndesh me këto postulate është gjëja më e shëmtuar për gjyqësorin, sepse me sjellje të pahijshme humbet besimi në vetë gjyqësorin dhe sjelljet e këtilla dëmtojnë në thelb sundimin e ligjit, i cili është kusht për shtetin ligjor dhe demokracinë e mirëfilltë",- ka thënë kryetari Haxhimusa.

Në anën tjetër, statistikat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) tregojnë se çdo vit ka gjyqtarë të suspenduar me pagesë për shkak të shkeljes së ligjit.

Haxhimusa: Suspendimi i gjyqtarëve krijon humbjen e besimit te gjyqësori

Kryetari i Gjykatës Supreme, Rexhep Haxhimusa, ka thënë për revistën "Paqja" se nuk mund të promovohet sundimi i ligjit nëse humbet besimi i qytetarëve ndaj drejtësisë.

"Unë konsideroj se nuk mund të promovojmë sundimin e ligjit, nëse humbet besimi i qytetarëve ndaj ndarjes së drejtësisë, gjë që mund të ndodhë qoftë edhe kur një person i vetëm shet drejtësinë ose vepron pa e respektuar etikën e gjyqtarit", - është shprehur ai.

"Vetë fakti se nga gjyqësori i Kosovës kemi larguar disa gjyqtarë dhe prokurorë për shkelje të ndryshme, flet për seriozitetin me të cilën ne, si gjyqësor, e trajtojmë pastërtinë e figurës së gjyqtarit", - ka thënë kryetari Haxhimusa.

Sipas tij, gjyqtarët përveç zbatimit të ligjit duhet të posedojnë edhe vlera të larta etike.

"Gjyqtarët por edhe prokurorët dhe të gjithë të tjerët që merren me zbatimin e ligjit, përveç njohurive dhe shkathtësive profesionale, duhet të posedojnë edhe vlera të larta etike. Këto virtyte janë të domosdoshme për ndarjen e drejtësisë, në të cilën do të besojnë qytetarët që kërkojnë shërbime dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre nga ana e gjykatave" , - ka deklaruar Haxhimusa.

Ai është shprehur se shoqëria kosovare, historikisht ka vuajtur për një sistem të mirëfilltë të drejtësisë, në të cilin qytetari do të ndihej i sigurt se do të gjejë drejtësi në rastet e shkeljeve të të drejtave të lirive themelore të tij.

Statistikat e Këshillit Gjyqësor:

Sipas statistikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) vetëm gjatë periudhës një vjeçare, 2007-2008, janë suspenduar me pagesë tetë gjyqtarë për shkak të shkeljes së ligjit dhe të gjitha këto raste janë nën hetime.

Në statistikat e KGJK-së thuhet se gjatë vitit 2007, në Gjykatat Komunale të Kosovës janë suspenduar vetëm dy gjyqtarë për shkak se kanë rënë ndesh me ligjin, ndërsa gjatë vitit 2008 në Gjykatat Komunale kemi tri raste të suspendimit, në Gjykatat e Qarkut dy, ndërsa ne Gjykata për Kundërvajtje kemi vetëm një rast ndaj gjyqtarëve të suspenduar me pagesë.

Edhe Bedri Krasniqi, ish-gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në janar të këtij viti, po për të njëjtën vepër penale sikurse Xhelili, është dënuar me pesë muaj burgim nga Gjykata e Qarkut në Prizren, nën akuzat se ka kryer veprën penale të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore.

Krasniqi dyshohet se në vendin e tij të punës, duke punuar si gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gjatë seancës gjyqësore për konfirmimin e aktakuzës së datës 19 korrik 2007, të cilën e drejtonte në cilësinë e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës, me qëllim që të dëmtuarve Elham, Avni, Beqri Gavazi dhe Mihane Dema t'u shkaktojë dëm dhe t'u mohojë të drejtën e të dëmtuarit, kanë nxjerrë vendim të kundërligjshëm, duke konfirmuar aktakuzën e dorëzuar nga prokurori i Qarkut Xhevat Danqe, kinse e depozituar në gjykatë me datë 19. 7. 2007, në të cilën nuk ishin Qamush Bekteshi dhe Isuf Bekteshi të akuzuar për veprën penale 'lëndim i rëndë trupor' dhe nuk i njoftoi të dëmtuarit me të drejtën e ndërmarrjes së ndjekjes penale. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren për gjyqtarin


Rexhep Haxhimusa

arëve dëmtojnë në thelb sundimin e ligjit

Bedri Krasniqi ende nuk ka marrë formën e prerë.

Nën hetime nëntë gjyqtarë të Kosovës

Vetëm nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjatë këtij viti janë suspenduar pesë gjyqtarë, nën dyshimin se kanë kryer vepra të ndryshme penale.

Elez Hoxha, ish-gjyqtar i kësaj gjykate, në qershor të këtij viti është arrestuar në vendin e punës nga pjesëtarë të njësitit të specializuar të Policisë së UNMIK-ut, së bashku me pjesëtarë të Policisë së Kosovës (PK). Hoxha dyshohet se ka kryer veprën penale marrje ryshfeti sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës.

Me propozimin e PSSP-se edhe Drita Hoxha, gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, është suspenduar gjatë muajit maj-qershor të vitit 2008. Hoxha dyshohet se ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Rasti ndaj gjyqtares Hoxha është ende nën hetime.

Abdullah Robaj ish-gjyqtar hetues në Gjykatën Supreme të Kosovës, po ashtu, është në mesin e të suspenduarve me pagesë. Në vitin 2002, Robaj dyshohet ta ketë keqpërdoruar pozitën zyrtare, duke i bërë shantazh bashkëshortes së një të dyshuari që gjyqtari i kishte caktuar masën e paraburgimit prej 30 ditësh.

Zef Prenaj është gjyqtari tjetër i suspenduar. Ai, si gjyqtar penalist në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, dyshohet se ka kryer së paku dhjetë shkelje të rënda ligjore. Prenaj ka një dosje në Njësinë e Inspektoratit Gjyqësor (NJIGJ), organ, i cili ka vepruar në kuadër të ish-Departamentit të Drejtësisë në UNMIK.

Nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë është suspenduar edhe gjyqtari Xhevat Bici, i cili dyshohet të ketë kryer veprën penale: marrje të ryshfetit.

Ndërsa dy nga gjyqtarët e suspenduar nga KGJK janë edhe Adem Tasholli dhe Baki Azemi nga Gjilani dhe Lipjani. Ata janë dyshuar për përfshirje në korrupsion dhe për thyerjen e Kodit të Etikës profesionale.

Në Gjykatën e Qarkut në Pejë është nën hetime gjyqtari Ukë Muçaj. Ndaj tij është ngritur kallëzim penal nën dyshimin se ka kryer vepra penale mitmarrje dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Që prej dy muajsh ai nuk e ushtron detyrën e gjyqtarit në këtë gjykatë. Muçaj akuzohet për marrje të mitos, respektivisht marrje të 12 mijë eurove. Për këtë rast hetimet kanë filluar plot 16 muaj më parë nga njësitet kundër krimeve serioze të rajonit të Pejës. Me t'u kompletuar lënda, ajo i ishte dërguar Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë, ndërsa me ndërmjetësimin e Prokurorisë së Kosovës dhe sipas ligjit të ri, lënda i është dorëzuar Prokurorisë Komunale në Prishtinë.

Në Gjykatën e Qarkut në Pejë është nën hetime edhe gjyqtari Sudan Gorani, i cili, po ashtu sikurse kolegu i tij, dyshohet të ketë kryer veprën penale: keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Dy gjyqtarë të dënuar për veprën penale: nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve

Ish-kryetari i Gjykatës Komunale në Gjilan, Shefqet Xhelili, është dënuar me gjashtë muaj burgim në vitin 2006 nga Gjykata Komunale e Prishtinës për veprën penale: nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore. Plotfuqishmëria e vendimit ndaj ish-kryetarit Xhelili është bërë nga kolegji i gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i udhëhequr nga gjyqtari Isak Ademi. Ish-kryetari Xhelili, njëherësh edhe gjyqtar, sipas diapozitivit të aktakuzës së Prokurorisë, si kryetar në Gjykatën Komunale kishte nxjerrë një vendim me të cilin kishte vendosur që të bëhej ndarja fizike e pasurisë së paluajtshme në emër të propozuesve Stojanoviq Jovan, Stojadin, Aleksander dhe Stojanoviq Trajka dhe në dëm të Stajnokoviq Qedomir, Pavle, Stojanka, Zlata si dhe Tasiq Sllavisha, Kruna, Radoslav, Mitra dhe Tasiq Mirosllav.

Një gjyqtar i liruar nga vepra penale

Selman Bogiqi është suspenduar nga pozita e gjyqtarit të procedurës paraprake, që ai e ushtronte në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, që nga momenti që ndaj tij ka filluar hetimi. Pas mbajtjes së tetë seancave në Gjykatën e Qarkut në Prizren, Bogiqi është liruar nga vepra penale e shkeljes së fshehtësisë zyrtare nga neni 347, par.1 i KPPK-së.

Ish-gjyqtari Bogiqi kishte filluar punën në vitin 1999, si gjyqtar hetues, e pastaj si gjyqtar në konfirmimin e aktakuzave dhe gjyqtar i Procedurës Paraprake. ■



Rulèt greke për Shqipërinë



Avni XHEMAJLI


Na ishte njëherë jo edhe shumë kohë e largët, kur trojet shqiptare kishin një territor prej më shumë se 100000 km². Na ishte njëherë edhe një njeri, një burrështetas që pati rastin ta bënte Arbërinë. Na ishte dhe çfarë nuk na ishte njëherë; por që, lidhja e miqësive me armiqtë, pozicionimet politikisht të gabuara nga liderët shqiptarë, lidhja në dëm të shqiptarëve e traktateve dhe marrëveshjeve shpeshherë edhe të fshehta nga ana e ndërkombëtarëve dhe jo rrallëherë edhe nga vetë shqiptarët në dy shekujt e fundit dhe madje edhe tani 'matanë e këtë anë të kufirit', solli një tkurrje të paparë të hapësirave tokësore shqiptare, ngjashëm si tkurrjen e mishit kur hidhet mbi tiganin me vaj të nxehtë e që servohet pastaj në pjatë të huaj.

Si rezultat i gjithë këtyre veprimeve të gabuara politike e diplomatike të udhëheqësve shqiptarë, trojet shqiptare sot të shpërndara e të mbetura nën sovranitetin e shteteve fqinje si Presheva, Bujanovci e Medvegja nën Serbinë, hapësirat territoriale shqiptare nën Maqedoni, trevat shqiptare të mbetura nën Malin e Zi, si dhe Çamëria nën Greqi, solli tkurrjen përmbi 60% të territorit nga ajo që trojet shqiptare e kishin dikur; e që për nga madhësia e pamja si një tërësi e vetme hapësinore do t'i ngjante sot pak a shumë territorit të sotëm të Portugalisë.

Fatkeqësisht kjo tkurrje e territoreve në dëm të shqiptarëve po vazhdon edhe sot e kësaj dite. Derisa rulèta ruse vazhdoi të zbrazet llahtarshëm në GJND kundër Kosovës, së fundi edhe rulètet maqedonase dhe malazeze po zbrazen në juglindje dhe perëndim të saj, sikur edhe rulèta serbe në veri tash e sa kohë. Ndërkaq, në anën tjetër, tani edhe rulèta greke po shkrep furishëm në jug të Shqipërisë përsëri.

Loja e grekëve nuk është edhe gjithaq e panjohur me rulèt ruse herë me Turqinë, herë me Çamërinë, herë me Maqedoninë, herë-herë edhe me Bullgarinë; ndërsa tani, po luan rulèt greke me Shqipërinë. Po aq është e njohur që grekët gjithmonë kanë synuar të marrin në posedim ngushticat si Bosforin dikur, ose hapjen e ndonjë ngushtice tjetër si kanalin e Korintit, ose zënien e ndonjë ngushtice si ngushticën e Termopileve pranë brigjeve të detit, ngushticë, të cilën mbreti grek i spartanëve Leonidas e zuri dikur, ku edhe pat zhvilluar betejën me 300 ushtarët e tij kundër perandorisë më të madhe të kohës së mbretit persian, Kserksit, deri në fund.

Ndërsa deri në fund, këtej radhe grekët i shkuan një tjetër beteje, jo me "Leonidas" as me "Akilin"... Këtej radhe ata ia mësyn një ngushtice tjetër, t'ia marrin Shqipërisë ngushticën e Otrantos. Dhe jo me luftë, as më dhunë, por me bukurinë që vret, me dorën që e dërguan në Tiranë, me të cilën si duket arritën t'ia mpinë mendtë Bashës, ngjashëm siç ia mpinë dikur rusët e grekët së bashku Pashës në Janinë, ashtu siç edhe e gjejmë në dramën e shkrimtarit Milazim Krasniqi *"Rulet ruse për Ali Pashën"*, botuar nga Arbëria në 2004. Në këtë vepër autori e paraqet rastin e njeriut, e burrështetasit Ali Pashë Tepelena që pati rastin ta bënte Arbërinë. Ai jo që fitoi, jo që e bëri Arbërinë, por e humbi edhe kokën e tij, e humbi edhe kokën edhe Arbërinë, e humbi duke luajtur me rulèt ruse, grekët e rusët së bashku. Dhe me këtë humbi edhe njëra nga pjesët më të bukura të trojeve shqiptare, duke i kaluar dorës greke.



Tani historia po përsëritet, humbja po përsëritet. Po përsëritet ngase s'kemi nxjerrë si duket kurrë ndonjë prej saj. Po përsëritet edhe diçka tjetër, loja më rulèt, këtej radhe loja me rulèt greke. Dhe gjithçka ishte gati që loja të fillonte, kur më 27.04.2009, ministri i punëve të jashtme i Shqipërisë, Lulëzim Basha dhe homologia e tij greke Dora Bakojanis, nënshkruan në Tiranë marrëveshjen për delimitimin e kufirit detar, e cila për opinionin e gjerë publik erdhi si krejt e papritur dhe jo transparente. Sigurisht sepse ishte lojë me rulèt dhe s'mund të luhej ndryshe. Për këtë arsye marrëveshja detare ose siç u quajt: "Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të Shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare"- u përmbyll nga pala greke në një kohë rekord prej vetëm tri takimeve, duke ushtruar vazhdimisht presion mbi palën shqiptare, të cilën ministrja e punëve të jashtme e Greqisë, Dora Bakojanis, menjëherë pas miratimit të saj në parlamentin grek e quajti si arritje historike e strategjike.

Bakojanis nuk e tha pa ndonjë arsye këtë gjë. E tha për arsye se pala greke doli fituese, shumëfish bile, kurse ajo shqiptare humbëse e vërtetë nga kjo marrëveshje. Ish-drejtori i Institutit Gjeografik të Shqipërisë, Dr. Myslim Pasha, në studimin e tij prej 117 faqesh në lidhje me këtë çështje sjell argumentet e tij teknike dhe hartografike për rishqyrtimin dhe mosratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Ai thotë se kjo marrëveshje shkel sovranitetin kombëtar të Shqipërisë, duke i dhuruar hapësira detare vendit fqinj, në bazë të së cilës Shqipëria pëson një tkurrje të hapësirës detare në një sipërfaqe prej 354 km², si dhe në gjirin e Sarandës si njëra nga vendet më të rralla dhe më të bukura turistike që shquhet për bukuritë e rivierës shqiptare të detit Jon, ku humb një sipërfaqe detare prej 15 km², hapësirë e cila në marrëveshjen e lartpërmendur është trajtuar


si vijë e zakonshme bregore, edhe pse është det shtetëror i Shqipërisë. Kurse në kuadër të sipërfaqes së humbur detare prej 354 km² hyn edhe humbja e sipërfaqes në ngushticën e Otrantos që gjendet mes Shqipërisë dhe Italisë si një nga pjesët detare më strategjike të saj.

Edhe kësaj radhe, Greqisë si duket rulèta i shkrepi mirë duke vrarë tri shënjestra me një plumb, sepse humbja e hapësirës territoriale të detit shqiptar duket të mos jetë humbja e vetme për Shqipërinë, që del si rezultat i kësaj marrëveshjeje, e cila sipas të gjitha gjasave do ndikojë që Shqipëria të mbetet jashtë përfshirjes në projektet ndërkombëtare energjetike. Ish-z.ministri i energjetikës Pajtim Bello zbuloi para mediave prapaskenat e një debati të hershëm të zhvilluar mes Tiranës dhe Athinës, objekt i së cilës ishte gazsjellësi, i cili do të transportojë gazin e Kaspikut nga Turqia për në Itali përmes territorit tokësor të Greqisë dhe më pas përmes detit për të arritur në tregun e madh evropian, nevojat energjetike të së cilës janë në rritje çdo ditë e më shumë. Pala shqiptare në atë kohë kishte shtruar propozimin që gazsjellësi, i cili do të ketë një kapacitet prej 2.5 miliard m³, të përfshijë edhe Shqipërinë duke kaluar përmes luginës së lumit Vjosa për të dalë pastaj në gjirin e Sarandës dhe prej aty përmes ngushticës së Otrantos të kalojë për në Itali, propozim, i cili u mirëprit nga Brukseli por që u refuzua ashpër nga Athina. Ndërsa tani me humbjen e hapësirës detare, kjo gjë bëhet edhe më e pamundur që të realizohet.

Kurse përfitimi i milionave përmes transportimit të gazit përmes gazsjellësit të planifikuar duket të mos jetë benificioni i vetëm i shënuar nga kjo marrëveshje për Greqinë. Gjasat janë reale që Greqia, përmes hapësirës detare të fituar nga marrëveshja e shënuar, të përfitojë miliona euro edhe nga ndonjë burim i mundshëm nafte që gjendet aty. Në lidhje me këtë gjë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore e Shqipërisë na bën me dije se në këtë zonë ka naftë. Qeveria shqiptare, në vitin 1992, kishte zhvilluar në këto hapësira detare kërkimin e burimeve të naftës, duke angazhuar në atë kohë kompaninë australiane Helinton Oil dhe më pas edhe kompaninë BHB, të cilat shpenzuan 12,5 milionë dollarë. Në vitin 2007 qeveria shqiptare angazhoi përsëri një kompani për hulumtimin e burimeve të naftës, kësaj radhe kompaninë britanike Medoil dhe sipas të gjitha gjasave del se në këtë hapësirë detare duhet të ketë naftë.

Lidhur me çështjen e interesave ekonomike që ka Greqia nga kjo marrëveshje, koloneli në rezervë i Forcave të Armatosura Shqiptare, Myslim Pasha, tregon se prirja e një pale të tretë - që në këtë rast është Greqia në raport me Shqipërinë dhe Italinë - për t'u futur në hapësirën e Otrantos është prirje, e cila është krejtësisht në kundërshtim me konventën e detit, ku në një nga neni e saj thotë: *"Asnjë shtet i tretë nuk ka të drejtë që të vendosë viza të drejta bazore, për të ndërprerë detin shtetëror, hapësirën e afërt vijimore dhe hapësirën ekskluzive ekonomike të shtetit tjetër."*

Po ashtu, Myslim Pasha, i cili është topografi dhe eksperti i matjeve detare thekson edhe një shkelje tjetër nga pala greke, edhe pse në nenin e parë të marrëveshjes shprehet qartë parimi i respektimit të baraslargësisë së kufijve mes dy shteteve ku thuhet: *"Kufiri ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë do të saktësohet në përputhje me parimin e baraslargësisë. Në mënyrë specifike vija e delimitimit do të jetë vija e mesme, çdo pikë e së cilës është e baraslarguar nga pikat më të afërta të vijës bazë, si kontinentale ashtu edhe ishullore nga e cila matet gjerësia e ujërave territoriale detare."* Eksperti i matjeve detare, Myslim Pasha, tregon se në hartimin e marrëveshjes së kufirit detar, mes pikës më të afërt bregdetare të Shqipërisë dhe mes ishullit të Korfuzit të Greqisë, në këtë hapësirë që është mjaft e ngushtë mes të dy vendeve, janë përdoru si pika referuese edhe shkëmbinjtë nënujorë, që shpeshherë zhduken nga sipërfaqja ujore dhe nuk duken për një kohë të gjatë. Ai thotë se në këtë zonë detare, kjo lloj matjeje që përfshin kryesisht detin mes gjirit të Sarandës dhe ishullit grek të Korfuzit, është absolutisht e papranueshme në këtë rast, sepse një matje e tillë e hapësirave detare ku përdoren edhe shkëmbinjtë nënujorë si p.sh. që në këtë rast është përdorur shkëmbi Barketa, vjen në konsideratë vetëm në hapësirat e mëdha detare ku nuk ka pika bregdetare referuese, kurse assesi në hapësira të ngushta siç është rasti mes bregut të Sarandës dhe ishullit grek të Korfuzit, ku brigjet e njërës dhe tjetrës palë shihen edhe me sy.



Prandaj marrëveshja e shënuar mes Shqipërisë dhe Greqisë në pranverë të vitit 2009, e cila tani gjendet në Gjykatën Kushtetuese për shkak të animimit të opozitës,dhe e cila nuk është bërë ende e plotfuqishme përfundimisht, e tillë siç, është e papranueshme, kështu që duhet të shfuqizohet dhe të bëhet rishqyrtimi i saj. Përndryshe edhe Shqipëria rrezikohet seriozisht t'i shkojë në bisht të sorrës territori i saj detar dhe shumë të mira të tjera materiale, ngjashëm siç i shkuan në bisht të sorrës Kosovës 22 hektarë nga marrëveshja e delimitimit kufitar që bëri me Maqedoninë, gjë me të cilën, sipas të gjitha gjasave, ka humbur rastin për ndërtimin e një hidrocentrali të përbashkët mes dy vendeve që ishte planifikuar më herët të bëhej në atë zonë.

Dhe e gjithë kjo nuk është një dramë imagjinare. Ajo është e vërtetë, sikurse që janë të vërtetë edhe aktorët e saj. Andaj, liderë e politikanë gjithandej trojeve shqiptare, merrni pak mësim nga historia që të ruheni nga përsëritja e mallkimi i saj - siç porosiste Hasan Prishtina; merrni pak mësim nga drama *"Rulèt ruse për Ali Pashën"*, që të ruheni nga prototipi i ushtarakëve, diplomatëve si Vladimiri, Kosta, e Aleksisi, si dhe nga hijet e nga gratë që jep e që sjell drama; edhe nga prototipi i politikanëve si: Churkin, Jeremiq, Lavrov, Gruevski e Putin. Por, ama, ruhuni edhe nga dora e profili i diplomatëve si Dora Bakojanis, që mban fshehur në dorë ruletën drejtuar Shqipërisë. ■

Homoseksualizmi



Dukagjin AVDYLI

Sipas përkufizimit psikologjik, homoseksual quhet personi që tërhiqet seksualisht nga një person tjetër, i cili ka të njëjtën gjini me të, për dallim nga njerëzit e tjerë që i tërheq gjinia e kundërt.

Në Shqipëri, kohëve të fundit, homoseksualizmi ka lëvizur drejt "suksesit", nëse mund të thuhet kështu qoftë edhe nën thonjëza. Kryeministri Sali Berisha, më 31 korrik 2009, dha një deklaratë se do të miratohet ligji kundër "diskriminimit", me qëllim që t'u përmirësohet gjendja homoseksualëve.

Ndaj kësaj deklarate, menjëherë, të nesërmen pasoi reagimi i shoqatës së homoseksualëve dhe kategorisë së tyre në Shqipëri, në të cilin thuhej tekstualisht: "Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBT-së (lesbikeve, gay-ve, biseksualëve dhe trans-gjinorëve) e mirëpriti deklaratën e kryeministrit Berisha në mbështetje të Ligjit kundër diskriminimit dhe të drejtës së martesës për personat gay në Shqipëri."

Këtij lajmi nuk iu gëzuan vetëm homoseksualët në Shqipëri, po edhe armata e homoseksualëve italianë matanë Adriatikut, të cilët i duartrokitën fort kësaj deklarate, ngase ishin shumë të lumtur për mundësinë që atyre do t'u ofronte Shqipëria në një të ardhme të afërt. Dhe si pasojë e kësaj, homoseksualët italianë deklaruan se: "do ta braktisin Italinë e do të shkojnë të jetojnë në Shqipëri, ngaqë atje do të ofrohen kushte ideale për ushtrimin e lirë të homoseksualitetit". Normalisht ata ndihen të lumtur, sepse Shqipëria do t'u mundësojë atyre të ushtrojnë veprimtarinë, të cilën shteti i tyre nuk po ua lejon assesi. Mirëpo, si duket homoseksualët janë gëzuar pakëz herët, ngase kanë hasur në një kundërshtim të fortë të kishës katolike, asaj ortodokse, si edhe të Komunitetit Mysliman shqiptar, të cilët kanë reaguar ashpër ndaj qëndrimit të kryeministrit Sali Berisha për të mbështetur ligjërisht martesat e homoseksualëve në Shqipëri. Edhe pse kreu i qeverisë shqiptare i ka paraprirë hapjes së një debati të fortë lidhur me këtë çështje, duket se nuk e ka llogaritur reagimin kaq të ashpër të të gjitha komuniteteve fetare kundër deklaratës së tij. Madje, as veshja e kësaj deklarate nën petkun e eliminimit të diskriminimit, ose arritjes së standardeve dhe integrimit evropian, duket se nuk do ta shpëtojnë qeverinë Berisha nga nomatisja fetare - thonë mediat në Shqipëri.

Por, edhe nëse arrin një projektligj në Parlament, që e paralajmëroi kryeministri Berisha, për t'ua lejuar homoseksualëve martesën, prapëseprapë Kodi Shqiptar i Familjes nuk i lejon martesat brenda gjinisë së njëjtë. Më parë duhet ndryshuar Kodi i Familjes dhe për këtë nevojiten 84 vota nga 140 deputetë. Një shpjegim i tillë vjen nga Aureola Anastasi, drejtore e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Ajo thotë se "nuk ka një pikë në draftin e përgatitur nga organizatat për të drejtat e njeriut në vend, ku do të kërkohej legjitimimi i martesave mes homoseksualëve, por edhe nëse do të kishte një të tillë, ky ligj nuk do të mund të kalonte për miratim në Parlament, pasi më parë do të duhej të ndryshohej Kodi i Familjes".

Por, a thua edhe sa do të zgjasë ndalimi i martesës ndërmjet homoseksualëve në Shqipëri?! Kjo varet se sa e fortë do të jetë dëshira e shqiptarëve për të hyrë në Evropë. E hyrja në Evropë i ka disa kushte që duhet plotësuar. Një prej këtyre kushteve është edhe legalizimi i homoseksualizmit dhe trajtimi i kësaj kategorie më me "dinjitet", sipas BE- së. E këtë nuk po e them sa për të thënë diçka, por këtë e tha Komisioni Evropian, në Raportin e Progresit për Shqipërinë, për vitin 2009. Në këtë raport, në pjesën për të drejtat e njeriut, Komisioni vlerësoi se: *"Nuk ka më organizata aktive për komunitetin LGBT (lezbike, gay, biseksualë, trans-seksualë). Ky komunitet është subjekt i jotolerancës dhe diskriminimit. Qeveria nuk ka ndërmarrë akoma ndonjë program aktiv për të ndalur këtë diskriminim".* Nga kjo pjesë mund të shihet fare qartë presioni evropian për t'ua pranuar të "drejtat" homoseksualëve, nëse Shqipëria dëshiron të ecë përpara drejt BE-së. Përse na shtyjnë ta bëjmë atë, të cilën shumica absolute e anëtarëve të BE-së nuk e kanë bërë akoma?! (Aktualisht, vetëm tri nga 27 vendet e BE-së, Holanda, Belgjika dhe Norvegjia e kanë të legalizuar martesën homoseksuale. Një përpjekje të njëjtë për legalizim të martesës pati edhe në Itali, përpjekje e cila ngjalli reagim të fortë kundërshtues nga Vatikani).



Homoseksualizmi në Kosovë

As në Kosovë gjendja nuk është hiç më e mirë, kur e dimë që Kushtetuta e Kosovës (që është pjellë e Pakos së Ahtisaarit), shtetin e Kosovës e njeh si shtet multi-etnik edhe përkundër faktit që mbi 90 % janë shqiptarë etnikë. Po e njëjta Kushtetutë, në nenin 37: E Drejta e Martesës dhe Familjes, thotë:

1. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.

2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.

Sipas këtij neni (37) dhe paragrafit 1 e 2 martesa njihet si e drejtë legale e çdokujt, por nuk precizohet se martesa u lejohet vetëm personave me gjini të kundërt, por thuhet se kjo çështje do të rregullohet me ligj. E kur Kushtetuta ia jep mandatin ligjit që ta rregullojë martesën nuk është larg mendsh që ligji i martesës të ndryshojë në një të ardhme të afërt në favor të homoseksualëve. Por, për t'ua lejuar martesat homoseksualëve, ata që e kanë menduar këtë gjë po presin që të vijë një kohë më e përshtatshme, që populli të "civilizohet" edhe pak, ngaqë gjithnjë sipas tyre akoma është i prapambetur, e nuk po ua kupton "botën" homoseksualëve.

Kryetari i homoseksualëve të Kosovës, me inicialet K. Z., 21-vjeçar, ka pohuar se në Kosovë janë rreth 200 persona që janë homoseksualë. Ata takohen shumë shpesh, organizojmë ndenjja një herë në muaj, të cilat i bëjmë nëpër shtëpi private". Në "Qendrën për Emancipim Shoqëror" janë inkuadruar 5 persona homoseksualë e lezbike që janë aktivë, të moshës 18-35, të gjithë nga Prishtina, mirëpo ka edhe anëtarë të tjerë nga qytetet e tjera të Kosovës, por që nuk janë aktivë.

Sekularistët, të cilët mendojnë se demokraci do të thotë të bësh çfarë të të bie ndërmend dhe çfarë të vijë ndorësh, nuk mendojnë njëlloj si ne që këtë dukuri devijante e quajmë deformim moral. Ata mendojnë se lejimi i homoseksualizmit është e drejtë fondamentale njerëzore dhe të gjithë ata që po ua ndalojnë homoseksualëve "aktin e shëmtuar", sipas tyre, njihen si shkelës të të drejtave të njeriut.

Shumica e psikologëve mendojnë se homoseksualizmi, në radhë të parë, është i mësuar dhe mund të ndryshohet me anë të terapive në qoftë se dëshiron vetë personi.

Tekniku i njohur për Joga, Svami Baba Ramdev, në televizionet indiane ka formuluar një peticion për Gjykatën e Lartë Indiane. Këtë peticion e ka paraqitur kundër gjykatës në Delhi, që sipas tij, ka gabuar në dekriminalizimin e "llojit seksual jonatyral", sepse nga kjo sëmundje mund "të dilet" me Joga me ushtrime për frymëmarrje dhe teknika të tjera të meditimit, theksoi Ramdev, duke e dërguar ankesën e tij në gjykatë.

Feja dhe homoseksualizmi


Sa u përket feve qiellore (atyre që janë të shpallura nga Zoti), që të gjitha kanë qëndrim negativ kur shtrohet çështja e legalizimit të ushtrimit të veprimtarisë së homoseksuaëlve, ose lejimit të martesave ndërmjet tyre. Në Kur'an thuhet se kjo dukuri devijante është shfaqur qysh në kohërat e lashta. Aty tregohet historia e të dërguarit Lut, populli i të cilit kishte prirje homoseksuale. Po ashtu tregohet se për shkak të atij mëkati janë shkatërruar qytetet Sodoma e Gomora, që ndodheshin atje ku sot është Deti i Vdekur.

Këtë dënim e morën popujt që e shkelën natyrshmërinë njerëzore dhe i tejkaluan kufijtë e moralit. Sikur ta shihte i Gjithëdijshmi të nevojshme këtë gjë do të krijonte vetëm mashkullin dhe s'do të nxirrte nga brinja e Ademit, gruan e tij Havanë, ose do të krijonte vetëm femrën pa e krijuar mashkullin fare. Por, Zoti, në Librin e tij, na ka treguar se ka krijuar mashkullin dhe femrën që të gjejnë prehje dhe kënaqësi te njëri-tjetri dhe për t'u shtuar në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e jetës njerëzore në tokë.

Gjithashtu, feja krishtere e ndalon në mënyrë rigoroze homoseksualizmin. Për ta dëshmuar këtë që po themi kemi marrë një citat nga Bibla: *13. Nëse mashkulli bie me mashkull si bihet me femër, të dy bëjnë vepër të urryer: le të ndëshkohen me vdekje: gjaku i tyre rëntë mbi ta. Pastaj Pavli në Dhiatën e re e thotë qartë në letrën e tij të parë drejtuar korintasve paragrafi 6:9:10. Ai thotë edhe këto: "Mos e mashtroni veten! As ata që bëjnë imoralitet, që bëjnë idhujtari, që bëjnë tradhti bashkëshortore* ***ose që kanë marrëdhënie seksuale me dikë tjetër të të njëjtit seks,*** *as vjedhësit, as fajdexhinjtë, as pijanecët, as shpifësit dhe as hajdutët nuk do të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë. E njerëz të tillë kishte edhe ndër ju…"*

Ushtrimet – Joga, i kthejnë homoseksualët në heteroseksual

Homoseksualiteti mund të trajtohet si çdo defekt tjetër i lindur, për shembull, me joga, ushtrime për frymëmarrje dhe teknika tjera të meditimit - ka theksuar Svami Baba Ramdev.



Po ashtu, edhe feja hebraike e ndalon homoseksualizmin dhe si të tillë e dënon atë.

E keqja gjithmonë ka qenë, është dhe, pa dyshim, do të jetë e keqe deri në fund të kësaj bote, pa marrë parasysh civilizimin njerëzor dhe zhvillimin e hovshëm që po ndodh në të gjitha sferat e jetës gjatë këtyre dy shekujve të fundit.

Gjithmonë e zeza do të jetë e zezë dhe e bardha e bardhë, gjithmonë gënjeshtra do ta ketë të njëjtin tretman, gjithmonë hajnia do ta ketë epitetin që ka, gjithmonë imoraliteti do të jetë imoralitet dhe, pa dyshim, gjithmonë homoseksualizmi do të jetë vepër e urryer, e ndaluar dhe e dënuar nga Zoti i Madh dhe nga njerëzit që kanë moral të mirëfilltë, mendje të arsyeshme dhe të gjykuar të drejtë mendor.

Dhe fare për fund themi se nuk ja vlen që me çdo kusht të hyjmë në BE dhe në asnjë organizatë tjetër botërore, e as t'i lëshojmë pe veprës së keqe sa për t'u dukur të moderuar në sytë e të tjerëve që na shohin si të prapambetur, kur si këmbim të këtij "favori" (pra integrimit në strukturat e ndryshme botërore e konkretisht në BE) do merrnim degradimin moral, pasojat e të cilit do t'i bartnim si 'trofe' të një dështimi total shoqëror në këtë jetë dhe në jetën tjetër. ■

Intervistë me shkrimtarin dhe publicistin, Kim Mehmeti

Kim Mehmeti: Serbia punon

Intervistoi: Iljasa SALIHU

Shkrimtari dhe publicisti i njohur nga Maqedonia, Kim Mehmeti, në një intervistë ekskluzive për revistën "PAQJA", ka pohuar se Maqedonia e harxhoi kohën për të qenë shtet shumetnik, e gjithnjë e më shumë ky shtet po shkon drejt konceptit të shtetit dyetnik. Pra, tani Maqedonisë i kanë mbetur dy zgjidhje: o shtet dyetnik, o protektorat. Të gjitha konceptet e tjera ajo i harxhoi. Shqiptarët e këtushëm i ecën të gjitha rrugët e tjera, e ecën rrugën e mundimshme që të ndërtohet një shtet shumetnik, ku mori pjesë edhe vetë ai, e ecën dhe e përjetuan edhe rrugën unitare prej viteve 90-ta deri 2001-shin, por asnjëra rrugë nuk bëri fajde.

PAQJA: ***Çfarë mund të na thoni për urtësinë e konfliktit të 2001-shit, si dhe çka fituan shqiptarët e çka humbën maqedonasit në këtë konflikt të armatosur?***

MEHMETI: Urtësitë më të ndershme janë ato që nxirren prej fatkeqësive, sepse ato mbahen në mend më gjatë. Këtë e them për arsye se pas 2001-shit duhej të arrihej një harmoni ndëretnike, por ajo harmoni nuk u arrit edhe pas tetë viteve nga ky konflikt dhe Maqedonia e sotme ndodhet thuajse aty ku ishte në nëntëdhjetën, kur u themelua si shtet. Kjo është bindja ime, ndoshta mund edhe të gaboj. Dhe me këtë, shikuar realisht, nuk fituan gjë shqiptarët e as nuk humbën gjë maqedonasit, mirëpo pasi nuk u realizua Marrëveshja e Ohrit, humbi e tërë Maqedonia. Sipas meje, shqiptarët janë aty ku ishin para konfliktit, pra merren me çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe dhe shumë kërkesave të tjera kolektive, që duhej të ishin zgjidhur vite më parë. Pra, shqiptarët e këtushëm ende merren me realizimin e të drejtave kolektive që është absurde! Ne ende nuk kemi arritur në atë nivel sa të merremi me të drejta individuale. Kjo është si rrjedhojë e asaj se Maqedonia nuk u ndërtua as si shtet shumetnik, as si shtet dynacional, as si shtet qytetar. Ky është një ndërtim shtetëror hibrid, ku keni, nga njëra anë, tendencën maqedonase që, me çdo kusht, shteti ta ketë shenjë njohëse cirilikën dhe ortodoksizmin dhe, nga ana tjetër, dëshirën e shqiptarëve që ky shtet ta ketë shenjën njohëse edhe portretin e tyre kolektiv, gjë e cila assesi nuk arrihet. Maqedonia është duke blerë kohë për ta mbajtur sa më gjatë në jetë këtë sistem unitar që realizon vetëm ëndrrën maqedonase. Por, ajo harroi se ia harxhoi kohën vetvetes për të qenë shtet shumetnik dhe gjithnjë e më shumë ajo po shkon drejt rrugës që të bëhet shtet dyetnik.

PAQJA: ***A do të thotë kjo se partitë politike shqiptare, dështuan në jetësimin dhe vjeljen e fryteve që u arritën me një konflikt të armatosur?***

MEHMETI: Gjithsesi se shqiptarët nuk ia dolën ta zbatojnë Marrëveshjen e Ohrit, Marrëveshje që duhej të përmbyllej qysh në vitin 2004. Vetë fakti se tani jemi në fillim të vitit 2010 dhe ende flasim për realizmin e Marrëveshjes së Ohrit, dëshmon qartë për efikasitetin e partive politike shqiptare. Partitë politike shqiptare, Marrëveshjen e Ohrit e kuptuan si mënyrë për të punësuar partiakët e vet, partizanët e vet. Ata nuk e kuptuan atë si frymë që ka të bëjë me tërë shtetin, me të gjitha institucionet shtetërore dhe, duke e shqyrtuar si të atillë, ata ua bën ndihmesën më të madhe partive politike maqedonase, që donin ta ngadalësonin realizimin e kësaj Marrëveshjeje. Pra, erdhi puna deri aty sa partitë shqiptare të kënaqen me punësimin e qindra partizanëve të tyre dhe çdo gjë të përmbyllej me aq. Nga ana tjetër, keni një Ministri të Kulturës ku nuk ka dikaster për kulturën shqiptare, keni një Ministri të Arsimit pa një dikaster për kualitetin e arsimit shqiptar, keni ministri të tjera ku tërë buxheti shtetëror ndahet disproporcionalisht, 93 % të buxhetit e kontrollojnë ministrat maqedonas dhe vetëm 7 % ministrat shqiptarë. Çfarë barazie është kjo? Kujt mund t'i flasin liderët tanë partiakë për barazi dhe për realizim të Marrëveshjes së Ohrit?

PAQJA: ***A mund të na shpjegoni ndryshimin e kursit tuaj në veprimtarinë publicistike, ku nga një publicist që promovonit ide për një shtet shumetnik, kaluat në një kritikues të ashpër të pushtetit?***

MEHMETI: Shihni, unë i kam besuar dhe ende i besoj shtetit shumetnik. Unë ende jam ithtar i konceptit shumetnik. Mbi konceptin shumetnik, shumëkulturor, shumëreligjioz ekziston vetë bota. Bota nuk qëndron mbi themelet e njerëzve dhe kolektiviteteve të njëjtë, por mbi dallueshmëritë mes popujve! Unë nuk pendohem fare për ato dhjetë vite sa kam punuar për konceptin e shtetit shumetnik, sa shpresoja se Maqedonia do të ndërtojë institucione që do të pasqyronin realitetin e saj shumetnik. Pra, mua më interesonte shteti shumetnik me institucione shtetërore shumetnike, e jo një shoqëri shumetnike e sunduar vetëm nga një grup etnik.

PAQJA: ***Do të thotë kjo se ne jemi shoqëri shumetnike?***

MEHMETI: Shoqëri shumetnike janë të gjitha. Nuk ke shoqëri monoetnike, ose ato janë shumë rrallë. Mirëpo shteti që ndërtohet mbi baza shumetnike është krejt diçka tjetër. Unë duke e parë që ky shtet nuk ndërtoi institucione shumetnike, u tërhoqa, sepse shpesh e përsëris, nuk jam aq abdall, por fshatar që vepron sipas urtësisë: vlerësoje arën se çfarë mund të mbjellësh në të, e pastaj hidhe farën. Nuk mund të mbjellësh speca aty ku mund të rriten vetëm patatet, nuk mund të mbjellësh qershi aty ku vendi është për kumbulla. Pra, vlerësova se Maqedonia nuk ka as vullnet, as forcë politike, për ta ndërtuar veten si shtet shumetnik. Andaj, i përballur me këtë të vërtetë, unë vazhdoj tutje. Mirëpo i besoj atij koncepti. Ai është koncepti i ardhmërisë, por ai koncept nuk ka të sotshme në Maqedoni dhe, meqë nuk ka të sotme, atëherë sot them se koncepti shumetnik në këtë shtet u harxhua, nuk u shfrytëzua koha për t'u bërë diçka e tillë, edhe se ky shtet e harxhoi mundësinë të bëjë një shoqëri qytetare, një shtet qytetar, ku nuk do të kishte vlerë përkatësia etnike, por ku do ishte vlera individuale ajo që ta përcaktonte fatin dhe meqë është ashtu, tani Maqedonisë i kanë mbetur dy zgjidhje: o shet dyetnik, o protektorat. Ne shqiptarët, e ecëm rrugën e mundimshme, ku mora pjesë edhe unë, që Maqedonia

n kundër imazhit të UÇK-së

të ndërtohej si shtet shumetnik, e ecëm edhe rrugën e shtetit unitar prej viteve 90-ta deri 2001-shin, mirëpo nuk bëri fajde asnjëra.

PAQJA: ***A është e mundur që një prej këtyre të dyve të realizohet (shtet dyetnik apo shtet nën protektorat)?***

MEHMETI: Shihni, idetë dhe sjelljet njerëzore janë si uji, s'mund t'i kontrollosh ose t'i parashikosh. Ti shpeshherë e sheh që uji rrjedh këtu, por depërton nëpër mure e del atje ku nuk e pret. Edhe idetë e njeriut dhe zhvillimet e shoqërisë njerëzore janë zhvillime të gjalla, kanë të bëjnë me njerëz të gjallë dhe janë të paparashikueshme. Nuk pretendoj se mund ta di, mirëpo në bazë të asaj që shoh, unë them që ky shtet shkon gjithnjë e më shumë drejt një shteti dyetnik, nuk funksionon asgjë për një koncept shumetnik.

PAQJA: ***Pse shqiptarët në përgjithësi, e ju në veçanti, kur flitni për problemet dhe diskriminimin e shqiptarëve, flinti me një dozë emocioni që në vazhdimësi ju shoqëron. A mos vallë kjo është pjesë e traditës sonë, apo është pjesë e realitetit të dhembshëm që mbretëron në të gjitha trevat tona shqiptare. Ndërkaq, të njëjtën gjë nuk e shohim tek aktivistët dhe analistët maqedonas?***

MEHMETI: Unë mendoj se kjo nuk ka të bëj me gjenetikën që na çon të jemi më emotiv se të tjerët. Unë mund të jem i tillë, sepse jam krijues, jam njeri i emocioneve dhe tek unë, si krijues, sigurisht që do minojnë emocionet. Që të jesh më racional, sikurse është pala maqedonase, duhesh të jesh brenda në kala dhe është shumë e lehtë pozita e atij që i kontrollon të gjitha, gjë që i lejon të jetë shumë më racional, që ia mundëson të tjerëve t'u thotë keni durim, pritni, do të bëhet më mirë. Mirëpo, mua më ngutet se unë jam jashtë "kalasë" dhe me vetë atë jam më nervoz, më i ngutshëm, më emotiv. Ai që është brenda në "keshtjellë" gjithnjë mundohet të blejë kohë, i rregullon gjërat brenda saj sipas dëshirës dhe nevojave të veta. Nga kjo rrjedh edhe ajo "shpirtmadhësia" e përfaqësuesve etnikë maqedonas, e atij që blen kohë dhe do të mbetet pronar i vetëm i shtetit. Duke qenë në pozitën e pronarit të vetëm të shtetit, maqedonasit etnikë janë të prirë të flasin për një Maqedoni që është e mirë për ata, e unë flas për një Maqedoni që është e keqe për mua, flas me të keqen që e ndiej se më ndodh në këtë shtet, ndërsa ata për të mirën që u ndodh në këtë shet, sepse kultura e tyre financohet mirë, kishat financohen mirë, vendbanimet e maqedonasve përparojnë, partitë politike shqiptare punësojnë 1000 shqiptarë, ndërsa partitë politike maqedonase punësojnë 6000 maqedonas dhe, kështu pastaj, flitet për një realizim të Marrëveshje së Ohrit. Vallë, si mund të flasim në gjuhën e njëjtë?! Ne aktualisht jetojmë në dy Maqedoni: Maqedonia në të cilën jetojnë shqiptarët, ku vlejnë standarde të tjera dhe Maqedonia ku jetojnë maqedonasit, ku vlejnë standarde tjera.


Kim Mehmeti: Ne aktualisht jetojmë në dy Maqedoni: Maqedonia ku jetojnë shqiptarët, ku vlejnë standarde tjera për ta dhe, në Maqedoninë ku jetojnë maqedonasit ku vlejnë standarde tjera.

PAQJA: ***A mendoni se liberalizimi i vizave për Maqedoninë mund të vlerësohen si fillim i mbarështhimit të gjërave?***

MEHMETI: Sigurisht që është diçka pozitive. Në mos tjetër, të gjithë të rinjtë do të ikin nga ky shtet, me çka partitë politike do të mund të lavdërohen se e kanë zgjidhur problemin e papunësisë. Ndërkaq, kjo nuk është zgjidhje, por tragjedi! Por, në këtë vorbull do të ketë edhe diçka pozitive për liderët tanë partiakë, të cilëve do u mbeten vetëm votuesit pleq dhe do të shkojnë nëpër dhomat e burrave, do këndojnë këngë popullore me çifteli dhe do mund të bëhen deputet me 200 vota. Ku ka më mirë se kjo për politikanët tanë?!

PAQJA: ***Përpos që jemi të diskriminuar në aspektin e të drejtave kombëtare, ne po ashtu jemi të diskriminuar edhe në aspektin e të drejtave fetare. Me këtë dyfish të padrejtësive, çfarë dëshiron të na thotë pushteti i Gruevskit?***

MEHMETI: Shteti i Maqedonisë e ka barazuar fenë me pushtetin, sepse çdo objekt që inaugurohet bëhet me priftërinjtë ortodoksë. Duhet të gjithë ta kemi parasysh se ato objekte ndërtohen edhe me paratë e myslimanëve. Gruevski asnjëherë nuk ka bërë ndonjë përurim duke pasur pranë vetes edhe ndonjë hoxhë, apo ndonjë prift katolik.

PAQJA: ***Mos ndoshta kjo ndodh për arsye se shumë objekte ortodokse ndërtohen në vakëfet e Bashkësisë Islame?***

MEHMETI: Maqedonia është shumë e kujdesshme dhe e ndjeshme ndaj kishës ortodokse. Asaj ia kthen pasurinë, i dhuron pronë të patundshme, ajo ka edhe hotele në Strugë e gjetiu. Në vendin ku duhej të ndërtohej kisha katolike iu dha vendi kishës ortodokse, e vendi ku duhet të ndërtohet Burmali Xhamia nuk iu dhurua Bashkësisë Islame. Kjo flet edhe për vetë Bashkësinë Islame dhe për njerëzit që e drejtojnë atë.

PAQJA: ***Po dalim pak në Kosovë. Çfarë mendoni për deklaratat pompoze dhe tejet skandaloze të Nazim Bllacës?***

MEHMETI: Shihni, ajo mbi të gjithë është diçka e pahijshme, diçka që nuk mund të ndodhë në një shtet normal: të

dalë në rrugë një njeri dhe të thotë se unë kam vrarë njerëz dhe pastaj të shkojë në shtëpi, thuajse nuk ka ndodhur kurrgjë...

PAQJA: ***A mund të jetë kjo një skenë e projektuar prej pushtetit të Beogradit?***

MEHMETI: Ne duhet ta dimë një gjë: jo sot, por prej dje, prej ditës kur filloi lufta e UÇK-së, e ushtrisë që flijoi çdo gjë për të mirën e Kosovës, shërbimet serbe veprojnë dhe do të veprojnë. Në njëfarë mënyrë, Maqedonia dhe Kosova janë "Kazabllankat" e Ballkanit ku i ke të gjitha shërbimet sekrete. Dhe normalisht se në një shtet i ri si Kosova, i cili nuk i ka shërbimet e veta aq të etabluara, aq të përsosura që t'ju kundërvihen strukturave të huaja policore, atje pa dyshim se ndodhin edhe të papritura. Nuk duhet harruar se të gjitha dosjet e shqiptarëve janë në Beograd. Beogradi edhe sot mund të manipulojnë me dosjet e shqiptarëve. Shërbimet sekrete policore serbe edhe sot mund t'i ribëjnë dosjet tona, mund t'i korrigjojnë dhe munden që nesër të nxjerrin në publik dokumente të ndryshme. Ne ende jemi në fazën kur edhe "heronjtë" na i cakton Beogradi, sepse shpeshherë, ata krijojnë situata që individë të caktuar të ngjajnë si "patriotë", ose e kundërta, ofrojnë "argumente" për "tradhtinë" e ndonjë figure tonë të çmuar. I njëjti Beograd, sot e kësaj dite, ka mundësi t'i rrënojë vlerat tona, veçanërisht politike, duke publikuar dokumente të rrejshme për ta. Mjafton që një dosje ta sajojnë e ta nxjerrin publikisht, mjafton pastaj që mjegulla të shtohet! Tendenca e të gjitha këtyre sajesave është zhvleftësimi i UÇK-së, si vlera më e madhe që ka populli i Kosovës. Këto tendenca kanë për qëllim që të barazohemi të gjithë në fajësi. Unë nuk flas për rastin konkret, por për fenomenin kur shërbëtorët e dikurshëm të qarqeve policore sllave, nguten të mbulojnë veprimet e veta duke i humbur gjurmët e të kaluarës së vet dhe duke shpallur sa më shumë të tjerë të njëjtë si vetvetja. Është naive të besosh se shërbimet sekrete serbe nuk do mundohen të bëjnë çmos që ta degradojnë luftën në Kosovë, me çka duan ta rrënojnë historinë e një populli. E ata këtë do e bëjnë nëpërmjet shqiptarëve, nuk do e bëjnë nëpërmjet serbëve!

PAQJA: ***Mos u mbesim borxh edhe ngjarjeve të fundit që rrodhën në Luginën të Preshevës. Çfarë mendoni për ndërtimin e bazës ushtarake serbe, e cila cilësohet si baza më e madhe në Serbi? Si dhe cili ishte roli i Shqipërisë kundër këtij akti?***

MEHMETI: Ta kesh nënë Shqipërinë e babë Kosovën, mbetesh në rrugë.

Mirëpo, fëmijët e atillë ndonjëherë bëhen edhe më të fortë, bëhen më të gjindshëm, ngase e dinë fort mirë se nuk mund të presin ndihmën e prindërve dhe u mjafton prona që e kanë trashëguar nga ata. Unë e di se Serbia do të bëjë çmos që ta pastrojë Luginën e Preshevës nga shqiptarët, se ajo nuk ndërton biblioteka a shkolla për shqiptarët, por u ndërton kazerma ushtarake përpara pragut të shtëpisë. Sikur të kishim një Shqipëri që nuk do merrej me sharjet më absurde, më poshtëruese ndërpartiake për të gjithë shqiptarët, nëse nuk do na e merrnin kështu fytyrën këta politikanë shqiptarë të Tiranës dhe nëse Shqipëria do tregonte kujdes për shqiptarët që janë jashtë mëmëdheut, atëherë Bujanoci do të konsiderohej si pika që ruan brendinë kombëtare. Atëherë do mjaftonte, për shembull, në Bujanoc të investohej aq sa kushtojnë darkat dhe drekat e ministrave në Tiranë, e që Lugina e Preshevës të kishte të ardhme më të ndritshme. Nëse nuk e dinë se si duhet vepruar me këto vendbanime që ndërlidhin unazën e jashtme etnike, atëherë politikanët shqiptarë duhet të shohin si vepron Serbia me pakicat e saj jashtë vendit. Duhesh të mësosh, të them kushtimisht, edhe nga armiku. Mirëpo politikanët shqiptarë janë njerëz që i dinë të gjitha dhe nuk dëshirojnë të mësojnë nga askush. Mbase prandaj mbeten vetëm grindavec të mirë, vetëm dinë të shajnë.


Kim Mehmeti: Prej konfliktit të 2001-shit, nuk fituan gjë shqiptarët e as nuk humbën gjë maqedonasit, por pasi nuk u realizua Marrëveshja e Ohrit humbi e tërë Maqedonia.

PAQJA: ***A e shihni si shpëtim përfundimtar të kombit shqiptar, platformën e Shqipërisë Natyrale, ide e plasuar prej disa analistëve shumë të përgatitur?***

MEHMETI: Një popull që nuk e ka ideal bashkimin e vet është popull pa ardhmëri. Çdo popull duhet ta ketë këtë ideal. Ajo që mund të diskutohet është rruga se si duhet realizuar kjo ëndërr kombëtare. Me një Shqipëri të këtillë siç është, me një Kosovë të këtillë siç e kemi, me ne shqiptarët e tjerë të shpërndarë nëpër shtetet e tjera, mendoj se ne kemi arritur maksimumin e mundshëm. Nëse synoni ta arrini ndonjë cak, duhet paraprakisht të vlerësoni potencialin tuaj etnik, sepse nuk mjafton vetëm dëshira juaj! Shikuar nga ky kënd, mendoj se ideali ynë për bashkim kombëtar mund të arrihet vetëm në dy mënyra: o dhunshëm, pra nëpërmjet një lufte me të gjithë rreth nesh, o duke ecur rrugës së Bashkimit Evropian që do i zhvlerësojë kufijtë e këtushëm shtetërorë. Ne lëre që nuk kemi mundësi ushtarake, por bota rreth nesh bëhet e tëra bashkë kur jemi në pyetje ne shqiptarët, sepse të gjithë ata janë kushërinj, kanë ndonjë lidhje farefisnore mes vete. Andaj mendoj se rruga që duhet të ndjekim ne shqiptarët është ajo që çon drejt Evropës pa kufi. Nëse ky Ballkan anëtarësohet në BE i tillë siç është, atëherë hapësira shqiptare vetvetiu do mbyllet ekonomikisht, medialisht, etj. Mendoj se sezoni i luftërave në Ballkan ka marrë fund dhe është harxhuar. Besoj se vjen sezoni i integrimeve. Ajo që është tragjike për ne, e që unë mendoj se do të na kushtojë shumë shtrenjtë, është e vërteta se ne nuk blejmë integrimin brendashqiptar as në lëmin e kulturës e as të historisë së përbashkët. Dhe kjo është ajo që na dëmton dhe sigurisht se kjo do të na dëmtojë edhe në të ardhmen, sepse ne edhe në atë Evropë do të hyjmë të copëtuar. Ne nuk punojmë as për bashkimin tonë shpirtëror, ndërkaq bashkimi jo çdoherë do të thotë thyerje dhe asgjësim i kufijve.

Shihni, ju keni sot në Tiranë dy parti, të cilat grinden aq shumë ndërmjet vete sa keni përshtypjen se sikur të kishin mundësi, do e ndanin mes vete edhe Shqipërinë, se çdonjëra është e gatshme të ketë Shqipërinë e vet. Vallë, a është e mundur me këto parti të arrijmë integrimin tonë brendakombëtar dhe këto parti të na çojnë drejt një Evrope të bashkuar?! ■

Çfarë bëmë, e çfarë duhet të bëjmë?

Viti 2009, u karakterizua me pakënaqësi të shumta siç janë papunësia, e cila nuk ka trend të rënies por të ngritjes, kur dihet se tregut të punës për çdo vit në Kosovë i shtohen mijëra të rinj, të cilët nuk mund ta gjejnë veten askund. Përveç këtyre problemeve, Kosova gjatë vitit u përball edhe me mungesën e rritjes ekonomike, pavarësisht nga deklaratat e zyrtarëve. Ajo ka qenë 4 për qind, pra, më pak se gjatë vitit 2008 që ishte mbi 5 për qind.



Lulzim AHMETI

Pavarësisht se zyrtarët e institucioneve të Kosovës mund të krenohen me të arriturat e vendit në sferën ekonomike gjatë vitit 2009, kjo nuk mund të jetë ashtu për shumicën e banorëve të vendit, të cilët janë përballur me vështirësi të mëdha vitin që shkoi.

Viti 2009 kaloi në ethet e krizës globale, e cila përfshiu botën, dikë më pak e dikë më shumë, por, fatmirësisht, Republika e Kosovës nuk u prek rëndë, përveç rënies së investimeve të huaja, rënies së remitencave dhe problemeve të Ferronikelit, nga pjesa e dytë e vitit me rënien e çmimit të metaleve në bursat botërore. Por investimet e huaja direkte dhe remitencat mund të jenë shqetësuese për shoqërinë kosovare, pasi që pa to nuk mund të kemi një zhvillimi të dëshirueshëm ekonomik.

Rritja ekonomike

Viti 2009 u karakterizua edhe me pakënaqësi të shumta siç janë papunësia, e cila nuk ka trend të rënies por të ngritjes, kur dihet se tregut të punës për çdo vit në Kosovë i shtohen mijëra të rinj të cilët nuk mund ta gjejnë veten askund.

Përveç këtyre probleme Kosova gjatë vitit u përball edhe me mungesën e rritjes ekonomike, pavarësisht nga deklaratat e zyrtarëve. Ajo ka qenë 4 për qind, pra, më pak se gjatë vitit 2008 që ishte mbi 5 për qind.

Ekonomia kosovare stagnoi, ndoshta edhe për shkak të mosprivatizimit të ndërmarrjeve strategjike të Kosovës, siç janë një pjesë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Postë Telekomi i Kosovës (PTK), si dhe futja e koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinë (ANP), në të cilat ishin paraparë të hynte edhe kapitali privat. Por, privatizimi i disa ndërmarrjeve gjatë vitit 2009 ka qenë i "lodhtë", pasi që shumica e ndërmarrjeve, të cilat janë privatizuar, kanë qenë kryesisht toka bujqësore e nuk kanë sjellë shuma të mëdha parash. Po ashtu, gjatë vitit që shkoi ishte paraparë që të privatizohet kompleksi Turistik "Brezovica", i cili është pronë e Kosovës, por që arkëtimi më i madh i mjeteve bëhet nga kompani të Serbisë.

Problemi CEFTA

Një problem i madh për Kosovën, gjatë vitit 2009, ishte edhe bllokimi i produkteve me origjinë nga Kosova për të kaluar nëpër territorin e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, i cili u ka shkaktuar dëme të mëdha prodhuesve kosovarë. Si duket CEFTA do të jetë problem në vazhdimësi për prodhuesit. Sidomos, tash problemet mund të rriten pasi që nga fillimi i vitit kryesimin e sekretariatit të CEFTA-s e ka marr Serbia, e cila mund t'i "injorojë" institucionet e Kosovës.

Edhe pse Republika e Kosovës e pati nënshkruar marrëveshjen për tregti të lirë CEFTA me vendet e rajonit më 2006, ajo nuk është duke u respektuar pikërisht nga fqinjët nënshkrues të Kosovës.

Bujqësia pa prioritete

Sa i përket bujqësisë, ajo ende nuk është prioritet i institucioneve të Kosovës, e as i atyre që merren shumë me bujqësi.

Bujqësia në planin e qeverisë së Kosovës jo vetëm që nuk renditet shumë lart në prioritet, por ajo nuk ka as edhe buxhet të mjaftueshëm për nevojat e veta.

Përderisa Maqedonia dhe vendet e tjera të rajonit kanë buxhete dhe fonde ekstra për subvencione, në Kosovë nuk ka fonde e as subvencionim të mjaftueshëm.

Në vitin 2010, sfidë përveç rritjes ekonomike, hapjes së vendeve të reja të punës, privatizimit të ndërmarrjeve strategjike aq të nevojshme për qytetarët e vendit, do të jetë edhe stabiliteti makroekonomik i vendit, sipas udhëzimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Po ashtu, institucionet e Kosovës duhet të angazhohen më shumë për t'u bërë anëtare të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH), e cila është më e vështirë të arrihet se sa FMN-ja e Banka Botërore. ■



Pallati presidencial i rrëzuar nga tërmeti në Haiti

Nëpër vorbullën e problemeve



Mevlude ZEJNULLAHU

Kaloi mbi një dekadë që kur përfundoi lufta në Kosovë. Pas gjithë këtyre viteve, rrjedhat teknologjike të botës janë bartur edhe këtu, e sidomos teknologjia e mediave, të cilat gjithherë kanë synim lehtësimin e përçimit të lajmeve sa më lehtë e sa më shpejt te publiku. Kosova, si kurrë më parë, ka filluar të hapërojë drejt globalizimit, si për nga kultura masive, si për nga infrastruktura rrugore, si për nga demokratizimi i institucioneve të saj, ashtu edhe për shumë çështje sociale, shëndetësore, e edhe për planifikime familjare. Por, shumë shqetësime kanë mbetur ende të theksuara si: vetëvrasja, prostitucioni, pornografia, homoseksualizmi, droga etj., e veçmas: aborti, të cilin do ta përmendim këtu kalimthi.

Sot në Kosovë nuk di nëse ka ndonjë familje (përjashtuar ato në gjendje shumë të rëndë ekonomike) që s'i dëgjon lajmet, së paku një herë në ditë, qoftë në radio ose në televizion e që nuk i komenton deklaratat e politikanëve të partive të ndryshme, por jo edhe programet e tyre të prezantuara gjatë e pas fushatës zgjedhore.

Zgjedhjet e kaluara dëshmuan se politika kosovare (partitë) duket se nuk e ka fort të qartë, në program jo se jo, se kanë përgjegjësi të merren edhe me këto probleme, të cilat kohët e fundit në shoqërinë tonë janë gjithnjë e më shumë në rritje. Ato vazhdimisht po tejkalohen e po anashkalohen, ndonëse mediat çdo mëngjes, çdo mesditë e çdo mbrëmje bëjnë zhurmë rreth këtyre problemeve. Por, ndërmjet shoqërisë dhe shtetit ka dhe një problem tjetër, shumë të vrazhdë.

Me prurjen e "vlerave" të reja, kinse emancipimit e demokratizimit të shoqërisë, sidomos gjinisë femërore, disi ka filluar të keqkuptohet liria e sjelljes së një kategorie të femrave në Kosovë. Por, prej nga ky keqkuptim? Përgjigjet do të ishin të ndryshme, ngaqë nuk ka analiza të plota se përse vajzat e reja, për shkak të kësaj "lirie" të keqkuptuar, kanë filluar t'i lëshohen lirisë seksuale me bashkëmoshatarët e vet e shpeshherë edhe me mosha të tjera më të shtyra. Një ndër shpjegimet tona është se shkaqet duhen kërkuar në praninë e ndërkombëtarëve në Kosovë, që nga paslufta e këndej. Kontingjentet e forcave paqeruajtëse, që në Kosovë kanë qenë në numër tejet të madh, natyrisht se kanë pasur nevoja seksuale dhe interesa. Kjo tezë e jona mund të kontestohet nga këndvështrimi informativ, por si dukuri e shprehur tashmë, madje edhe me dimensione goxha alarmuese, për mendimin tonë, e ka "gjetur" vendin e vet në mesin e atyre fenomeneve që duhet t'u kushtohen vëmendje e posaçme.

Së këndejmi, mendojmë se shkaqet duhen kërkuar edhe te njëfarë indeference e re e prindërve që kanë filluar ndaj gjeneratës së re (gjenerata e viteve '90-ta), që tashmë ka hyrë si kontingjent, që më së shumti po ka probleme ta gjejë vetveten në këto procese të reja... Në anën tjetër është një hall tjetër i madh: prindërit, më parë sesa me problemet e vajzës, janë të mbingarkuar me probleme ekonomike, sidomos se si ta sigurojnë ekzistencën (bukën) për familjen.



Më tutje, kuptojmë se një qytetari kosovar, që është i ngarkuar me shumë halle ekonomike e sociale, larg mendsh se do t'i bie ndërmend t'i flasë vajzës për edukatë seksuale, se kur është koha më e përshtatshme e marrëdhënies së parë, ose cilat mjete preventive duhet të përdoren gjatë marrëdhënies seksuale për t'u mbrojtur nga: shtatëzënia e padëshiruar, nga HIV-i, sifilizi e ndonjë sëmundje tjetër infektuese e ardhur nga moskujdesja gjatë aktit seksual.

Gjithashtu, kemi vënë re se gjeneratat e reja kanë një individualizim të tepruar, që me kushtet dhe rrethanat tona ekonomike vështirë se mund të ndërtohet dhe të ngrihet njësoj sikurse që ka ndodhur, bie fjala, në botën perëndimore. Këtij faktori themi që i duhet shtuar edhe kriza që e ka kapluar institucionin e familjes kosovare që, tashmë, edhe me thellimin e tepruar të krizës ekonomike, është futur në një lloj skeme të çoroditur makiaveliste! Por, ka një zgjidhje.

Terapia më e mirë për të gjithë ne është: jo kthimi decidiv drejt vlerave konservative të familjes sonë, se ato, është e kuptueshme, nuk mund t'u bëjnë më rezistencë kohës dhe proceseve të reja integruese, por duhet të shkojmë drejt kombinimit të natyrshëm të këtyre vlerave me trendët e rinj të shoqërisë sonë. Kështu, mbase, do të jemi shumë më të kujdesshëm për vete dhe për shtetin!

Pak larg nesh ka shembuj për të mirë. Nëse kalojmë kufijtë gjeografikë të Kosovës, shohim se në Shqipëri është i pranishëm një trend i tillë i kombinimit të këtyre dy sistemeve të reja, por në Kosovë, edhe pse kaq afër me këtë kombshtet, ende s'e dimë se nga do të shkojë ky trend. Përveçse që i mbetet kohës të na tregojë se nga do të shkojmë, është edhe koha që projektet e qeverisë dhe programet e partive të jenë shumë më ndryshe nga ç'janë tash. Ato duhet të ofrojnë një zgjidhje për një jetë më të mirë e më të rehatshme për akëcilin shtetas të Republikës së Kosovës. Por, hëpërhë, na mbetet ta presim edhe më tutje, po kaq rëndë, atë të ardhme më të mirë! ■

Aliu, i biri i Ebu Talibit (598-661)

I Dërguari s.a.v.s. ka thënë:"Do të ketë shumë fitne (trazira, sprova dhe vështirësi) gjatë të cilave ai që rri ulur do të jetë më i mirë se ai që rri në këmbë, ai që rri në këmbë do të jetë më i mirë se ai që ecën dhe ai që ecën do të jetë më i mirë se ai që vrapon. Kushdo që do t'u dalë përpara këtyre sprovave, do të shkatërrohet prej tyre. Prandaj, kush mund të gjejë një vend që të ruhet e të mbrohet prej tyre, atëherë le të strehohet atje" (el-Buhari, f. 990/2192)



Muhamed J. KAJOLLI

Efillova jetën e këtij sahabiju shumë të dashur për të gjithë muslimanët me këtë hadith të Pejgamberit s.a.v.s., me qëllim që të paralajmëroj lexuesin se Pejgamberi s.a.v.s. ishte në dijeni të faktit se pasuesit e tij do të sprovoheshin me një goditje shumë të rëndë. Dhe kjo sprovë goditi sahabijun më të mençur nga të gjithë të tjerët e mëhershëm dhe më të dashurin e Pejgamberit s.a.v.s.

Shkurt mbi jetën e këtij sahabiju të dashur

I biri i Ebu Talibit u lind në Mekë më 598 ose 600, nga nëna Fatime. Për shkak të varfërisë së tejskajshme që mbretëronte në atë kohë te disa familjarë të hashimitëve, ky fëmijë u rrit në shtëpinë e Muhamedit s.a.v.s. Në moshë të hershme (10-12 vjeç) e pranoi Islamin dhe, njëherësh, njihet si personi i parë i gjinisë mashkullore që e pranoi Islamin. Historia e njeh si një njeri me fizik dhe karakter shumë të fortë, që ka lënë pas vetes shumë thënie të mençura, me të cilat edhe sot shërbehet njerëzimi. Ai ishte shumë i sinqertë dhe i drejtë në gjykimet e tij, të cilat ishin të panumërta. Ishte gjykatësi kryesor i gjykatës supreme në kohën e Ebu Bekrit, Omerit dhe Osmanit.

Përveç se ishte kushëriri i parë i Muhamedit s.a.v.s., ai ishte edhe dhëndri i tij dhe mbeti trashëgimtari i vetëm në lozën e Muhamedit s.a.v.s., prandaj ai konsiderohet si pjesëtari i vetëm i familjes së tij. Pasi ndërroi jetë Fatimeja, e bija e Pejgamberit s.a.v.s., ai u martua me shumë gra të tjera. Ishte babai i 14 djemve dhe 19 vajzave.

Edhe pse më i ri në moshë se Omeri r.a., ai ishte vjehrri tij. Omerit r.a. kishte për grua bijën e tij Ummul Kulthumin, e cila ishte lindur nga nënë Fatimeja.

Rëndësia e tij në umetin musliman

Një ditë kur zbriti ajeti kuranor: "Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju 'Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët" (Kur'an: 3/61), Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysenin dhe tha: O Zot, këta janë familja ime" (Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu).

Gjithashtu transmeton Ebu Hurejra, se Pejgamberi s.a.v.s. për Ditën e Hajberit ka thënë: "Do t'ia jap flamurin një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin dhe do të jetë fitimtar". Omeri tha: Nuk kam dëshiruar ndonjëherë të jem prijës veç asaj dite, prandaj shpresova se do të më thërriste mua i Dërguari s.a.v.s., por ai e thirri Aliun (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) dhe ia dha flamurin duke i thënë: "Ec përpara dhe mos u kthe prapa derisa të fitosh". Ai eci pak përpara dhe u ndal, por pa kthyer kokën prapa pyeti: "O i Dërguari i Allahut, për çfarë t'i luftoj njerëzit?" Ai iu përgjigj: "Luftoji ata derisa të dëshmojnë se nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari Tij. Nëse ata e bëjnë këtë, atëherë gjaku dhe pasuria e tyre i takon Allahut". (Muslimi)

Buhari dhe Muslimi transmetojnë një hadith tjetër të transmetuar nga Sead Ibën Vekasi i cili thotë: Pejgamberi s.a.v.s. e la Aliun (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) Ditën e Betejës së Tebukut në Medinë, ndërsa ai i tha: "O i Dërguari i Allahut, a po më lë me fëmijët dhe gratë?" Muhamedi s.a.v.s. ia ktheu: "A nuk dëshiron të jesh për Mua ashtu siç ishte Haruni për Musanë".

Veçoritë e Alisë

Ai veçohej nga të gjithë të tjerët për fuqitë e tij fizike, psikike dhe për moralin e tij të lartë. Ata persona që kishin marrë pjesë në fushëbetejat ku kishte luftuar edhe Aliu, dëshmonin për një fuqi fizike të pashpjegueshme të tij. Është transmetuar nga shumë sahabë se ai, për asnjë moment, nuk e kishte parë organin e tij gjenital, prandaj sa herë përmendej emri tij thoshin: Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij.

Kur ai ishte pjesëmarrës në ndonjë aktgjykim, të tjerët qetësoheshin. Ndërsa Omeri thoshte: sa herë që më mungonte Aliu në vendimmarrje, kërkoja mbështetje tek Allahu i Lartëmadhëruar ndaj problemeve të vështira. Imam Neveviu transmeton nga Ibën Abbasi të ketë thënë: "Aliut i janë dhënë 9/10 e diturisë. Vallahi ai merrte pjesë edhe në të dhjetën." Nëse konkludohej diçka nga Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij), të tjerët nuk lodheshin që ta hulumtonin çështjen nga dikush tjetër.

Sahabët e mëdhenj, edhe pse kishin jetuar dhe vepruar me Muhamedin s.a.v.s., gjithmonë siguroheshin nga fetvatë e tij. Thëniet dhe fetvatë e tij ishin dhe mbeten edhe sot si më të fuqishmet rreth shumë problemeve të jetës së një besimtari musliman. Ibën Abbasi thotë: -Omeri ka thënë: "Aliu është gjykuesi më i mirë e më i drejtë prej nesh, ndërsa Ubeji është lexuesi më i mirë".

Prej fjalëve të urta të Alisë

- Njerëzit janë tri llojesh:
1. Dijetar i përkushtuar tek Allahu i Lartëmadhëruar
2. Ai që mëson për të shpëtuar
3. Njeriu fundërrinë, që endet andej nga fryn era. Të tillët nuk kërkojnë dritë nga dituria, e as mbështetje të qëndrueshme.

- Dituria është më e mirë se pasuria. Pasurinë duhet ta ruash, ndërsa dituria të ruan ty.
- Dituria të bën të bindur në jetë dhe të lumtur pas vdekjes.
- Musliman i vërtetë është ai i cili i siguron të tjerët nga e keqja e gojës dhe e duarve të tij, përveç nëse ka arsye.
- Askujt s'i takon ta bezdis tjetrin, ndaj kujdesuni për çështjet e përbashkëta dhe personale para se të vdisni.

Kalifi më i dashur dhe njëkohësisht më i sulmuari nga muslimanët

Nuk mund të thuhet se Aliun e zgjodhën rebelët, por forma në të cilën u zgjodh

ai jepte sinjale të tilla. Aliu u zgjodh nga shumica dërmuese e muhaxhirëve dhe ensarëve të cilët ishin në Medinë, ndërsa ky qytet sikur e kishte marrë primatin për t'i emëruar kalifët. Aliu u zgjodh si personi më i parapëlqyer nga të gjithë të tjerët, ose si personi dy, i mbetur nga gjashtë kandidatët e përzgjedhur nga Omeri r.a..

Sikurse kemi thënë në numrin e kaluar, komplotistët kishin mendime të ndryshme rreth zëvendësit të Osmanit r.a. Ata filluan ta ndienin rrezikun, ndaj kërkuan që ta përshpejtonin puçin e tyre, duke e rrëzuar kalifin. Pesë ditë para vrasjes, ata kërkuan zëvendësimin e tij. Rebelët nga Egjipti, kërkuan prej Aliut të pranonte ofertën e tyre për kalif të ardhshëm, por ai refuzonte me çdo kusht. Pastaj, ata të Kufes shkuan te Zubejri, por atë nuk e gjetën në shtëpi. Ai ishte fshehur ose kishte ikur nga Medina. Edhe ata të Basrës nuk arritën ta bindin Talhan. Ai ishte justifikuar me shëndetin e tij të dobët. I gjithë ky presion i madh i rebelëve erdhi pasi Muhamed Ibën Ebi Bekr ua lexoi letrën e gjetur në trupin e djalit të Osmanit r.a.

Ata dështuan që ta kenë zëvendësin e kalifit. Situata po acarohej çdo ditë e më shumë dhe ata përfundimisht vendosën që ta vrisnin Osmanin r.a. Atë nuk e vrau e as nuk e masakroi Muhamed Ibën Ebi Bekër , por, pas atij veprimi makabër, rebelëve iu shtua frika e hakmarrjes. Ankthi i tyre ishte Muaviu, prandaj duhej të vepronin sa më shpejt. Për ta shuar frikën e tyre, vendosën shpejt e shpejt kalifin e ri dhe ikën secili në vendin e vet. Telalli lajmëroi se do të vriteshin njëherësh Aliu, Talha dhe Zubejri nëse Aliu nuk do të pranonte detyrën e kalifit. "Kur u vra Osmani ditën e xhuma (18 Dhul-hixhxhe 35 h.), njerëzit iu drejtuan Aliut për ta zgjedhur të parin e tyre para se të varrosej Osmani r.a. (thuhet se kjo ndodhi pas varrimit) . Alia nuk e pranoi dhe iku deri te kopshti i Benu Amër Ibën Mexhdul, që t'i shmangej njerëzve. Por ata shkuan dhe kërkuan prej tij me këmbëngulje që ai të pranonte. Në mesin e turmës ishin Talha dhe Zubejri të cilët i thanë: "Kjo punë e do të parin e tyre", dhe ata insistuan derisa ai e pranoi detyrën e prijësit të muslimanëve". (Ejub:230) Pa dëshirën e tij, por, për me qëllim që situata të mos eskalonte edhe më shumë dhe nga frika e vrasjeve të tjera që mund të ndodhnin, Aliu e pranoi ofertën e tyre, me kusht që kjo të ndodhte hapur edhe në prani të muslimanëve të Medinës, ndër të cilët do të duhej të ishin prezent edhe sahabët e mëdhenj , të cilët kishin marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Fatkeqësisht, disa prej sahabëve nuk do të pranonin t'ia jepnin besën , për shkaqe të ndryshme. Askush nuk e kontestonte personalitetin e Aliut dhe askush nuk e kundërshtonte atë për kalif, por disa prej tyre kishin vendosur të mos përziheshin fare në këtë lloj përzgjedhje të diktuar nga puçistët.



Emrat e prefektëve të rinj

Me t'u zgjedhur kalif, Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) i zëvendësoi prefektët e krahinave kryesore me përjashtim atë të Kufes . Këtë e bëri për shkak të papjekurisë politike që kishin treguar ish-prefektët e përzgjedhur nga Osmani r.a. dhe se këta konsideroheshin si shkaktarët kryesorë që sollën rebelimin e një numri të madh të besimtarëve dhe që katandisën tërë vendin duke vrarë kalifin dhe duke shkaktuar më vonë luftëra civile. Nga ky zëvendësim nuk shpëtoi as Muaviu, i biri i Ebu Sufjanit.

Të zgjedhurit e Aliut nuk ishin emra të njohur sahabësh, por pa dyshim që ishin më të mirët e kohës së tij. Ai do të caktonte në: 1. Jemen, - Ubejdullah Ibën Abasin, 2. në Basra, - Osman Bin Hunejf, 3. në Kufa,- Umare Ibën Shihab, 4. në Egjipt,- Kajs Ibën Sead Ibën Ubade dhe, 5. në Sham,- Sehl Ibën Hunejf. (Taberiu: 4/301)

Të gjithë u nisën për në detyrat e reja. Që të gjithë, me pak probleme, u vendosën në këto krahina, ndërsa prefekti i Shamit nuk do të arrinte asnjëherë të vendoset në pushtet, për shkak se nuk iu dha leja për të hyrë në Sham në kohën kur arriti në Tebuk. Ata që e penguan ishin rojtarët kufitarë të krahinës së Shamit, të cilët kërkuan prej tij që të priste lejen hyrëse nga Muaviu. Ndërsa ky i fundit nuk do ta përfillte vendimin e kalifit me pretekst se, ai ishte nën presion e rebelëve dhe vendimet e tij nuk do të duhej të ishin valide. Mospërfillja e Muaviut sikur i trimëroi disa nga krahinat e tjera dhe kështu, më vonë, u krijua një situatë jo e pëlqyeshme edhe për prefektët e Egjiptit, Basrës dhe të Kufes, sepse në këto tri krahina populli ishte i ndarë që në fillim, në përkrahësit e kalifit dhe ata që kërkonin hakun e vrasjes. Në Jemen, ish-prefekti Ja'la Bin Umeje e lëshoi postin pa asnjë fjalë, por e mori me vete tërë pasurinë shtetërore të krahinës, të cilën do t'ia dorëzonte më vonë ushtrisë së Aishes, Talhas dhe Zubejrit, të cilët tanimë ishin vendosur në Mekkë.

Flota bizantine në brigjet e territorit musliman

Do të kishte qenë shumë naive sikur perandoria bizantine të mos e kishte shfrytëzuar rastin e kësaj katrahure politike, të krijuar pas vrasjes së Osmanit r.a. në shtetin islam, edhe pse perandori bizantin ishte i ri në moshë. Ai do të përpiqej ta befasonte ushtrinë muslimane. Për këtë orvatje të tij, historiani Taberiu na sjell një detaj, ose më saktë orvatjen e Konstantinit, birit të perandorit të madh Herakliut, për të rimarrë tokat muslimane. Mirëpo, për fat të mirë të muslimanëve, ky perandor qe pa përvojë të madhe, edhe pse kishte arritur të ndërtonte një flotë marine prej një mijë anijesh. Nisja e kësaj flote ishte bërë në kohën më të papërshtatshme për anijet e Konstantinit dhe, gjatë këtij rrugëtimi për në tokat islame, këto anije u shkatërruan nga dallgët e mëdha të krijuara nga moti i lig në det. Prej kësaj ekspedite kishin shpëtuar shumë pak marinarë, midis tyre ishte vetë perandori Konstantini. Meqenëse perandori i tyre kishte dështuar në këtë orvatje, kabineti i tij kishte marrë vendimin më fatal për perandorin, duke e ekzekutuar.

Nuk ka dyshim se ushtria e Muaviut, në kohën e Osmanit r.a., kishte përparuar edhe më shumë në drejtim të tokave të Perandorisë Bizantine. Mirëpo versioni i paraqitur nga Taberiu thotë se flota bizantine ishte shkatërruar nga stuhia e madhe e detit, e jo nga ushtria e Muaviut. Elementi tjetër është se kjo ngjarje është shkruar në vitin 36 hixhri ose 656/7 gregorian. Mirëpo Taberiu nuk na tregon se vdekja e perandorit bizantin erdhi shumë më vonë se shkatërrimi i kësaj flote, por ai tregon se, ai u mbyt nga personeli i vet.

Këtu kemi një mospërputhje të vogël. Burimet bizantine thonë se marina e tyre u shkatërrua në betejën e madhe midis muslimanëve të komanduar nga Muaviu dhe Konstantinit, një vit para se të vdiste Osmani r.a.: "Konstantini II u vu personalisht në krye të flotës bizantine e më 655 i sulmoi arabët pranë bregdetit të Lidisë. Kjo betejë e parë midis arabëve e Bizantit përfundoi me një disfatë të plotë të bizantinëve. Vetë perandori u rrezikua me jetë dhe u shpëtua vetëm nga heroizmi dhe nga shpirti i sakrificës i një ushtari të ri bizantin." (Ostrogorsky: 93)

Ndërsa sa i përket vdekjes së këtij perandori, burimet bizantine tregojnë se atë e vranë personat e tij më të afërt në rezidencën e vet. "Për fat të mirë perandori nuk i shqetësoi më, sepse vdiq nga një vdekje e dhunshme dhe e turpshme më 15 shtator 668. Gjersa po sapunisej në banjë, një nga ndihmësit e tij grek, i kapluar nga një shkulm i papërmbajtur nostalgjie, e vrau me mbajtësen e sapunit" (Norwich: 100)

Cili nga këto dy versione është i vërtetë vetëm një Zot e di. Sido që të ketë qenë, dy versionet tregojnë për shkatërrimin e plotë të flotës bizantine dhe për vrasjen e turpshme të perandorit. Duke qenë se bizantinët nuk kishin forcë për t'i shkaktuar dëme të mëdha shtetit islam, ata, në vitin 659, pranuan ofertën e Muaviut për një armëpushim. S'ka dyshim se Muaviu ishte një strateg dhe një diplomat i madh, prandaj ai deshi t'i siguronte kufijtë e shtetit edhe sikur t'i paguante tribute (xhizje) të vogla Perandorisë Bizantine. Në anën tjetër, edhe bizantinët e mirëpritën këtë armëpushim sepse ata do të siguroheshin se Muaviu nuk do t'i sulmonte, ndërsa ata tani kishin kohë të mjaftueshme për t'i pastruar hesapet me sllavët e Ballkanit, të cilët kishin ngritur krye kundër perandorisë. ■

---

1. Fatimja kishte lindur Hasanin, Hysenin, Zejneben dhe Umul Kulthumin, Hevleja - Muhamed Ekber, Lejla - Ebu Bekrin, Umul Benije - Xhaferin dhe Abdullahin, Umul Veledja - Muhamed Esgar, Esma - Jahjanë dhe Avninë, Umame - Omer Ekberin dhe Rukijen, Umul Said - Umul Hasen dhe Remlette El Kurba, ndërsa Osmanin, Zejneb Es Sugra, Fatime, Umame, Hadixhe, Umul Kiram, Umul Xhafer, Shumane, Nefisa dhe Umu Seleme janë nga nëna të tjera. E solla gjenealogjinë familjare këtu, për arsye se shumica e fëmijëve të tij janë përndjekur dhe vrarë, si dhe ajo do të na shërbejë për në temat në vijim. Vuajtjet e kësaj familje s'do të ndalen, sidomos pas vrasjes së nipit të Muhamedit s.a.v.s., Huseinit. Përndjekja e tepruar në njërën anë dhe përkrahja në anën tjetër sollën fraksionin e madh shiit në ummetin musliman.

2. Një argument tjetër i cili vërteton se Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) nuk ishte në armiqësi as me Ebu Bekrin e as me Omerin r.a., e aq më tepër tek ai nuk vërehet asnjë shenjë xhelozie për postin e prijësit të muslimanëve. Përkundrazi, ai gjithmonë ka qenë pranë Ebu Bekrit dhe Omerit. Ai kishte rolin e këshilltarit dhe gjykatësit të umetit.

3. Këto hadithe dhe shumë të tjera të këtij lloji, shpeshherë kanë zgjuar debat të madh në shoqërinë muslimane. Këto hadithe do të interpretohen sipas mënyrës së vet, me të dalë në skenë grupet ose sektet e shumta pas përfundimit të dy luftërave civile 656-661 dhe 680-692.

4. EJUB, Hasan, "Katër halifët e drejtë", Botues, Furkan-Shkup 2003, f. 217

5. Hadithet janë marrë nga po i njëjti libër, f. 219.

6. Shumë transmetues kanë argumentuar se Talha ishte i paralizuar në dorën e tij të djathtë, të cilën e kishte lënduar në betejën e Uhudit.

7. Osmanit r.a. iu bë presion që të zëvendësonte prefektin e Egjiptit. Ai e bëri këtë dhe në vend të tij caktoi Muhamed Ibën Ebi Bekr. Pasi morën vendimin në dorë, Muhamedi dhe një pjesë e madhe prej përkrahësve të tij, u nisën për në Egjipt. Ishin larguar tri ditë udhë larg Medinës, kur ithtarët e Muhamed Ibën Ebi Bekër kapën një djalosh të dyshimtë në rrugë. Pas një kontrolli, atij ia gjetën një letër me vulë të kalifit. Pas disa pyetjeve, ai tregoi se ishte i biri i kalifit Osman r.a. (Dinuri: 37)

8. Rreth pyetjes, a e vrau apo jo Muhammed Ibën Ebi Bekër Osmanin, asnjë nuk e pohon se ai ishte njëri prej vrasësve. Prej shumë tregimeve zgjodha atë të Ebu Theur thotë, i cili tha: 'Kam përjetuar ditët e rrethimit të rezidencës së Osmanit. Isha duke i veshur rrobat e luftës dhe Alia po më vështronte. Nuk më ndaloi e as nuk më urdhëroi të shkoja. Kur erdhi koha për ta dhënë betimin për Alinë dola me të tjerët për t'ia dhënë besën. Ai doli nga rrethojat e familjes së Beni Mazinit, dora e tij ndryshonte nga duart tona, pastaj shkuam deri tek xhamia e ndritshme. I pari që hypi në mimber ishte Talha dhe ia dha besën, ndërsa dora e tij ishte e paralizuar, dhe e tërhoqi Alinë në mimber, i cili desh fluturoi. Pastaj besën ia dha Zubejri, Seadi dhe të gjithë as'habët e Pejgamberit s.a.v.s. Pak para se të zbriste Alia nga mimberi, kërkoi që t'i vinte Mervani, i cili kishte ikur prej tij. Pastaj kërkoi disa pjesëtarë të tjerë të emevitëve si dhe Ibn Muitin, por të gjithë këta kishin ikur...pastaj Alia shkoi tek gruaja e Osmanit r.a. dhe e pyeti. Kush e vrau Osmanin? U përgjigj: nuk e di, hynë njerëz të pa njohur për mua në shtëpi, do t'i njihja sikur t'i kisha pranë ndërsa me ta ishte edhe Muhammed Ibn Ebi Bekr. Alia e thiri Muhammedin dhe e pyeti atë për sa dëshmoi gruaja e Osmanit. Muhammedi tha: Është e vërtetë, vallahi hyra që ta mbysja, por në atë çast foli dhe më përkujtoi babanë dhe ika i dëshpëruar e i penduar. Pasha All-llahun nuk e kam vrarë e as që e kam prekur. Ajo (gruaja e Osmanit) tha: e tha të vërtetën, por ka qenë brenda..." (Dinuri, f.47)

9. Aliu ishte njeriu më i përshtatshëm dhe më i pranueshëm për kalif. Ai ishte i vetmi kandidat, i cili kishte mbetur nga gjashtë të përzgjedhurit e Omerit r.a. në garë me Osmanin r.a. Thënë ndryshe, gjykuar me logjikën e sotme, Aliu ishte në fakt zëvendësi i kalifit Osman.

10. Aliu u zgjodh kalif më 25 të Dhul Hixhxhes të vitit 35 h. Ditën e Xhuma ia dhanë besën shumica dërmuese e popullit të Medinës, me përjashtim të personave të theksuar në temë.

11. Këtë version e shohim te shumica e autorëve që kanë përshkruar ngjarjet historike të muslimanëve.

12. Një version tjetër thotë se Talha dhe Zubejri nuk ishin prezent në momentin kur Aliu do t'i jepte kushtet për të pranuar. Ata shkuan te Talha dhe Zubejri dhe kërkuan prej tyre me forcë që ta pranonin Aliun si kalif të muslimanëve. Ata e bënë, por betimi i tyre doli nga goja e jo nga zemra. (Dinuri. f. 46)

13. Ata që nuk e pranuan Aliun për kalif ishin: 1. Sead Ibën Ebi Vekas, 2. Abdullah Ibën Omeri (këta dy në fakt kishin abstenuar), 3. Usame Ibën Zejd, 4. Hasan Ibën Thabit, 5. Kab Ibën Malik, 6. Mesleme Ibën Muhaledi, 7. Fadlullah Ibën Ubejdi, 8. Kab Ibën Uxharahu, 9. Muhamed Ibën Mesleme, 10, Numan Ibën Beshir, 11. Zejd Ibën Thabit dhe 12. Rafi Ibën Hadixhi... (Taberi dhe Dinuri) Nga familja emevite, të cilët ishin në Medinë, nuk ia dhanë besën: Mervan Ibën Hakem, Seid Ibën As dhe Velid Ibën Ukbete (Tarih Jakubi, Bidaje ve Nihaje, Taberi...)

14. Shumë prej sahabëve u tërhoqën për shkak të hadithit të lartpërmendur në këtë numër.

15. Ebu Musa el Esharij, një vit para se të vritej Osmani r.a., ishte zgjedhur prefekt i Kufes. Ai me të dëgjuar se Aliu u shpall Kalif, dërgoi korrierin e tij me një letër, në të cilën thoshte se e mbështeste pa rezerva kalifin e tij të ri.

16. Përjashto Shamin, me prefekt Muaviun

17. Aliu vendosi ta shkarkonte edhe Muaviun, për shkak se ky i fundit nuk i ishte përgjigjur pozitivisht letrës së Aliut (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij), kur prej tij kishte kërkuar që t'i dërgonte një mijë ushtarë nga Shami. Letra e Aliut dërguar Muaviut: "...Të kam lënë, ashtu siç ishe më herët që të vendosësh për udhëheqjen dhe pasurinë. Paraprakisht kërkoj besën tënde dhe më dërgo një mijë ushtarë nga Shami.

18. Përgjigja e Muaviut: "...Nuk kemi asgjë për të ndarë midis nesh, përveç shpifjeve të përgjithshme dhe poshtërimit" (Dinuri, f. 49)

19. Për prefekturën e Kufes kishte shfaqur interesim Zubejri, por si duket Aliu do ta emëronte Shihabin, i cili nuk do të shkonte atje, sepse Ebu Musa shumë shpejt do të tregonte se ishte në lojalitet të plotë. Ndërsa për Basrën kishte shprehur dëshirë Talha. Sipas Aliut, Talha dhe Zubejri ishin dy personalitete shumë të rëndësishme për të dhe ai preferoi që t'i mbante afër vetes. Por, si duket, këta dy do të zemërohen me vendimin e tij dhe pas katër muajsh qëndrimi në Medinë, këta të dy kërkuan prej Aliut të shkonin në Umre. Alia i lejoi edhe pse e dinte fare mirë se këta dy nuk kishin për qëllim Umren, por të iknin nga Medina dhe të shikonin mundësi të tjera veprimi personale. (Dinuri: 52) Ibni Kethiri thekson të njëjtën gjë sikurse edhe Taberiu, se flota bizantine kishte pësuar humbje të madhe nga dallgët e detit në muajt e parë të kalifit Ali (35 h), por ky tregohet më preciz rreth vrasjes së perandorit. "Kur hyri në rezidencë, atij ia përgatitën banjën, dhe mu aty e mbytën" (Bidaje we Nihaje: 5/461)

Muslimanët ndërmjet Ok



Dr. Murad W. HOFMANN

Unë jam gjerman dhe jam musliman. Mund të duket e pakuptimtë që krenohem se jam gjerman. A thua unë i kam zgjedhur prindërit e mi? Në fakt, unë krenohem me atë që jam rritur në kulturën dhe gjuhën gjermane. Ndryshe thënë, që të dyja këto janë mjete për ta zgjidhur problemin. Po ashtu unë, me të vërtetë, mburrem që jam musliman.

Do të ishte, po ashtu, e pakuptimtë që unë të jem kryelartë se jam musliman. A thua, mos vallë, unë e kam zgjedhur Islamin, ose, a nuk më ka zgjedhur mua Allahu xh. sh. të rikonvertohem në fenë e Tij? Mu për këtë, unë në botën islame ndjehem si në shtëpinë time. Në realitet, çdoherë kur nuk gjendem atje ndiej mall për Mekën. A mos vallë, unë jam i mpleksur në mes dy kulturave dhe dy mënyrave të jetesës? A thua është e pamundshme të jesh me prejardhje dhe prind oksidental dhe të jesh musliman në të njëjtën kohë?

Unë mund t'i mohoj të gjitha këto pyetje: Islami që nga fillimi kumtohej dhe prezantohej si fe universale, e cila vlen për të gjitha kohërat dhe të gjitha hapësirat. Por, për çfarë shkaku i Dërguari i Allahut xh. sh., Muhamedi a.s., u drejtohet të gjithë sunduesve në Arabi, madje edhe para çlirimit të Mekës, duke i ftuar në Islam? Për çfarë shkaku gjeneratat e para të muslimanëve do të shpërndaheshin nëpër botë si tymi i malit të ndezur? Ky është fillimi i globalizimit të Islamit, i cili në shekullin e XX-të dhe XXI-të, po bëhet realitet.

Kur jam prezent në mbledhjet vjetore të Udhëheqjes së Lartë Islame në Egjipt, takohem me muslimanë nga Japonia, Ukraina, Venezuela, Kolumbia, Kanadaja, Argjentina, Koreja, Finlanda, Suedia dhe Afrika Jugore. Pluralizmi kulturor është i tillë, gjersa një herë kam numëruar dyzet e shtatë kapela të ndryshme, gjegjësisht dyzet e shtatë forma të ndryshme me të cilat meshkujt kishin mbuluar kokat e tyre. Shtetet prej nga vinin këta persona asnjëherë nuk konsiderohen shtete islame. A thua Irani, Turqia, Afganistani ose India, janë konsideruar si potencial për vend musliman para se populli i atjeshëm të pranonte Fenë Islame? Nëse këto vende janë shndërruar në shtete muslimane, pasi me shekuj të tërë kanë qenë vende krishtere, hinduse ose zaraostriane, pse të mos jetë e mundur që një gjë e tillë të ndodhë një ditë me Danimarkën ose Portugalinë? Po, Muhamedi a.s. ka qenë arab nga familja hashimite e fisit të Kurejshëve, edhe Kur'ani është formuluar në dialektin e krahinës në fjalë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Allahu xh.sh. është arabofon, ose, për të qenë dikush musliman i vërtetë, paraprakisht, duhet të shndërrohet në beduin hixhazian i shekullit të VII-të. Islami dhe Oksidenti, shikuar nga ky këndvështrim, nuk i takojnë poleve të kundërta që nuk mund të bashkohen. Po ashtu, relacionet ndërmjet tyre nuk janë as të thjeshta, as të lehta. Për shembull, disa miq të mi muslimanë nga Gjermania, Britania, Franca ose nga Shtetet e Bashkuara, refuzojnë dhe injorojnë civilizimin perëndimor- të mirat dhe të këqijat e tij - deri në atë masë saqë e demonizojnë atë, e llogaritin atë si kulturë femohuesish, pjesëtarët e të cilës jetojnë në një paganizëm modern, që korrespondon me atë të xhahilijetit. Në sy të personave në fjalë, kjo është mbretëri e satanit të mallkuar, siç e kishte zakon dikur të shprehej edhe i ndjeri Ajatullah Homeini. Kurse disa të tjerë janë thjesht të magjepsur nga kjo kulturë, madje edhe nga një aspekt i kulturës oksidentale. Ky rregull vlen në veçanti për studentët arabë, pakistanezë, egjiptianë, marokenë, tunizianë dhe libianë në perëndim dhe për gjeneratën e dytë të emigrantëve - punëtorëve muslimanë në përgjithësi. Shumica nga këta janë në gjendje të përvetësojnë çdo



ksidentit dhe Orientit (1)

cilësi të civilizimit perëndimor, deri në atë masë sa që të jetojnë si "muslimanë të kulturuar", të cilët nuk e praktikojnë Islamin, por dëfrehen me begatitë konsumuese të shtetit në të cilin jetojnë si emigrantë. Tejet interesant është fakti që të dy palët mund të ofrojnë prova relativisht bindëse në mbrojtje të pozitave përkatëse.

II

Ata të cilët e injorojnë Perëndimin, thonë se historia e Perëndimit është serial katastrofash që nga fillimi i të ashtuquajturës renesancë. Nga fundi i shekullit të XVII-të, e ashtuquajtura periudhë racionale ka aguar në Europën, e cila deri në këtë kohë lëngonte nga errësira dhe tirania e klerikëve të korruptuar. Mendjet udhëheqëse të periudhës së Descartes-it, Hume-s, Kant-it, Voltair-it, Göthe-s, Fredrick-ut II, nuk e mbronin ateizmin kur ata distancoheshin nga dogmat krishtere. Ata si "deistë", gjegjësisht persona, të cilët nuk pranonin dogmat krishtere: karakterin hyjnor të Isait a.s., trinitetin e shenjtë, etj. – në esencë afirmonin atë që në terminologjinë islame quhet teuhid/monoteizëm. Duke e çliruar njerëzimin nga robërimi i mendjes dhe ndërgjegjes nga ana e kishave dhe duke i dhënë supremacion mendjes njerëzore, nuk kanë pasur për qëllim të predikojnë dhe propagandojnë ateizëm. Por kjo, më në fund, do të ndodhë detyrimisht. Në fund të shekullit të XIX-të, Nietzche do të ishte në gjendje të shpallte "vdekjen e Zotit", kurse ideologjia marksiste, edhe zyrtarisht, do të marrte formë ateiste. Kjo është më se normale ngaqë njerëzimi, gjatë dhe pas renesancës, kishte përkrahur politeizmin, duke e shpallur njeriun për kriter definitiv të çdo gjëje. Që nga kjo kohë, Oksidentin e karakterizon ose deifikacioni implicit i shtetit (kolektivi) ose impliciteti deifikativ i njeriut (individi). Në këtë kontekst, racionalizmi shovinist, fashizmi (së bashku me racizmin), komunizmi dhe liberalizmi i shfrenuar, të gjithë do të jenë tipare perëndimore. Perëndimi është vendi dhe kultura e parë që njeh historia botërore, e cila është shndërruar në agnostikë, edhe teorikisht edhe praktikisht. Perëndimi e ka humbur tërësisht aspektin transcendental. Edhe pse akoma përfiton nga tradita krishtere, ajo tashmë nuk është e tillë, në kuptimin e drejtë të fjalës.



Pasojat janë dramatike. Në fanellat e të rinjve mund të lexoni formulimin perfekt të filozofisë hedoniste bashkëkohore "unë dua zbavitje TASH". Nëse kënaqësive emocionale të individit, qoftë edhe një herë, u jepet statut i prioriteteve shoqërore, natyrisht, normat ekonomike fillojnë të lejojnë çdo gjë. Civilizimi oksidental sot, me të vërtetë, është i përqendruar në çështjen e maksimalizimit të fitimit dhe optimalizimin e prodhimit. Ironik është fakti se, gjatë procesit në fjalë, qenia njerëzore është reduktuar vetëm në faktor irracional, i cili vetëm mund të ndryshojë prodhimin, statistikat dhe kibernetikën. Në këtë mënyrë, njeriu i lirë perëndimor humb dinjitetin e vet, gjersa, kushtimisht, "realizon vetveten".

Dramatike janë edhe pasojat në aspektin etik. Harxhimet masive, të propaganduara nga masmediat, rrënojnë tabutë një nga një. Sot shprehja "gjithçka kalon", është slogan operativ. Gjatë këtij procesi materializmi i shthurur shkatërron familjen, institucionin themelor të një shoqërie të shëndoshë. Në SHBA, momentalisht, vetëm 15% nga kurorat e përgjithshme kanë mundësi të jenë valide.



Qindra mijëra femra parapëlqejnë të jenë "nëna të vetëushqyera". A thua mund ta parashikojë dikush, çka do të ndodhë kur në shoqëri do të anëtarësohen aq fëmijë pa prindër, të shkatërruar emocionalisht?

Femrat pretendojnë se "realizojnë dhe paracaktojnë ardhmërinë e vet", kur vendosin për vdekjen/mbytjen e fëmijëve personalë të palindur nëpërmjet abortit. Dallimi mes të tashmes dhe asaj ç'ndodhte në kohën e injorancës paraislame, është se sot edhe fëmijët meshkuj mbyten. Pornografitë janë bërë gjithëpërfshirëse; ju nevojiten vetëm disa minuta për të vizituar tridhjetë kanale televizive. Gjatë shëtitjes nëpër këto kanale do të keni mundësi që në ekranin tuaj të shihni disa vrasje, kidnapime dhe femra tërësisht të zhveshura.

Për perëndimorët, për të cilët çdo gjë llogaritet me pará, edhe koha është pará, por disa herë është shumë e shkurtër. Për këtë shkak, ata kërkojnë intensivisht instanca dëfrimi nëpërmjet elementeve të ndryshme, siç është droga. Nëse kemi parasysh që duhani, alkooli dhe interneti, po ashtu, krijojnë varshmëri mund të konstatojmë se kultura perëndimore është kultura e parë në historinë botërore që është e varur nga aspekti strukturor. Në Perëndim, tregun e drogës dhe atë të njerëzve/femrave e udhëheqin kriminelët. Lirisht mund të themi se për momentin, metropolet në të cilët rrugët janë relativisht më të sigurta, janë metropolet muslimane, si Kajro dhe Stambolli. Në



shumë qytete në Perëndim, zgjidhja më e mirë për ju është, që pasi të bjerë muzgu të qëndroni në shtëpi. Perëndimi, krahas disharmonisë që posedon, e ofron veten si model ekskluziv, i cili është i detyrueshëm për të gjithë popujt e tjerë. Kulturave, të cilat kundërshtojnë imitimin, u kanosen me margjinalizim. Ky është në realitet mesazhi i vërtetë kur Francis Fukuyama në vitin 1991, pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik prezanton "Fundin e historisë", që do të thotë, që i ashtuquajturi, "projekt i modernizimit", ndryshe e njohur edhe si "mënyra amerikane e jetesës" ose si "Makdonalizëm" paraqet kulminacionin e patejkalueshëm për të gjithë kohërat. Për personat e këtillë, bota në të ardhmen do të jetë e ndarë vetëm në perëndimin përparimtar dhe botën e ngelur. Samuel Huntington, madje, parasheh edhe luftëra të përgjakshme ndërmjet dy mbretërive, arrogancë kjo të cilën muslimanët e quajnë "imperializëm kulturor". Ky është një emër i gabuar, ngaqë nuk ekziston ndonjë master plan i madh që qëndron pas, pos tinejxheri i quajtur Bill Gates. Megjithëkëtë, si rezultat, globalizmi tekno-kulturor, dëshmitar të të cilit jemi të gjithë ne, funksionon si areligjioz, si vazhdimësi ideologjike e kolonializmit.

Tash të shikojmë me kujdes historinë e të vetëquajturës qendër racionale në botën perëndimore. Që nga shekulli i XVIII-të, për dallim nga idealet e mëdha të përfolura dhe të ekspozuara, ajo që vërehet dhe zbulohet në sjelljen reale është tejet shqetësuese: tregti me robër dhe aparteid, dy luftëra botërore të përgjakshme, pastrim etnik (në realitet fetar) në Bosnjë, sulme atomike kundër qytetarëve të pafajshëm në Hiroshimë dhe Nagasaki. Tragjeditë në fjalë janë më të përgjakshmet që bota i ka njohur dikur. Madje, edhe atëherë kur kombet perëndimore nuk ishin në luftë mes vete, ata kanë përdorur dhunën kundër natyrës, edhe kundër florës dhe faunës, kafshëve dhe bimëve, mineraleve deri në shkatërrimin e resurseve dhe katastrofave ekologjike, siç është rasti me ndotjen ekologjike, e cila rrezikon ekzistencën e njerëzimit. Asnjë nga anashkalimet dhe keqpërdorimet që cekëm më lart nuk ka ndodhur në botën islame. Por, megjithatë, Oksidenti, krahas të kaluarës së këtillë, kërkon, saqë edhe obligon, që bota e ngelur të shembëllehej nga Perëndimi dhe mohon jo vetëm ekzistencën, por edhe mundësinë e ndonjë alternative tjetër. Tash do të bëhet më e qartë, pse një libër timin, të botuar në vitin 1992, e emërova 'Islami si alternativë', nga që ekzistojnë mjaft arsye për ta kritikuar Perëndimin.

III

Ekzistojnë edhe shumë pretekste për të pranuar Perëndimin e njëjtë, atje dhe vetëm atje, ndoshta jo me dozë ideale, janë të zhvilluara metodat dhe proceset për mbrojtjen efektive të qytetarëve nga keqtrajtimet e strukturave shtetërore. Flas për demokracinë dhe sundimin e së drejtës. Atje, dhe askund tjetër, varfëria thuajse nuk ekziston. Atje dhe vetëm atje, shkenca dhe mjekësia ka përparuar me hapa dhe zhvillim gjigant. Kjo që them është më se e vërtetë, por fatkeqësisht, raste identike është dashur të ndodhin në botën islame, ashtu siç kanë qenë, kur është në pyetje arti dhe shkenca, gjatë periudhës abasite në Andaluzi. Po ashtu, në aspektin politik, zhvillim i njëjtë me atë të Perëndimit ka mundur të realizohet edhe në botën islame, ngaqë, sipas Kur'anit, çdo musliman është individ i lirë, madje është edhe halife (mëkëmbës i Allahut në tokë) dhe se mirëqenia shoqërore, barazia dhe drejtësia, gjithashtu, janë parime islame. Realiteti, fatkeqësisht, është ashtu siç e dimë të gjithë ne, deri në atë masë gjersa Muhamed el-Gazaliu ka vërejtur se ka shumë Islam në Perëndim (krahas faktit që muslimanët janë të paktë atje) dhe pak Islam në botën muslimane (krahas numrit të madh të muslimanëve atje). Në këtë kontekst, Muhamed Asad, dijetari perëndimor musliman i rëndësishëm i këtij shekulli, më ka thënë se ishte mjaft i lumtur që e kishte pranuar Islamin në rini, në vitin 1926; duke pasur parasysh gjendjen në të cilën gjendet bota muslimane tash, pasi ndoshta më vonë nuk do ta gjente rrugën e shehadetit/dëshmisë. ■

Vazhdon në numrin tjetër.

Prej fashizmit deri te terrorizmi

Senad RAMADANI

Një erë që po fryn me shpejtësi të madhe, sidomos nga vendet e Lindjes: nga Polonia në Hungari, deri në Bashkimin Sovjetik. Një galaktikë komplekse dhe e fragmentizuar, që frymëzohet drejtpërdrejt nga Rajhu i Tretë, edhe për sa u përket simboleve. Rrjeti i nazistëve të rinj i ka shtrirë kufijtë e tij nga zemra e Gjermanisë në Francë, nga Spanja në vendet skandinave, nga Anglia në laboratorët e rinj të Lindjes, Poloni, Rumani, Hungari, nga Greqia në Qipro, Itali dhe pastaj në Rusi. "Po përhapet një urrejtje sa e vjetër, aq edhe e re kundrejt të huajve, duke u bërë diçka e vazhdueshme dhe e zakonshme", - tregon Cono Tarfusse, gjykatës në Gjykatën Kriminale Ndërkombëtare të Hagës. "Është një ndjenjë e thellë dhe në të njëjtën kohë boshe, e përhapur nga informacionet nacionaliste me tipare të theksuara ksenofobe. Risia është se armiqësia nuk është vetëm kundrejt emigrantëve, minorancave etnike e fetare. Urrejtja shtrihet te të gjithë të huajt. E vërteta është se shoqëria, si pasojë e mungesës së kulturës, nuk arrin të vendosë kufij natyrorë me qëllim që t'i izolojë këta njerëz dhe mos t'u lërë hapësirë dhe terren kultivimi". Sot, që nga koha e fundit e komunizmit, ky fenomen ka dimensione të rëndësishme, sidomos në Lindje". Parti, organizata ose grupe të ndryshme, sipas vlerësimeve, mendohen se janë 250 mijë militantë neonazistë në Evropë. 50 mijë të tjerë vetëm në Rusi. Rrjeti i lidhjes është interneti. Në Poloni gjendet liga e familjeve polake, aleanca e partive nacionaliste që zgjodhi Presidentë të Republikës Lech Kaczinskin. Vendimtare për fitoren në balotazhin e vitit 2007 ishte ndihma e dhënë nga radio "Maryja", një transmetues klerikal, antikomunist (shumë herë është dënuar nga Vatikani), që iu drejtua rreth dy milionë zgjedhësve. Polonia kufizohet me Gjermaninë në perëndim dhe në jug me Republikën Çeke e Sllovakinë. NPD (Partia Nacional- Demokrate gjermane, themeluar 45 vjet më parë nga ish-pjesëtarë të Partisë socialiste të Rajhut gjerman) e Ugo Voight vazhdon të prezantojë përfaqësuesit e saj në landet e ndryshme, pavarësisht se një pjesë e popullsisë e quan një parti filonaziste, raciste dhe antisemite. Në Evropën Qendrore: Hungaria, Republika Çeke, Sllovakia: tri vende me demokraci të re pas më shumë se gjysmë shekulli komunizëm, sot janë pjesë e BE-së. Në Bratislavë ekstremizmi antisemit u përhap në qeveri nga kryeministri populist Robert Fico. "Fundi i komunizmit hoqi pengesat për të djathtën ekstreme. Dikur ishte margjinale, ndërsa sot po rritet me shpejtësi në çdo anë", - shpjegon Guiseppe Scaliati, autor i esesë "E djathta radikale në Evropë". Në Budapest, rreth 7 mijë pasuesit e gardës hungareze sfilojnë në qendër të veshur me uniforma të zeza, me kryqe të thyer në krah. Evokojnë Holokaustin, ëndërrojnë një "zgjidhje përfundimtare për çështjen e romëve" dhe përballen me policinë në përleshje të dhunshme në Pragë. Romët kanë përfunduar edhe në shënjestrën e rumunëve të "Noua Dreapta" (ND), ekstremistët që kanë ngjallur gardën e hekurt të Corneliu Zelea Codreanus, aktive në vitet '30. Të rinj, të veshur me këmisha jeshile ose të zeza, e konsiderojnë veten si organizata më e rëndësishme neolegjionare e Rumanisë. "Duam të zgjojmë ndërgjegjen e njerëzve duke i paralajmëruar për rreziqet që kërcënojnë popullin rumun", - tregon lideri 30-vjeçar, Tudor Ionescu.





Në Serbi dhe Kroaci nostalgjia për liderët e vjetër nacional-socialistë, mbështetës të spastrimit etnik, përzihet me intolerancë. "Zonat e Ballkanit janë laboratori i privilegjuar i nazistëve të rinj. Aty bëhet një përzierje dhe marrëveshje mes lëvizjeve të Evropës Perëndimore dhe atyre të vendeve të Lindjes. Për shembull, neofashistët italianë kanë raporte shumë intensive me këto vende", - shpjegon specialisti Saverio Ferrari. Në Rusi, sipas burimeve të policisë, mendohet se janë mbi 50 mijë militantë neonazistë aktivë në ish-Perandorinë Sovjetike. Vetëm në Shën Petërburg numërohen rreth 20 mijë "Skinhead". Janë pikërisht ata autorët e një sërë agresionesh kundër qytetarëve të huaj, nën moton "Rusia për rusët". "Uniteti nacional rus" dhe "Grupi nacional- socialist" janë dy grupimet më të rëndësishmet në vend. Ata rreshtohen përkrah "Combat 18", grupimeve të videove me dhunë dhe paradave naziste në "You- Tube". Në vitin 2007, një xhirim dramatik bëri xhiron e botës: neonazistët e rinj që i prisnin kokën një të riu me origjinë nga Kaukazi. Përgjegjësinë e morën nacional-socialistët e "Rus" (fjalë e përdorur nga neonazistët për të përcaktuar atdheun e tyre). Të tjera parti për t'iu referuar janë: Partia Nacionale e Popullit

me 15 mijë militantë, gjysma e të cilëve nën 22 vjeç, Partia Liberal-Demokrate e Vladimir Zhirinovskit, zëvendëspresident i Dumas ruse, i detyruar në vitin 2003 të pranojë origjinën e tij hebreje. Të shtien frikën nacional-socialistët e Konstantin Kasimovskit, që i referohen ideologjisë hilteriane dhe që kanë si simbol kryqin e zi. Në Angli, pas agresionit të liderit të "British national party", Nick Grifin, në dëm të një nxënësi hebre, është rritur intoleranca drejt popullsisë me origjinë izraelite. Njëlloj si në Francë, ku Fronti Nacional i Le Penit, që u rendit i treti në zgjedhjet e 2007-s me 17.79 për qind, po fiton terren. Në Spanjë po avancojnë neonazistët e Falangës spanjolle; në Greqi Aleanca Patriotike e ka zgjedhur liderin e saj edhe në Parlament, ndërsa ekstremistët e "Laos" dhe "Albadoro" kërkojnë të bëjnë edhe një lloj festivali për nazistët e rinj. Në Suedi po kthehet në modë Partia e Rajhut nordik, e themeluar në vitin 1956 dhe drejtuar nga "luftaraku" Assar Oredsson. Në Austri kemi Bzoe, lëvizjen e themeluar nga Jorg Hider. Informacionet e Shërbimeve Sekrete Gjermane flasin për grupe neonazistësh që veprojnë në kufirin mes Austrisë dhe Gjermanisë, më konkretisht në qytetin e lindjes së Hitlerit në Branau. Në fund vjen Italia, ku shquhet Forca e Re, Rinia Hitleriane etj.

Me gjithë këto grupacione të rrezikshme ksenofobiste, bota frymon frikshëm, por për çudi asnjëra prej tyre nuk apostrofohet pothuajse asnjëherë. Të gjitha i mundi vetëm një 'problem': siç po e quajnë 'terrorizmi islamik'. Po pse vallë quhet kështu?! Mund të ketë terroristë muslimanë, por pse islamikë? Islam është feja, musliman është përkatësia. A thua nuk i dinë këto gjëra përdoruesit e këtij vokabulari? Apo ndoshta duan të thonë se feja është terroriste?!

Këto ditë hetimi që holandezët i kanë bërë luftës në Irak ka nxjerrë në dritë se ajo nuk ka pasur bazë ligjore në aspektin e ligjit ndërkombëtar. Raporti 551-faqësh bën të ditur se rezolutat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitet '90, para fillimit të luftës, nuk u jepnin autoritet britanikëve dhe amerikanëve që të sulmonin Irakun. Në raport kritikohen edhe ministrat holandezë që përdorën informacionet e burimeve sekrete amerikane dhe britanike, sipas të cilave Iraku, pra pushteti i Sadam Huseinit, kishte armë të dëmtimit në masë, çka nuk doli e vërtetë më pas. (Vetë ish-ministri amerikan i mbrojtjes Donald Ramsfeld, i hutuar nga pyetjet e gazetarëve se ku fshihen armët irakiane të shkatërrimit në masë, ishte shprehur konfuz: 'atje, këtu, nën'). Sipas raportit, ministrat holandezë duhej të bazoheshin në vlerësimet e bëra nga Shërbimet Sekrete Holandeze dhe jo ato të huaja. Aty kritikohet ashpër qeveria holandeze e kohës që lejoi politikën të anashkalonte, madje të mos pyeste për ligjet ku vendosi që t'u jepte mbështetje amerikanëve dhe britanikëve në luftën e Irakut, e cila nisi në vitin 2003. Politikanët injoruan edhe Shërbimet Sekrete Holandeze, të cilat nuk kishin të njëjtin informacion me ato amerikane. Në fund të raportit thuhet shprehimisht se: "Aksioni ushtarak që u ndërmor ndaj Irakut nuk ishte i mbështetur nga ligjet ndërkombëtare". Bëhet fjalë për një raport shumë të gjatë dhe të shumëpritur nga politikanët, por edhe nga vetë holandezët. Në të thuhet se ndërsa Shërbimet Sekrete Holandeze kishin shumë rezerva për sa u përket armëve të dëmtimit në masë në Irak, politikanët besuan verbërisht informacionet e shërbimeve amerikane e britanike dhe morën vendime pikërisht duke u nisur nga këto burime informacioni. Këto hetime në lidhje me luftën nisën pas publikimit të disa materialeve të ministrit të dikurshëm të jashtëm të vendit, që nxorën në dritë dyshime mbi legjitimitetin e luftës. Holanda ishte një nga vendet që u dha mbështetje konkrete amerikanëve në sulmin që ndërmorën në vitin 2003 në Irak, por nuk pati një rol ushtarak. Në kohën kur qeveria vendosi të mbështesë Bushin në vitin 2003, Parlamenti ishte kundër një vendimi të tillë dhe, në vend që të ndiqnin ligjet, ndoqën vendimet e shteteve të tjera. Nuk përjashtohet mundësia që reagime të ngjashme të kenë edhe vendet e tjera. ■



Zoti, sh…



Mexhid YVEJSI

Zoti

Të gjithë popujt, kudo në botë, besojnë në Zot. Vetëdija për Zotin është e mishëruar thellë në mendjen, zemrën dhe shpirtin e njeriut. Plutarku ka thënë: "Njeriu mund të gjejë vendbanime pa mure mbrojtëse, pa shkrim, pa shkolla, pa teatro, por një qytet pa objekte fetare, ku adhurohet Zoti, askush s'e ka parë dhe as që ka për ta parë!"

Historiani dhe encikopledisti i njohur James Hasting, në veprën "Encyclopaedia of Religion and Ethics", shkruan: "Nuk ka popull në rruzullin tokësor, ose nuk ka gjuhë, që është pa emrin e Zotit".

Zoti dhe shqiptarët

Shqiptarët, si popull besimtar, i përqafuan dy religjionet monoteiste më të përhapura në botë: Krishterimin dhe Islamin dhe u shërbyen me devotshmëri, aq sa u bënë shembull edhe për popujt më të mëdhenj, më të zhvilluar e më të përparuar!

Shqiptarët dallohen nga popujt e tjerë edhe për një gjë: në gjuhën shqipe përdorën disa emra për Krijuesin e Gjithësisë. Atë e quajnë Zot, Allah, At, Hy, Perëndi, duke e respektuar secilin emër të Tij.

I pari dokument i gjuhës së shkruar shqipe, për sa dihet, " Formula e Pagëzimit" (1462) fillon me emrin e Zotit (Atit). Kurse libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, për sa dihet deri më sot, "Meshari" i Gjon Buzukut (1555), është një libër për t'i shërbyer Zotit.

Dy nga poetët dhe shkrimtarët më të shquar shqiptarë të letërsisë shqiptare, Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta, në veprat e veta, fjalën më të përdorur e kanë, pothuajse, fjalën Zot, Perëndi... Kështu ishte dikur, në të kaluarën, por çka ndodhi më vonë? Ndërhyri një dreq! Mos, o Zot më keq!

Zoti dhe gjuhëtarët

Gjuhëtarët tanë thonë:

qiptarët dhe gjuhëtarët

"Pas çlirimit (lexo: robërisë komuniste-ateiste) gjuhësia jonë bëri hapa cilësore përpara në përvetësimin e metodologjisë materialiste-dialektike të njohjes dhe të shpjegimit të fenomeneve shoqërore nga pikëpamja e teorisë marksiste-leniniste, duke kapërcyer një varg konceptesh të gabuara, të trashëguara nga e kaluara".

Duke u bazuar në këtë metodologji të zbatuar në "shkencën marksiste leniniste", gjuhëtarët shqiptarë vendosën rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Në Tiranë, që asokohe sundohej nga tiranët; me 25 Nëntor 1972, tetëdhjetë e shtatë (87) delegatë miratuan rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Në atë Kongres, ndër marrëzirat e tjera, u vendos që emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore, të shkruhen me shkronjë të madhe, (të gjitha fjalët që hyjnë në përbërjen e tyre, me përjashtim të nyjeve). P.sh. Sekretari i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. (Kapitulli VI, paragrafi 74).

Kurse, jashtë çdo rregulli, ose norme, duke e mohuar edhe traditën u vendos që emrat e përveçëm Allah, Zot, Hy, Perëndi të shkruhen me shkronjë të vogël! ! (Kapitulli VI, paragrafi 75).

Por gjuhëtarët shqiptarë nuk u mjaftuan vetëm me kaq. Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, të botuar në Tiranë më 1980, ribotuar në Prishtinë më 1981, hartuesit gjuhëtarë fjalën 'Zot' e shpjegojnë kështu:

"Zoti, sipas parafytyrimeve fetare e mistike, qenia më e lartë e mbinatyrshme, e trilluar nga fetë e ndryshme, e cila gjoja ka krijuar botën, qëndron mbi të dhe drejton gjithçka, perëndi, s'ka zot. Nuk i besojmë zotit". (Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980, ribotuar në Prishtinë më 1981, faqe 2248).

Përndryshe, Fjalori Amerikan i Gjuhës Angleze, i gjuhës më të përhapur në botë, sa për të bërë një krahasim me fjalorin e gjuhëtarëve tanë, fjalën Zot (God) e shpjegon kështu:

"Zoti, krijuesi dhe sunduesi i Gjithësisë, i përhershmi, Qenia Supreme, i plotfuqishmi, i plotëmëshirëshmi, i adhuruari nga njerëzit".

(New Webster's Dictionary of the English language, faqe 210, botuar në New York dhe Chicago, më 1975).



Shtrohet pyetja: ku mbetëm ne shqiptarët, duke u bazuar në "shkencën" marksiste-leniniste edhe në gjuhësi, këtë e përjetuam vetë, e ku janë amerikanët e "shkretë"...!?

Kuptohet, të gjitha ato vendime u morën në kohën e diktaturës komuniste-ateiste. Sistemi tiranik shtypte çdo mendim që lëshonte ndonjë rreze drite sado të vogël. Dritën e Vërtetë të Krijuesit diktatura s'mund ta shuante, por mbasi rrënoi edhe me dinamit objektet fetare: xhamitë, kishat, teqet, tyrbet, mbasi pushkatoi e burgosi dijetarët më të shquar të fesë, që i shërbyen Zotit, atdheut e kombit, më në fund tiranët urdhëruan që edhe fjala Zot të shkruhet me shkronjë të vogël!

Por deshi i Madhi Zot dhe diktatura komuniste-ateiste u rrënua si kullë prej letre, e bashkë me të u rrënuan edhe shumë ligje çnjerëzore e antikombëtare që ishin në fuqi...

Sot, emri i Zotit përmendet me lavdi, dashuri e simpati nga shqiptarët e të gjitha shtresave, që nga kryetarët, kryeministrat shqiptarë, e deri te fëmijët parashkollorë, secili në mënyrën e vet. Nga i Madhi Zot kërkohet që ta bekojë Shqipërinë, Kosovën, t'i bekojë shqiptarët, flamurin, gjuhën shqipe, deri edhe kushtetutën...

Mjerisht, kur vjen puna te gjuha e shkruar, e shkreta gjuha jonë, që disa e quanin gjuhë Perëndie (Rilindësit), bash fjala Zot shkruhet ende me shkronjë të vogël në shtypin tonë të përditshëm, javor, mujor, e ndër botime të ndryshme. Zoti, qoftë lavdëruar, ende shkruhet me shkronjë të vogël, ndërsa Partia, SIGURIMI, UDB-a, SHIK-u SHISH-i, shkruhen me shkronjë të madhe si në kohën e partisë....

Madje, edhe kur po intervistohen zyrtarë të lartë e veprimtarë të Bashkësisë Islame, të Kishës Katolike e të tjera, emri i Zotit, i dalë nga goja e tyre, në shtypin tonë, përveç atij fetar, shkruhet me shkronjë të vogël! A nuk është ky veprim një ofendim ndaj tyre?

Kur u rrëzua Muri i Berlinit të gjithë u gëzuan, ndoshta më së tepërmi u gëzuan njerëzit e penës, sepse shpata me dy tehe (censurë e autocensurë) ishte gati gjithmonë! Por muri në kokat e gjuhëtarëve e të gjithë atyre që merren me fjalën e shkruar, duket se qëndron ende i pa rrëzuar! A ka kuptim, njëzet vjet në kohën e demokracisë, të shkruhet emri i Zotit, edhe sot e kësaj dite, sipas vendimeve të një Kongresi të "Partisë"?

Nga tetëdhjetë e shtatë (87) delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të mbajtur në Tiranë më 20-25 Nëntor 1972, që u mbajt me bekimin e Partisë së Punës, nga Kosova mori pjesë edhe Dr. Idriz Ajeti, Dr. Besim Bokshi dhe Dr. Rexhep Qosja... Këta zotërinj të shquar, të tre akademikë, trutë e kombit, veprimtarë të dalluar, mbi të gjitha, me njohuri të thella gjuhësore e letrare, për këtë çështje kanë heshtur. Është çështja jo për një fjalë, por për një shkronjë. Të heshtësh edhe sot për këtë vendim do të thotë miratim!

Unë, si nxënës i tyre, preka një çështje për hir të gjuhës shqipe, për hir të traditës dhe për hir të drejtshkrimit! Përndryshe, edhe pse në gjuhën shqipe Zoti shkruhet me shkronjë të vogël – Zoti është i Madh. Zoti është më i Madhi. Të gjithë prej Tij jemi, të gjithë tek Ai do të kthehemi...■

Bashkëbisedim me balerinën, Vjollca Llugiqi

Pushtuesja e skenës

"Asgjë në jetën time nuk dua më shumë se sa baletin. Atë e kam në gjak. Baleti për mua është fryma që më ngroh."



Flamur MALOKU

Baleti në Kosovë nuk është aq shumë i përkrahur, por me ardhjen e ministrit të Kulturës, Valton Beqiri, si duket ka ndërruar edhe qasja për të mirë ndaj këtij arti. Mirëpo, pavarësisht lëvizjeve politike, përkrahja ndaj baletit lë për t'u dëshiruar. Ishin këto fjalët e një balerine të re, Vjollca Llugiqi, e cila prej vitit 2002 deri në vitin 2009 ka pasur shtatë premiera të mëdha të baletit klasik dhe të stilit "Dance theatre". Me shfaqjen "Performancë" me koreografinë e Gjergj Prevazit, Vjollca së bashku me trupin e baletit nga Kosova në festivalin e Elbasanit '2009' rrëmbyen edhe çmimin e koreografisë më të mirë. Janë këto të arriturat e një vajze të re, vetëm 22-vjeçare.

Në fytyrën e saj vërehet vazhdimisht lodhja, por në këtë lodhje ajo si duket ndihet mirë, sepse punon për shpirtin, siç thotë ajo. Gjatë bisedës që bëmë, Vjollca rrëfehet për vështirësitë e shumta që baleti ka si profesion, por dashuria e saj për këtë art është e madhe.

"Asgjë në jetën time nuk dua më shumë se sa baletin. Atë e kam në gjak. Baleti për mua është fryma që më ngroh". Ishin këto fjalët që buronin nga shpirti i një artisteje, që këtë vit i solli Kosovës edhe çmim. Pyetjes: - Pse gjithë ko dashuri për baletin, duke e ditur se baleti në Kosovë nuk është ndonjë profesion fitimprurës? – Vjollca iu përgjigj me buzëqeshje: - E di që baleti nuk është profesion fitimprurës, e sidomos në Kosovë, por kjo nuk më pengon aspak, sepse unë punoj për shpirtin tim, e shpirti im është baleti. E di që përkrahja nuk është e madhe. Institucionet e Kosovës nuk janë kujdesur shumë për baletin. Ka qenë një kohë, që fare nuk kemi pasur përkrahje. Mirëpo, me ardhjen e ministrit të kulturës z. Beqiri tanimë ka ndryshuar perceptimi ndaj baletit'.

Për artin sakrifikon edhe shëndetin

Puna në këtë profesion kërkon që ta sakrifikosh edhe shëndetin, por si duket edhe kjo nuk e pengon Vjollcën.

"Po është një profesion që kërkon ta sakrifikosh edhe veten, sepse çdoherë duhet të kujdesesh që pesha e trupit të mos bëhet pengesë për lëvizjet në balet. Ushqehemi shumë pak, madje edhe ky ushqim duhet të jetë i lehtë për organizmin" – shton Vjollca.

Edhe pse lodhja shihet në fytyrën e saj, aktivitetet nuk mungojnë. Deri më tash Vjollca, së bashku me trupin e baletit të Kosovës, kanë marrë pjesë në festivale të ndryshme si në Shkup, Ohër, Durrës. Në të gjitha paraqitjet e saj, Vjollca e ka mahnitur publikun. Kritikët e baletit në Shqipëri e kanë vlerësuar lart paraqitjen e saj, sidomos në Durrës, madje është komentuar se "Balerina nga Kosova, Vjollca Llugiqi është pushtuese e skenës".

Këtë vlerësim Vjollca e ka pritur mjaft mirë. "Unë nuk e di nëse jam ashtu, por mundohem që të jap maksimumin nga vetja ime, aq më shumë kur përfaqësoj vendin tim, Kosovën". Kohëve të fundit Vjollca është paraqitur në shfaqjen më të re "ONE MORE TWO FOR TANGO", me koreografi të Konstandin Urjevski-t nga Rusia, premiera e së cilës ishte më 15 nëntor. "Po jemi paraqitur me një shfaqje të re. Është një stil më ndryshe se të tjerët, një stil 'tango' dhe është mirëpritur shumë mirë nga publiku". Ishin këto fjalët e një balerine,që çdo ditë identifikohet si vlerë në skenën e baletit kosovar. ■



Intervistë me drejtorin e Instituti

35 projekte realizimin e t

Intervistoi: Astrit VELIQI

Drejtor i sapozgjedhur i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Hysen Matoshi, thotë se, përkundër rrethanave aktuale nëpër të cilat instituti albanologjik po zhvillon veprimtarinë e tij, viti që lamë është i suksesshëm. Janë botuar 23 vëllime shkencore, janë mbajtur shumë aktivitete e hulumtime shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Matoshi thotë se buxheti i Institutit Albanologjik, për vitin 2010, do të jetë rreth 119 000 euro, për gjithë veprimtarinë kërkimore, botuese dhe aktivitetet shkencore, duke përfshirë edhe shpenzimet e tjera për material pune. Sipas Matoshit, për vitin 2010, janë në plan për realizim 35 projekte shkencore, ndërkaq për planin botues janë propozuar 40 vepra të punonjësve shkencorë dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Institutit Albanologjik. Për të gjitha këto dhe çështje të tjera drejtori i IAP-it, Hysen Matoshi, flet për revistën "Paqja".

PAQJA: ***Z. Matoshi, tash së fundi keni marrë edhe timonin e drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Sa jeni të kënaqur me mbarëvajtjen e punës në Institut?***

Matoshi: Duke marrë parasysh rrethanat e përgjithshme në të cilat e zhvillon veprimtarinë Instituti Albanologjik, mund të themi se viti 2009 ka qenë vit i një pune të suksesshme. Me gjithë buxhetin e paktë, kemi botuar 23 vëllime, gjë që dëshmon për një përkushtim dhe vullnet të madh të punonjësve të këtij institucioni. Puna kërkimore-shkencore ka qenë një dimension tjetër i veprimtarisë së IAP-it. Gjatë vitit 2009, 5 punonjës shkencorë të IAP-it kanë qëndruar jashtë Kosovës për hulumtime shkencore. Punë terreni brenda Kosovës kanë realizuar edhe 6 punonjës të tjerë, kurse 15 punonjës të Institutit Albanologjik të Prishtinës kanë marrë pjesë në Festivalin Kombëtar të Folklorit në Gjirokastër, mbajtur nga 24 – 30 tetor 2009. Janë organizuar edhe veprimtari shkencore dhe përuruese të punës së IAP-it. Më 15 tetor 2009 është mbajtur sesioni shkencor 'Folkloristika

t Albanologjik, Hysen Matoshin

shkencore presin tyre për vitin 2010



shqiptare – dëshmi, probleme dhe plane' me pjesëmarrjen e 25 studiuesve nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia. Materialet e këtij sesioni janë botuar. Dega e Historisë ka organizuar një sesion përkujtimor-shkencor për mr. Sadulla Brestovcin, në 30-vjetorin e vdekjes së tij. Po kështu, Dega e Historisë ka organizuar një tryezë shkencore për jetën dhe veprën e dr. Flamur Hadrit Gjatë vitit 2009 janë zhvilluar edhe disa veprimtari promovuese të punës së Institutit Albanologjik.

PAQJA: ***Sa është buxheti për vitin 2010 dhe sa mund t'i plotësojë ky buxhet nevojat dhe kërkesat tuaja për të arritur rezultate pozitive?***

Matoshi: Buxheti të cilin e menaxhojmë si institucion është i pamjaftueshëm. Të tri Institutet (Albanologjiku, i Historisë dhe i Sllavistikës), që janë përfshirë në një kod financiar, do të kenë në menaxhim rreth 119 000 euro për gjithë veprimtarinë kërkimore, botuese dhe aktivitetet shkencore, duke përfshirë edhe shpenzimet e tjera për material pune. Kur jemi te buxheti, duhen përmendur edhe të hyrat vetjake, që janë rreth 54 000 euro. Vitin e kaluar, Institutit tonë i është lejuar shfrytëzimi i tyre në masën 40 për qind, ndërsa për vitin 2010 kemi bërë kërkesën që këto mjete të na lejohen në masën 100 për qind. Natyrisht kjo nuk do ta zgjidhte në tërësi çështjen, por do ta lehtësonte mjaft, sidomos në planin e veprimtarisë botuese. Është krejtësisht e qartë se për realizimin e projekteve ekzistuese janë të domosdoshme më shumë mjete dhe trajtim më i mirë i shkencës si veprimtari me interes të përgjithshëm shoqëror e kombëtar.

PAQJA: ***Cilat janë planet që keni në tavolinën për vitin 2010?***

Matoshi: Gjatë vitit 2010 do të punohet për realizimin e 35 projekteve shkencore, ndërkaq për planin botues janë propozuar 40 vepra të punonjësve shkencorë dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Institutit Albanologjik. Në këtë pikëpamje jemi të kushtëzuar t'i botojmë me prioritet revistat shkencore, pastaj monografitë – projekte të Institutit Albanologjik, etj. Në rrafshin e aktiviteteve shkencore, në tetor do të organizojmë "Javën e albanologjisë".

PAQJA: ***Sa po u mjafton ndarja e buxhetit për hulumtime të veçanta që kanë rëndësi, siç është epika?***

Matoshi: Lidhur me epikën me interes është mbështetja nga Qeveria e Kosovës e Projektit të hartuar nga Grupi i punës i Institutit Albanologjik që ka për synim përfshirjen e eposit të kreshnikëve në trashëgiminë botërore të UNESCO-s.

PAQJA: ***Me cilat institucione, si vendore po ashtu edhe të jashtme, keni bashkëpunim?***

Matoshi: Bashkëpunojmë me pjesën dërrmuese të institucioneve më të rëndësishme të albanologjisë te ne dhe në botë, sikurse janë akademitë e shkencave të Kosovës dhe të Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, Instituti Albanologjik i Shkupit, Instituti i Historisë i Kosovës, Universitetet e Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë etj.■

Vështrim

Tmerri i dokumentuar

Imer TOPANICA

Punimi në dorëshkrim i autorit Halit Barani, "Fakte dhe data" është një dëshmi autentike e periudhës së historisë më të re të Kosovës, ku shqiptarët u gjenden përballë sfidave të shumëllojshme shkombëtarizuese nga ana e pushtuesit serb. Ky botim përbën një punë të lavdërueshme, sepse në të gjejmë një material të bollshëm me fakte e dokumente konkrete të evidencuara nga autori përmes një përpjekje serioze – ngjarjet dhe ndodhitë e fushatave barbare kundër çdo gjëje me frymë shqiptare nga ana e qeverisë së Beogradit për të arritur qëllimin final të saj – likuidimin dhe shfarosjen e tyre. Autori në këtë punim përshkruan masat e ndërmarra nga ushtria dhe policia serbe ndaj fshatarëve, punëtorëve, qytetarëve, nxënësve, mësuesve, institucioneve kulturore – arsimore e shëndetësore, duke vënë në dukje politikën institucionale të dhunës, shpronësimit, shpërnguljes, kolonizimit etj., me synime e ide fikse për nënshtrimin e popullsisë shqiptare dhe për ndryshimin e përbërjes etnike të saj. Informacioni që jep autori, është autentik, me fakte e dukuri të zhvillimit arsimor, të jetës ekonomike, shoqërore, kulturore e politike të popullsisë vendase të pafajshme, e përshkruar me dënime, arratisje, plaçkitje, bastisje, keqtrajtime e gjenocid që pushtuesi serb ushtroi mbi popullatën shqiptare në Mitrovicë e rrethinë. Mbi këtë bazë, libri na përkujton kronikën e ngjarjeve dramatike, përmes veprimtarit të palodhshëm Halit Beranit, i cili, i ndodhur në një nga pikat më pikante në vlugun e ngjarjeve, ka mundur të shohë, të dëgjojë, të incizojë, të fotografojë e të përjetojë atë që s'kanë mundur të shohin, të dëgjojnë e të përjetojnë të tjerët dhe, kështu, ka arritur të lërë dëshmi të shkruara për ngjarje, ndodhi e fate njerëzish nga më të ndryshmet.

Guxim i arritur

Ngjarjet dhe faktet konkrete janë të sakta. Ato janë të plota dhe të thurura me shkathtësinë e një veprimtari të sprovuar, duke përshkruar e trajtuar me mjaft pjekuri, inteligjencë e stil bashkëkohor, pavarësisht nga kompleksiteti dhe vështirësitë e kohës në të cilën autori punoi dhe veproi.

Radhitja përmbajtësore dhe kronologjike e librit është e plotë dhe e qartë për lexuesin. Autori, me guxim, ka arritur t'i evidentojë dukuritë dhe veprimet e pushtuesit në çdo kënd të Mitrovicës e më gjerë, skenat e llahtarshme të një drame të paparë me gjenocid e dhunë që mendja e një qytetari evropian nuk mund t'i paramendojë. Meritë e veçantë e autorit është se ai ka vjelë shumicën e të dhënave në mënyrë direkte, aty për aty. Duke qenë gjithmonë pranë ngjarjeve a ndodhive, ai arrin t'i ndriçojë ato në mënyrë objektive e bindëse.

Në fund, mund të shtojmë edhe këtë: punimi i realizuar në nivel dhe cilësi të duhur është një bazë e fortë referimi që inkuadrohet në përpjekjet e studiuesve të ardhshëm shqiptarë e të huaj për të ndriçuar aspektet dhe çështjet jetike të popullsisë vendase e për të kontribuar në njohjen e opinionit ndërkombëtar me historinë dhe perspektivën e saj të fundshekullit XX. ■


Rreziku vjen nga Gjithësia



Agim AVDIU

Disa astronomë skeptikë e presin fundin e botës më 2012. Bazuar në rreziqet e shumta të trupave të ndryshëm qiellorë, ekziston mundësia që ndonjë trup i përflakur ta bëjë edhe më të keqen, ose më të paktën të sjellë ndonjë katastrofë të paimagjinueshme.

Kohëve të fundit një "shi meteorësh" ka rënë në çdo cep të Tokës: në Letoni (nëntor 2009), Indonezi (tetor 2009), Kanada (nëntor 2008), Sudan (tetor 2008), Peru (shtator 2007)… Cili do të jetë asteroidi tjetër që do të godasë Tokën? A jemi gati ta përballojmë rrezikun e një impakti shkatërrues, si ai që supozohet t'i ketë dhënë fund epokës së dinozaurëve 65 milionë vjet më parë? Si fillim duhet të sqarojmë diçka: nuk ka asgjë të veçantë në faktin se ndonjëherë Toka goditet nga një meteor (siç përcaktohet një asteroid që bie në Tokë). "Objekte të largëta jashtëtokësore, të gjera disa metra, godasin planetin tonë, të paktën një herë në gjashtë muaj, por në shumicën e rasteve copëtohen në atmosferë, duke i dhënë jetë bolidëve pak më të shndritshëm se yjet që bien, të cilat shkaktohen nga objekte edhe më të vogla", - thotë një astronom, i cili është edhe ekspert në këtë fushë. "Ndërsa objektet më të mëdha, rreth 10 metra, godasin Tokën një herë në 2 vjet". Në të kaluarën këto ngjarje kaloheshin në pjesën më të madhe të rasteve pa u vënë re, ndërsa sot shumë sy janë drejtuar nga qielli dhe shkencëtarët janë më të prirë t'i studiojnë këto fenomene, sigurisht me rezultate të rëndësishme edhe për sigurinë tonë. Rasti që ka tërhequr më shumë vëmendjen e mediave ishte ai i kraterit të gjetur pranë Mazsalacas, në Letoni, më 26 tetor të 2009-s. Ishte i gjerë disa dhjetëra metra dhe i thellë 5 metra. "Por kishte një formë të 'dyshimtë'", shpjegon astronomi. "Së pari, ishte një njollë e errët shumë e thellë që të kujtonte shenjën e lënë nga shpërthimet e forta të një eksplozivi si tritoli, me temperaturë disa mijëra gradë dhe e aftë për të djegur terrenin. Së dyti, përreth kraterit nuk ishte i pranishëm një material i veçantë, tipik për kratere. Dhe për ta mbyllur, ishte shumë dyshues fakti që nuk u gjet asnjë meteor". Në fakt, në harkun kohor të pak orëve u zbulua se në të vërtetë bëhej fjalë për një fushatë publicitare të kompanisë telefonike suedeze "Tele2", një iniciativë që autoritetet letoneze vendosën menjëherë ta gjobisnin me 17 mijë euro. Ndërsa krateri i sajuar në Letoni tërhoqi vëmendjen e gjithë botës, një ngjarje më e rëndësishme kaloi pa u vënë re: më 8 tetor të vitit 2009, në orën 11.00, një bolid shpërtheu 20 kilometra mbi ishullin e Sulawesi-n, në Indonezi, duke lënë gojëhapur popullin. NASA konfirmoi menjëherë ngjarjen, duke shpjeguar: "Mendohet se krateri 'Chicxulub' i detyrohet një asteroidi të vogël me diametër disa dhjetëra metra, që për shkak të bashkëveprimit të shpejtë me atmosferën, ka shpërthyer duke çliruar një energji rreth 50 tonë". Kjo mund të krahasohet me tri bomba si "Little Boy" që shpërtheu në Hiroshima në vitin 1945. Shpërthimi është regjistruar në 18 kilometra distancë (pothuajse gjysma e perimetrit të tokës) nga sensorët e infratingujve të instaluar për të paralajmëruar për shpërthimet e mundshme bërthamore. "Është pikërisht ky rreziku më i madh i episodeve të tilla", - thotë astronomi. "Nëse do të verifikohej një fakt i ngjashëm në një zonë të nxehtë të planetit, si në Indi, Pakistan ose Lindjen e Mesme, mund të ngatërrohet me një shpërthim atomik të rrezikshëm dhe të shkaktojë një reprezalje bërthamore". Mënyra më radikale për të ndaluar këto rreziqe është vëzhgimi i kujdesshëm i qiellit në kërkim të ndonjë rreziku të madh; dhe duke llogaritur, në rast përplasje me Tokën, vendin ku do të bjerë asteroidi. Ka ndodhur pikërisht kjo më 6 tetor të vitit 2008, kur asteroidi i vogël 8TA9D69, i riemërtuar më pas 2008 TC3, u dallua nga "Catalina Sky Survey". Në këtë pikë u aktivizua një sistem alarmi në shkallë globale, që në harkun kohor të pak orëve arriti të llogariste ekzaktësisht vendin dhe momentin e përplasjes me planetin tonë. Andrea Milani, një matematikan nga Universiteti i Pizës dhe babai i programit "Clomon 2", tregon se si ka funksionuar ky mekanizëm. "Sa herë që zbulohet një asteroid i ri, të dhënat relative astronomike dërgohen në qendrën 'Minor Planet Center' të Harvardit (SHBA) dhe përdoren për të llogaritur probabilitetin e një përplasjeje gjatë një shekulli. Llogaritjet kryhen nga programe të pavarura në Shtetet e Bashkuara ('Sentry', përdorur nga laboratori i NASA-s 'Jet Propulsion Laboratory' në Pasadena, Kaliforni) dhe Evropë ('Colmon 2' që rrotullohet në dy versione të ndryshme në Valadolid, Spanjë dhe në Pizë). Në rastin e asteroidit 2008 TC3, sistemi regjistroi automatikisht pamjet e asteroidit dhe parashikoi një përplasje brenda 24 orëve me një probabilitet 99.8 për qind: si pasojë u dërgoi një email alarmues të gjithë specialistëve të interesuar". Kështu, lajmi filloi të qarkullonte mes ekspertëve, ndërkohë që një program tjetër në laboratorin "Jet Propulsion Laboratory" llogariste vendin e përplasjes, që rezultoi të ishte në veri të Sudanit. Pas dy muajsh u organizua një ekspeditë, e koordinuar nga Peter Jenniskens, astronom i qendrës së kërkimeve SETI ("Search for Extra Terrestrial Intelligence") në Kaliforni. "Në atë vend u gjetën 47 meteorë", - komenton astronomi. Nga pikëpamja shkencore ishte një ngjarje historike: për herë të parë u zbulua një asteroid dhe u parashikuan si vendi ashtu edhe ora e për-



plasjes. Më pas shkencëtarët morën copat e meteorëve për të bërë studime të mëtejshme. Në këtë rast u zbulua se bëhej fjalë për një meteor të rrallë. Gjithashtu, kjo ngjarje pati edhe një vlerë tjetër: "Verifikuam që sistemi i alarmit funksionoi për mrekulli dhe se jemi në gjendje të japim alarm edhe në një kohë shumë të shkurtër, pra brenda 24 orëve", - shpjegon astronomi. "Megjithatë kemi ende shumë punë për të bërë, para se të arrijmë të kemi një sistem të dobishëm në nivel botëror, sepse rreziku i përplasjes me një trup qiellor shkatërrues, si ai 5 megaton që u verifikua në zonën e Tunguskas, Siberi, në vitin 1908, mund të ndodhë nga çasti në çast. "Teorikisht një trup qiellor më i madh duhet shikuar më parë, por askush nuk mund të garantojë që është kështu", - thotë astronomi. Kështu, për të parandaluar ndonjë katastrofë të mundshme është e nevojshme të fuqizohet rrjeti pamor dhe të përcaktohet një protokoll ndërkombëtar, për të vendosur se kur duhet të ndizet alarmi, kush duhet ta japë lajmin dhe si të bëhet evakuimi. Ajo që dimë sot është se asteroidi që ka shumë mundësi ta godasë Tokën në vitin 2018, ose 2027, quhet 2009 WM1 dhe është i gjerë rreth 300 metra. Ky asteroid do të ishte i aftë të shkatërronte komplet një hapësirë të madhe sa Franca. Llogaritjet e fundit tregojnë se tepër i rrezikshëm është edhe asteroidi "99942 Apophis", ku ishte përqendruar edhe vëmendja e mediave në të kaluarën, i cili ka shumë mundësi të përplaset me Tokën në vitin 2036 ose 2028. Megjithatë, asteroidi "2009 WM1" ka një probabilitet përplasjeje 20 herë më të madhe, pra e barabartë me 0,01% (si të fitosh një lotari me 10 mijë pjesëmarrës) dhe një energji më të madhe përplasje të parashikuar. Gjithsesi, tani për tani është e kotë të alarmohemi, pasi do të jenë të nevojshme vëzhgime të tjera për të kuptuar nëse rreziku është real. Ndërkohë, shpresojmë që të mos zbulojmë ndonjë asteroid me përmasa të njëjta si ai që goditi Tokën në Meksikë, 65 milionë vjet më parë, duke çliruar një energji prej 190 mijë gigaton (miliona herë më shumë se një bombë me hidrogjen) dhe duke shkaktuar, sipas shumë hipotezave, zhdukjen e dinozaurëve. Sipas indianit Sankar Chatterjee, paleontolog në Universitetin Teknologjik të Teksasit (SHBA), ajo që i zhduku dinozaurët nuk ishte vetëm një përplasje, por dy (kjo e fundit ndodhi pas tri shekujsh). Chatterjee është i bindur, se ka zbuluar një krater të gjerë 500 kilometra, më shumë se dyfishi i Chicxulub, në Perëndim të Indisë. Megjithatë shumë shkencëtarë janë skeptikë. Christian Koeberl, docent në Universitetin e Vjenës dhe një nga ekspertët më të mëdhenj të kësaj fushe, thotë: "Nuk ka prova që e mbështesin këtë hipotezë. Nëse do të ishte e vërtetë, e gjithë bota do të mbulohej nga një shtresë e madhe pluhuri, por në fakt nuk është kështu. E vetmja shtresë e asaj epoke është ajo që i përket kraterit të Chicxulub". Nëse një asteroid kaq i madh do t'i drejtohej Tokës, një rrugë shpëtimi mund të gjendej. Por, në fakt, një asteroid i madh është i lehtë për t'u identifikuar: mund të parashikohet përpara, nëse bëhet fjalë për një kërcënim real dhe, duke vepruar me shpejtësi të madhe, mund të parandalohet. Si? Duke i ndryshuar trajektoren, për shembull duke i vënë para një sondë për ta spostuar, ose duke e tërhequr me një "traktor hapësinor". Teknologjia mund të zhvillohet, por është e nevojshme edhe një politikë e mirë dhe kooperimi ndërkombëtar. Ky është momenti që të fillojmë t'u bëjmë ballë rreziqeve. ■



Artan N. BEJTA

Frika nga vaksina

Edhe pse kanë arritur disa doza të vaksinës kundër gripit A H1N1, në Kosovë fobia ndaj kësaj vaksine ende mbetet prezente. Kjo fobi nuk është e shprehur vetëm tek popullata kosovare, por edhe tek profesionistët e këtij lëmi. Pas arritjes së 5000 dozave të kësaj vaksine, të dhuruara nga qeveria turke për shtetin e Kosovës, ato përfunduan në IKSHPK.

Si janë prodhuar vaksinat kundër gripit A H1N1?

Metoda kryesore që është përdorur për prodhimin e kësaj vaksine është ajo me inokulimin (mbjelljen) e virusit në vezët e pulës dhe pastaj duke marrë dhe përpunuar lëngun e vezës së infektuar nga virusi pas disa ditëve.

Për prodhimin e kësaj vaksine janë përdorur dy teknologji. Një sasi e këtyre vaksinave është prodhuar në mënyrën e njohur si "vaksina inactive (inactivated vacin)" që do të thotë se në përbërjen e saj gjendet virusi i gripit A H1N1 i vdekur. Teknologjia tjetër e zakonshme është e ashtuquajtura "vaksina me viruse të dobësuara (attenuated vacin)" që do të thotë se prodhimi i tyre është bërë jo duke shfrytëzuar viruse të vdekura për prodhim, por duke bërë dobësimin e viruseve dhe shfrytëzimin e tyre si të tilla për vaksinë.

Siguria e vaksinave të gripit të derrit – në PIKËPYETJE¬?

Një numër i madh shkencëtarësh kanë vënë në pikëpyetje sigurinë e vaksinës kundër gripit A H1N1. Ky dyshim i shkencëtarëve lindi pas efekteve anësore të shfaqura nga kjo vaksinë. *Edin Hangton*, profesor në *Universitetin e Kardifit* tregon për *Gazetën Britanike "The Guardian"* se efektet e para anësore të vaksinës janë shqetësuese për komunitetin mjekësor botëror dhe se duhet më shumë vëmendje.

"Vaksina është ende e pasigurt. Deri tani janë raportuar më shumë se 20 raste vdekjesh pas kryerjes së vaksinës dhe kjo është një shifër që duhet të na shqetësojë. Këtu kemi të bëjmë me një vaksinë të krijuar në situatë pandemike, pra që është hedhur në treg pa u provuar tërësisht në njerëz. Për këtë arsye vaksina është ende e pasigurt", – thotë ai.

Mirëpo këto të dhëna i hedhë poshtë OBSH-ja, e cila i ka siguruar të gjithë qytetarët se nuk ka rrezik nga ky virus. Me anë të një komunikate, OBSH-ja deklaron se rastet e vdekjeve nuk tregojnë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me vaksinën, edhe pse ato kanë ndodhur menjëherë pas injektimit të saj.

➞

Sipas OBSH, specialistët e organizatës i kanë hetuar të gjitha këto raste. *"Një numër i vogël vdekjesh ka ndodhur te njerëzit që janë vaksinuar. Të gjitha këto vdekje të raportuara tek OBSH-ja janë duke u hetuar. Megjithëse disa nga hetimet janë në zhvillim e sipër, rezultatet e hetimeve të përfunduara, të cilat i janë raportuar OBSH-së nuk kanë përcaktuar një lidhje direkte të vaksinës me shkaqet e vdekjeve", – deklaron OBSH-ja.*

Rasti i parë i mutacionit të virusit A H1N1 i shfaqur në *Norvegji*, i raportuar nga *Instituti i Shëndetit Publik të Norvegjisë*, tashmë është konfirmuar edhe nga *Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)*, e cila duket se frikësohet nga ndryshimi që po pëson virusi i gripit të derrit, A/H1N1. OBSH ka deklaruar se këto raste të raportuara nga Instituti Norvegjez, e që kanë rezultuar me vdekje, tregojnë për mutacion të virusit. *"Shkencëtarët norvegjezë kanë analizuar mostra të marra nga më shumë se 70 pacientë me sëmundje klinike dhe deri tani nuk janë vërejtur raste të tjera mutacioni, duke treguar se mutacioni nuk është i shpërndarë në gjithë vendin, por vetëm në kryeqytetin Oslo*", – bën të ditur OBSH.

"Të dhënat e deritanishme tregojnë se vaksina e virusit mbulon edhe këtë mutacion".

Megjithatë, mutacioni i virusit tregon se ai mund të marrë forma të tjera, çka mund të shndërrohet në një virus më të rrezikshëm, rezistent si ndaj vaksinës, ashtu edhe ndaj ilaçeve të ofruara deri më sot.

Efektet anësore të vaksinës - të pritshme nga OBSH-ja!

Raportet e OBSH-së flasin se të gjitha efektet anësore të shfaqura deri më tani, pas marrjes së vaksinës kundër gripit A H1N1, kanë qenë të pritshme dhe nuk i kanë tejkaluar parashikimet e OBSH-së.


Sipas OBSH-së, përveç efekteve anësore, në vendin e marrjes së vaksinës janë vërejtur edhe sëmundje të personave të vaksinuar me temperaturë dhe dhimbje, mirëpo të gjitha këto kalojnë brenda 48 orësh, duke mos përbërë problem. "Siç pritej, efektet anësore janë zakonisht të raportuara për *fryrjen, skuqjen ose dhimbjen* në vendin e aplikimit (marrjes) së vaksinës, e cila zakonisht zgjidhet vetvetiu pak pas vaksinimit. *temperaturë, dhimbje koke, lodhje, dhimbje muskujsh etj*., që ndodhin menjëherë pas aplikimit të vaksinës, janë raportuar gjithashtu, por në më pak raste. Këto simptoma, zakonisht, largohen brenda 48 orësh. Për më tepër, janë vërejtur edhe raste të një sërë alergjish. Këto lloj efektesh vërehen në masën e paramenduar" – bën të ditur OBSH-ja.

Gjithashtu, OBSH-ja ka deklaruar se janë vërejtur raste të sindromës *Guillain-Barre*, që ka të bëjë me sëmundje neuropatike të shkaktuara nga vaksinat, porse sërish, numri i të prekurve është brenda normales, sipas organizatës. "Deri më sot, janë raportuar më pak se dhjetë raste të dyshuara me sindromën *Guillain-Barre* për njerëzit që kanë marrë vaksinën. Sipas studimeve të fundit këto numra janë normale. Megjithatë, në të gjitha këto raste po zhvillohen hetime për të përcaktuar nëse shfaqja e sindromës është e lidhur me vaksinimin", – bëri të ditur OBSH, duke shtuar se të gjitha rastet e prekura nga ky sindrom deri më sot janë shëruar.

Raporti i OBSH-së përfundon duke bërë thirrje që "të vaksinohen të gjithë, pasi deri më tani, vaksina rezulton e sigurt dhe të gjitha efektet anësore janë të pakta dhe të lehta", duke mos vendosur në rrezik jetën e njerëzve.

Punëtorët shëndetësorë kosovarë neglizhentë ndaj vaksinës kundër gripit A H1N1 – Ministri Gashi vaksinohet i pari!

Edhe pse në Kosovë kanë arritur disa doza të vaksinës kundër gripit A H1N1, fobia ndaj kësaj vaksine ende mbetet prezente. Kjo fobi nuk është e shprehur vetëm te popullata kosovare, por edhe te profesionistët e këtij lëmi. Pas arritjes së 5000 dozave të kësaj vaksine, të dhuruara nga qeveria turke për shtetin e Kosovës, ato përfunduan në IKSHPK të paprekura një javë, derisa doli i pari i shëndetësisë kosovare, Ministri i Shëndetësisë së Kosovës dhe e mori këtë vaksinë, duke u bërë personi i parë i vaksinuar në Kosovë kundër gripit A H1N1.



Gashi, me këtë rast, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës, që në respektim të rekomandimit të *Komitetit Nacional të Kosovës për Sëmundje Ngjitëse*, të vaksinohen, duke thënë se Kosova po i zbaton të gjitha masat e OBSH-së për pandeminë dhe, në këtë aspekt, duhet besuar edhe në efektin preventiv të vaksinës. *"Gripi nuk fal, prandaj, duhet të mbrohemi që të gjithë dhe një nga mënyrat më të mira për t'u mbrojtur është vaksina"* - ishin këto fjalët e Gashi drejtuar qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Drejtori për komunikim në Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës, *Faik Hoti*, pohoi se vaksinimi është vullnetar dhe i rekomanduar, mirëpo jo i obliguar.

"Mjekët janë duke hezituar për shkak të shkrimeve që janë duke qarkulluar në internet në të cilat thuhet se vaksina kundër gripit sjell efekte anësore. Ministria pret edhe disa ditë dhe nëse nuk ka interesim nga mjekët, atëherë ka kategori të tjera që janë të interesuara të vaksinohen" - ka deklaruar Hoti.

Ky hezitim për marrjen e vaksinës kundër gripit A H1N1 i punëtorëve shëndetësorë ka reflektuar në masë të madhe edhe te popullata kosovare, e cila, pa dyshim, ka një rezervë të madhe në marrjen e kësaj vaksine. Sidoqoftë, disa nga punëtorët e *Qendrës Klinike Infektive* e kanë marrë këtë vaksinë, por, megjithatë, shumica e tyre hezitojnë ta marrin atë. Kjo gjendje e krijuar po vazhdon edhe më tej, ndërsa vaksinat kundër këtij gripi vdekjeprurës, për 13 raste gjer më tani në Kosovë, po qëndrojnë në IKSHPK. ■



Për kë do të luajnë vëllezërit Xhaka?

Futbollistët nga Kosova, Taulant dhe Granit Xhaka, në vizitën që i bënë FFK-së, deklaruan se ata do ta mirëpresin ftesën për të luajtur si për Kosovën, ashtu edhe për Zvicrën. Nëna e tyre u ka deklaruar medieve zvicerane se djemtë e saj do të luajnë për Zvicrën. Sipas rregullores së FIFA-s, një futbollist mund të luajë vetëm për një shtet



Alban BILALLI

Granit e Taulant Xhaka, futbollistë nga Kosova, konsiderohen talentet më të mëdhenj për momentin në futbollin zvicer-an. Ata janë pjesë e pandashme e Përfaqësueses së Zvicrës, Taulanti luan për grupmoshat U-19, kurse Graniti për grupmoshat U-17. Madje Graniti, në vitin 2009, fitoi me Zvicrën Kupën e Botës në Nigeri, për grupmoshat U-17.

Për festat e fundvitit ata ishin në Kosovë, ku për nder të tyre, Federata e Futbollit të Kosovës organizoi një pritje. Kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri, i quajti ata ambasadorë të sportit kosovar.

Taulanti dhe Graniti ishin mjaft të lumtur me pritjen e bërë nga krerët e FFK-së. Ata u treguan të pranishmëve për sukseset e tyre në Zvicër si dhe për planet në të ardhmen. Ata ishin skeptikë sa i përket asaj se me cilën përfaqësuese do të luanin në të ardhmen, për Kosovën a për Zvicrën. Lidhur me këtë, kampioni i botës me Zvicrën, Granit Xhafa tha: "Do të isha i lumtur të ftohesha nga Përfaqësuesja A e Zvicrës, por edhe një ftesë nga Kosova do të jetë e mirëseardhur. Kurrë nuk i dihet" - u shpreh Graniti.

Babai i tyre, Ragip Xhaka, lidhur me këtë tha se ai dhe djemtë e tij kanë dëshirë të luajnë për Kosovën: "Kontaktet janë për të dyja, por dëshira ime dhe e djemve të mi është që të luajnë për Kosovën" - u shpreh Ragipi, babai i Taulantit dhe Granitit.

Reagojnë mediet zvicerane, demanton e ëma

Portali zviceran www.20minuten.ch ka reaguar menjëherë lidhur me deklaratën e Ragipit se djemtë e tij, Taulanti dhe Graniti, dëshirojnë të luajnë në të ardhmen për Kosovën. Ky portal ka intervistuar nënën e futbollistëve, lidhur me deklaratën e burrit dhe djemve të saj, se ata dëshirojnë të luajnë për Kosovën. Ajo ka deklaruar se kjo është një propagandë dhe se ata do të luajnë për Zvicrën. "Është një propagandë. Unë i kam dëgjuar me vëmendje të gjitha fjalët e asaj bisede. Askush nuk ka thënë një gjë të tillë. Nuk na interesojnë këto përralla. Ne jemi të lumtur në Zvicër. Fëmijët tanë janë lindur dhe janë shkolluar këtu. Ata i përkasin Zvicrës. Taulanti dhe Graniti në të ardhmen do të luajnë për Zvicrën" - ka thënë nëna e vëllezërve Xhaka.

Se për cilën kombëtare do të luajnë vëllezërit Xhaka do ta tregojë koha. Si Taulanti ashtu edhe Graniti kanë nënshkruar kontrata profesionale me ekipin e Bazelit deri më 2012. Taulanti është lindur më 28 mars të vitit 1991. Luan si mesfushor mbrojtës. Është i gjatë 1.73 dhe peshon 72 kg. Taulanti është shumë i fortë në duele dhe e ka gjuajtjen shumë të fortë.

Graniti është lindur më 27 shtator të vitit 1992. Luan në pozitën e mesfushorit sulmues. Është i gjatë 1. 83 dhe peshon 79 kg. Graniti shquhet si teknik shumë i mirë dhe lojtar shumë i shpejtë. Ka kontratë me Bazelin deri më 30.06.2012. ■



Largohet nga futbolli për të pasur më shumë kohë për t'iu përkushtuar Allahut

Abel Ksavier, ylli i futbollit portugez, është larguar nga futbolli aktiv. Ai është angazhuar me përkushtimin e tij në Islam. Në konferencën për shtyp, të mbajtur më 24 dhjetor të vitit që lamë pas, në stadiumin "Ras Al Khaimah" të Emirateve të Bashkuara Arabe, ai ka deklaruar se është larguar nga futbolli aktiv për t'iu përkushtuar më shumë adhurimit të Zotit. "Kësaj radhe jam këtu për të njoftuar largimin tim nga futbolli. Tani fillon një fazë tjetër e jetës sime", - ka deklaruar Ksavier, i cili më pas ka njoftuar edhe për kalimin e tij nga besimi katolik në besimin islam. "Në momentet më të vështira, ngushëllimin e kam gjetur në besimin islam. Ngadalë kam mësuar se ky besim promovon paqen, unitetin, lirinë dhe shpresën. Të gjitha këto përbëjnë bazën e identitetit", - ka shtuar mbrojtësi portugez. Ai, përveçse që ndërroi besimin, ka ndërruar edhe emrin nga Abel në Fejsal.

Abel Ksavier është lindur më 30 nëntor të vitit 1972. Karrierën futbollistike e nisi si 17 vjeçar te skuadra Amadora. Pas tri vitesh kaloi te skuadra e madhe portugeze Benfika. Pas kësaj skuadre shkoi në Itali te skuadra e Barit, e pas dy vitesh në Spanjë te Real Oviedo. Një vit qëndroi te PSV në Holandë, e më pas kaloi në ishull, te skuadra e Evertonit ku qëndroi plotë tri vite, për të kaluar më pas te rivali lokal i Evertonit, Liverpuli. Ka qenë pjesë edhe e Galatasarait, Hanoverit, Romës, Midllesbrout dhe, së fundi, ishte pjesë e skuadrës amerikane Los Angeles Galaxy. Ksavier ishte, po ashtu, edhe pjesë e kombëtares portugeze duke zhvilluar plotë 20 takime, ku ka shënuar 2 gola.

Ksavier, përpos që shquhej si mbrojtës tejet cilësor dhe i fortë në duele, njihet edhe për stilin e veçantë të flokëve, si dhe për ndeshjen gjysmëfinale të evropianit "Franca 2000" , Franca – Portugalia, ku Ksavier në minutën e 117-të shkaktoi penallti, të cilën Zidan e ktheu në gol dhe Franca shkoi në finale.

Ksavier ka paralajmëruar se tani do të merret me aksione humanitare për t'iu ndihmuar të varfërve anembanë botës.

AUTOR: AGIM GASHI	RRJETI I NGATËRRUAR I RRUGËVE	EMNAKU I AMARËS	"VESHJE" BEBESH	BANORE E NJË VENDI SHI'IT	PORTIERI BRAZILIAN, HEZUS	ALIAS	RADIUMI	MËRIA	(logo)	KRAHINË GREKE	PËRCAKTIMI I ALLAHUT	OKSIGJENI	RAPSODI, SALI	EMNAKU I ASIMES
PËRME-NDORJA									ENDE / ASHTU QOFTË					
MUZIKA E SHTHURUR												KAMPION / MAHISJA E VESHIT		
LLOJ POEME							DIÇKA SI NISESHTJA / ERBIUMI							
AKTORJA ARVANITASE, PAPAS						NJOLLOSJE / GRUP GJAKU								
MOSHË E RE					QË NUK E KA GRUAN BESNIKE								ITALIA / POROSI	
INDIA		ALI AJETI / NJË NGA NDJENJAT MË TË FUQISHME								AKTORJA, RINA				EMIGRUAR
NORTH DAKOTA			AZOTI / AKTORJA E NDJERË, JOSIPI							(logo)	GIMCOVA / FORMË E VJETËR QEVERISJEJE			
KËNGËTARJA KORÇARË, ANIDA (foto)										ORGANIZATA		A.RR. / MJET PUNE		
E PAKRYERA E FOLJES JAM				DEGË E GJUHËS						LUMË TIRANAS				
(logo)	UNIVERSAL TRAVEL GROUP / LIBRAT FILLESTARË									EPILEPSI				
BUJK										GETOARI (perkdhel.)				
VRIMA										ASTATI			SUEDIA / LUFTA	
ENERGJIA		ILIR META / PJESË E SYRIT			ISH-PORTIERI SOVJETIK, DASAEV	(logo)	PËRBIROJ	AMPERI	DËGJUAR	REPUBLIKA / AMERICAN ELECTRONICS ASSOCIATION		B.U. / FEJA E VËRTETË		
VOZË DJATHI						SHANKIST / MEHMET (dim.)								
LËVRIMI								AI QË QUAN ZOTIN KRIJUES / CANADA REVENY AGENCY						GJUAJ
RIJEKA			PLLOÇËSHTIA / UNITED KINGDOM								LLOMOTIT / V.E.			
KUJDESTARE FËMIJËSH NË KOPSHT										VAJTIME / GRAMI				
FUQI, FORCË						QË ËSHTË TËRË JARGË								